

Forcimi i rolit dhe aftësive të mësuesve mbi gjithëpërfshirjen

Gusht 2019

Manual trajnimi për mësuesit ndihmës

Broshurë për lehtësuesit e trajnimeve

unicef 
for every child

Forcimi i rolit dhe aftësive të mësuesve mbi gjithëpërfshirjen

Manual trajnimi për mësuesit ndihmës

Broshurë për lehtësuesit e trajnimeve

Përgatitur nga:

Beyond Education Consultancy

Dr. Peter Grimes, Marieke Stevens, Tricia Mariza Mangubat, Arlene dela Cruz, KaisaLigaya Sol Cruz, Irene Marie Malabanan, dhe Diana Marie Soliman

për UNICEF Shqipëri

Gusht 2019

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave	4
Hyrje	5
Broshura	5
Si mësojnë mësuesit?	5
Dita 1 – Konceptet kyçe: Qasja ndaj arsimit gjithëpërfshirës bazuar në të drejta	9
Vështrim i Përgjithshëm	9
Objektivat:.....	9
Materiale përgatitore:	9
Akhenda:	9
Hyrje.....	10
Aktiviteti 1 - Hyrje	10
Aktiviteti 2 – Lojë për nxehje: Bingo	11
Përkufizimi i arsimit gjithëpërfshirës.....	13
Aktiviteti 3 – Fletë Pune për Arsimin Gjithëpërfshirës	13
Aktiviteti 4 – Prezantim mbi arsimin gjithëpërfshirës	14
Vlerat gjithëpërfshirëse	18
Aktiviteti 5 – Prezantimi i vlerave	18
Aktiviteti 6 - Burri prej xhenxhefilii	20
Aktiviteti 7 - Burri prej xhenxhefilii (vazhdim)	21
Përkufizimi i aftësisë së kufizuar	23
Aktiviteti 8 – Prezantimi i aftësisë së kufizuar	23
Aktiviteti 9 - Barrierat	24
Modeli social i aftësisë së kufizuar	26
Aktiviteti 10 – Prezantimi i modelit social.....	26
Aktiviteti 11 - Modelet e aftësisë së kufizuar – reflektim	28
Reflektim dhe përpunim.....	29
Aktiviteti 12 – Fletë pune për arsimin gjithëpërfshirës	29
Aktiviteti 13 - Reflektimi	31
Aktiviteti 14 – Përmbledhja dhe mesazhet kyçe.....	32
Materiale - Dita 1	33
Materiali 1 Dita 1: 'Le të njihemi' Bingo.....	33
Materiali 3 – Dita 1: Çfarë është arsimit gjithëpërfshirës?	35
Materiali 4 – Dita 1: Lulja e arsimit gjithëpërfshirës.....	37
Materiali 5 – Dita 1: Rrathët e barrierave dhe mundësive	38
Materiali 6 – Dita 1: Barrierat e mundshme ndaj të Nxëniti dhe Pjesëmarrjes	39
Dita 2 – Praktika gjithëpërfshirëse: Çfarë është një mësues ndihmës dhe si mund të krijojmë një mjedis të nxëni gjithëpërfshirës?	42
Objektivat:.....	42
Materiale përgatitore:	42
Akhenda:	43
Hyrje.....	43
Aktiviteti 1 - Hyrje	43
Aktiviteti 2 – Lojë për nxemje: Aeroplanët	43
Mësuesi ndihmës	45
Aktiviteti 3 - Prezantimi i rolit të mësuesit ndihmës.....	45
Aktiviteti 4: Diskutimi i rolit dhe i përgjegjësive në grup	47
Bashkëpunim	48

Aktiviteti 5 – Prezantim mbi bashkëpunimin.....	48
Aktiviteti 6 – Diskutim në grup.....	51
Pedagogjia me në qendër fëmijën.....	52
Aktiviteti 7 – Prezantim mbi rëndësinë e pedagogjisë me në qendër fëmijën.....	52
Çfarë të thoni	54
Aktiviteti 8 – Prezantim mbi mënyrën e realizimit të pedagogjisë me në qendër fëmijën	54
Dizenjimi Universal për të Nxënit.....	58
Aktiviteti 9 – Parimet bazë të DUN-së	58
Aktiviteti 10 – Përshtatja e mjedisit të të nxënit	61
Reflektimi dhe përpunimi	63
Aktiviteti 11 – Reflektimi bashkëpunues	63
Aktiviteti 12 – Përmbledhja dhe mesazhet kyçe.....	64
Materiale, dita 2.....	66
Materiali 1, dita 2: Pedagogji e veçantë apo me në qendër fëmijën?	66
Materiali 2, dita 2: - Karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën	67
Materiali 3, dita 2: Stilet e ndryshme të të nxënit	71
Materiali 4, dita 2: Parimet e DUN-së	72
Materiali 5, dita 2: Këshilla për përshtatjen e mjediseve të të nxënit	73
Dita 3 – Planifikimi për arsimin gjithëpërfshirës: Strategji praktike për mbështetjen efikase të mësuesve ndihmës në klasë.....	75
Përmbledhje	75
Objektivat:.....	75
Materiale përgatitore:	75
Axhenda:	75
Hyrje.....	76
Aktiviteti 1: Hyrje	76
Aktiviteti 2: Loja për nxehje, Lëvizni-Bëhuni dyshe-Ndani.....	76
Strategjitë bazë në klasë - E përgjithshme	77
Aktiviteti 3: Prezantimi i strategjive bazë në klasë	77
Aktiviteti 4: Reflektimi i strategjive bazë në klasë	79
Mësimdhënie e fëmijëve me autizëm në klasa gjithëpërfshirëse.....	80
Aktiviteti 5: Prezantim	80
Aktiviteti 6: Strategjia e mësimdhënies së fëmijëve me autizëm në mjedise gjithëpërfshirëse	82
Mësimdhënia e fëmijëve me sindromën Down në klasa gjithëpërfshirëse.....	83
Aktiviteti 7: Prezantim	83
Aktiviteti 8: Ndarja e përvojave	84
Planin për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës.....	85
Aktiviteti 9: Prezantim i Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës	85
Aktiviteti 10: Studimi i rastit	88
Aftësitë e trajnimit	89
Aktiviteti 11: Rrahje mendimesh	89
Reflektimi dhe përpunimi	91
Aktiviteti 12: Reflektimi mbi trajnimin.....	91
Aktiviteti 13: Përmbledhja dhe mesazhet kyçe	93
Materiale, dita 3.....	94
Materiali 1, dita 3: Strategjitë bazë në klasë.....	94
Materiali 2 - Dita 3: Plani për mbështetjen e familjes dhe fëmijës	98
Materiali 3 - Dita 3: Rast studimor	103
Lista e referencave	105

Lista e shkurtesave

TT	Trajnim i Trajnuesve
DUN	Dizenjimi Universal i të Nxënit
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencave të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Hyrje

Broshura

Angazhimi i Shqipërisë në mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara u vërtetua me ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). Hapat madhorë drejt përmirësimit të mëtejshëm të realizimit të arsimit gjithëpërfshirës mundësuan caktimin e mësuesve ndihmës për t'i mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara, me qëllim integrimin efikas në shkollat e rregullta. Ky projekt i autorizuar nga UNICEF, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), synon që të forcojë rolin dhe aftësitë e mësuesve ndihmës në Shqipëri, nëpërmjet trajnimit të trajnuesve dhe hartimit të udhëzuesve për krijimin e shkollave gjithëpërfshirëse në vend.

Qëllimi i kësaj **broshure për lehtësuesit** është mbështetja e trajnuesve për t'i trajnuar mësuesit ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës. Lehtësuesi iu ofron trajnuesve të gjitha mjetet e nevojshme për të lehtësuar një kurs trajnimi tregues, të quajtur "Trajnim i Trajnuesve (TiT)". Në broshurë përfshihet agjenda e përgjithshme e secilës ditë të trajnimit, e cila mund t'iu shpërndahet të gjithë pjesëmarrësve. Secila ditë trajnimi përfshin një grup objektivash, një listë materialesh që duhen përgatitur, si dhe një agjendë më të hollësishme për lehtësuesit. Për secilin aktivitet bëhet një përmbledhje e qëllimit, synimit, materialeve dhe metodave përkatëse. "Hapat e aktiviteteve" paraqesin me hollësi se çfarë duhet bërë, thënë, shfaqur dhe ndarë nga trajnuesit për të lehtësuar aktivitetin.

- **Çfarë të thoni** - Përmbajtja e sugjeruar e cila duhet t'iu shpërndahet pjesëmarrësve
- **Çfarë të ndani** - Materiale
- **Çfarë të shfaqni** - Faqe prezantimi ose video
- **Çfarë të bëni** - Aktivitete të ndryshme me pjesëmarrësit

Në këtë broshurë përfshihen të gjitha materialet për pjesëmarrësit. Prezantimet dhe videot gjenden në një tjetër dosje. Lehtësuesve iu rekomandojmë që t'i lexojnë të gjitha materialet dhe të shohin çdo video para kursit të trajnimit.

Broshura për lehtësuesit shoqërohet me **broshurën për pjesëmarrësit**. Lehtësuesi duhet t'iu ofrojë secilit pjesëmarrës nga një broshurë. Në broshurën për pjesëmarrësit paraqiten informacione bazë mbi të gjitha temat e trajnimit, që të lexohen pas kursit të trajnimit. Krahas kësaj, përfshihen edhe të gjitha materialet që do të përdoren gjatë kursit të trajnimit. Ndaj, çdo ditë të trajnimit pjesëmarrësit duhet t'iu kenë broshurat me vete.

Si mësojnë mësuesit?

Para se të filloni me kursin e trajnimit, duhet të reflektoni mbi mënyrën se si mësojnë mësuesit e zakonshëm dhe ata ndihmës. Në këtë pjesë parashtrihen çështjet kyçe.

Të nxënit është proces i vazhdueshëm

Është e pamundur që të mësohet çdo gjë brenda një workshop-i ose trajnimi të vetëm. Nuk ndodh shpesh që mësuesit të përvetësojnë njohuri të specializuara dhe të gjitha aftësitë e nevojshme për të vënë në jetë ide të reja vetëm nga një workshop. Në të vërtetë, mësuesve iu duhet kohë dhe kontakt i vazhdueshëm me koncepte dhe praktika të reja në mënyrë që t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë plotësisht. Mësuesit mund të zhvillohen vetëm nëse mësojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë. Ndaj, ky TiT është pikënisja e zhvillimit të tyre profesional. Mësuesit ndihmës duhen nxitur që të vazhdojnë t'iu ndajnë dhe të reflektojnë mbi njohuritë dhe aftësitë e përvetësuara edhe pasi të kthehen në shkollat ku punojnë.

Mësuesit mësojnë më së miri në shkollë

Shumica e nismave për zhvillimin e mësuesve realizohen jashtë shkollës, në hapësira për grupe të vogla dhe me të gjitha mjetet e nevojshme. Këto hapësira jo gjithmonë e pasqyrojnë siç duhen realitetin e përditshëm të shumë mësuesve, të cilët punojnë në shkolla ku mjetet, burimet dhe interneti nuk janë të disponueshme, dhe iu japin mësim grupeve të mëdha nxënësish. Megjithatë, hamendësohet se çdo gjë që kanë mësuar në hapësirat ideale, mësuesit mund ta përcjellin krejt lehtësisht në praktikën e tyre të përditshme në klasë. Krahas kësaj, modeli tradicional i zhvillimit të mësuesve iu jep mundësinë vetëm disave prej tyre që të shkojnë në kryeqytet ose në qytete të tjera për të ndjekur workshop-e trajnimi. Mësuesit që përzgjidhen ose kanë status më të lartë, ose janë më të vjetër, ose kanë më shumë përvojë. Mendohet se këta mësues të privilegjuar i përfaqësojnë kolegët e tyre në shkolla dhe pas workshop-it, do t'i ndajnë njohuritë e përvetësuara në mënyrë të pavarur. Megjithatë, kjo rrallëherë ndodh në të vërtetë.

Ndaj, seancat e trajnimit realizohen më së miri vetëm në nivelin vendor, si për shembull në shkolla ose në zyrat arsimore të rrethit, me mësues nga një grup shkollash. Në këtë mënyrë, lehtësuesit e kanë më të thjeshtë për të kuptuar kushtet ku duhet të zbatohen praktikat e reja, si dhe mund të bashkëpunojnë me mësuesit për të hartuar strategjitë përkatëse me qëllim heqjen e barrierave gjatë zbatimit. Konceptet dhe praktikat e reja mund të zbatohen lehtësisht gjatë seancave të trajnimit. Për shembull, në shkollë nuk është shumë e vështirë që të përgatiten planet mësimore, të parashikohen orë mësimore provë ose orë vëzhgimi. Seancat e trajnimit në shkollë mund t'iu ofrohen të gjithë mësuesve të një apo disa shkollave. Në këtë mënyrë nxitet bashkëpunimi ndërmjet kolegëve, që më vonë mund të shndërrohet në komunitete mësuesish, çka përbëjnë strukturat ideale për mbështetjen e pandërprerë ndaj mësuesit.

Mësuesit mësojnë së bashku

Të nxënit është aktivitet social. Mësuesit mësojnë më së miri kur në shkollë ekziston fryma e besimit dhe e shkëmbimit të njohurive, si dhe strukturat për bashkëpunim. Nëse bashkëpunojnë në një mjedis përkrahës, mësuesit janë më të gatshëm për të ndjekur qasje të reja në klasë, çka shpie drejt efektshmërisë së mësuesit dhe përmirësimit të arritjeve të nxënësve. Në kursin e trajnimit përfshihen veprimtari që synojnë nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve.

Njohuritë janë dinamike

Shpeshherë, njohuritë ofrohen përmes teorive dhe koncepteve fikse, pasi mendohet se nga mësuesit do të përdoret e njëjta qasje kur të zbatojnë arsimin gjithëpërfshirës. Megjithatë, arsimit gjithëpërfshirës është koncept shumë më i ndërlikuar. Nuk ekziston asnjë model për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës i cili funksionon në çdo shkollë, pasi çdo komunitet shkollor është i ndryshëm dhe përballet me faktorë kontekstorë të shumëllojshëm, që pengojnë të nxënit. Ndaj, mësuesve nuk mund t'iu ofrohen as teori as njohuri fikse, por mësuesit duhet realizojnë një proces reflektimi kritik si me trajnuesit, ashtu edhe me komunitetin shkollor, ku të analizojnë situatën dhe të hartojnë strategji vendore për të adresuar sfida vendore.

Të nxënit është aktiv

Mësimi më i mirë për mësuesit nuk janë njohuritë që iu ofrohen, por nxitja për t'i vënë në jetë ato që mësojnë. Në një trajnim tradicional për zhvillimin e mësuesit, të nxënit shpeshherë është pasiv. Zakonisht trajnuesi paraqet informacione mbi përmbajtjen, dhe ndonjëherë pjesëmarrësve iu

kërkohet të diskutojnë dhe të japin mendimet e tyre mbi to, para se trajnuesi të vijojë me informacione të reja. Kjo lloj qasjeje e bën të nxënit pasiv, pasi kryesisht mësuesit përvetësojnë njohuri, por as nuk mësojnë as nuk përfitojnë mbështetje për t'i vënë në jetë. Të nxënit aktiv nuk izolohet brenda diskutimeve në grup apo lojërave në workshop. Përkundrazi, ky lloj të nxëni përfshin angazhim të gjithanshëm me koncepte, praktika dhe parime të reja që zbatohen në situata të vërteta.

Mësuesve nuk iu duhen ekspertë, por lehtësues

Realizimi i udhëzimeve të mësipërme për mënyrën se si mësojnë mësuesit kërkon ndryshimin e roleve tradicionale të trajnuesve dhe pjesëmarrësve në nismat për zhvillimin e mësuesit. Shpeshherë trajnuesit shihen si ekspertë dhe pjesëmarrësit si mësues më pak të ditur, të cilët do t'i përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre duke i dëgjuar ekspertët. Meqenëse njohuritë janë dinamike dhe të nxënit është aktiv, bashkëpunues, i vazhdueshëm dhe varet nga konteksti, trajnuesit nuk mund të sillen më si ekspertë, me detyrë kryesore përçimin e njohurive të mësuesit. Ata duhet të shndërrohen në lehtësues, që ndonjëherë mund ta prezantojnë përmbajtjen, por kryesisht përqendrohen të mbështetja e mësuesve për ta përdorur në klasë. Po ashtu, pedagogët duhet të bëhen lehtësues që i prijnë studentët nëpërmjet reflektimit dhe praktikës. Pjesëmarrësit nuk janë as gota që duhen mbushur me njohuri, as mësues që ndjekin praktika të gabuara, të cilat duhen korrigjuar. Mësuesit duhet të konsiderohen si partnerë kompetentë dhe të përgjegjshëm në procesin e tyre të të nxënit. Ata marrin pjesë në seancat për zhvillimin e mësuesit duke pasur edhe njohuri, aftësi dhe përvojë paraprake. Vlerat, besimet dhe konteksti konkret i shkollës ndikojnë të mënyra se si e vënë në jetë përmbajtjen e trajnimit. Mësuesit janë agjentë aktivë ndryshimi që çdo ditë marrin vendime, që ndikojnë të zbatimi i praktikave dhe politikave të reja të mësimdhënies. Në seancat e trajnimit duhet të evidentohen dhe të përdoren njohuritë, përvoja, vlerat dhe konteksti konkret i pjesëmarrësve.

Axhenda e trajnimit

Dita 1 – Konceptet kyçe

Koha	Tema
09.00 - 10.00	Mirëseardhja dhe Prezantimi
10.00 – 11.00	Përkufizimi i arsimit gjithëpërfshirës
11.00 – 11.15	Pushimi i çajit
11.15 – 12.00	Vlerat gjithëpërfshirëse
12.00 – 13.00	Dreka
13.00 – 13.30	Vlerat gjithëpërfshirëse (vazhdim)
13.30 – 14.30	Përkufizimi i aftësisë së kufizuar
14.30 – 15.15	Modeli social i aftësisë së kufizuar
15.15 – 15.30	Pushimi i çajit
15.30 – 16.30	Reflektim dhe diskutim

Dita 2 - Praktika gjithëpërfshirëse

Koha	Tema
09.00 – 09.30	Mirëseardhja dhe Prezantimi
09.30 – 10.30	Mësuesit ndihmës
10.30 – 10.45	Pushimi i çajit
10.45 – 11.40	Bashkëpunim
11.40 – 12.00	Pedagogjia me në qendër fëmijën
12.00 – 13.00	Dreka
13.00 – 14.00	Pedagogjia me në qendër fëmijën (vazhdim)
14.00 – 15.00	Pushimi i çajit
15.00 – 16.00	Dizenjimi Universal i të Nxënës
16.00 – 16.30	Reflektim dhe diskutim

Dita 3 - Planifikimi i arsimit gjithëpërfshirës

Koha	Tema
09.00 – 09.30	Mirëseardhja dhe Prezantimi
9.30 – 10.30	Strategjitë bazë në klasë - e përgjithshme
10.30 – 10.45	Pushimi i çajit
10.45 – 12.00	Mësimdhënia e fëmijëve me autizëm në klasat gjithëpërfshirëse
12.00 – 13.00	Dreka
13.00 – 14.00	Mësimdhënia e fëmijëve me sindromën Down në klasat gjithëpërfshirëse
14.00 – 15.00	Plani për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes
15.00 – 15.15	Pushimi i çajit
15.15 – 15.45	Aftësitë e trajnimit
15.45 – 16.30	Reflektim dhe diskutim

Dita 1 – Konceptet kyçe: Qasja ndaj arsimit gjithëpërfshirës bazuar në të drejta

Vështrim i Përgjithshëm

Objektivat:

- Prezantoni konceptet kyçe dhe parimet e të drejtave në arsimin gjithëpërfshirës
- Familjarizohuni me politikat ndërkombëtare dhe kombëtare për arsimin gjithëpërfshirës
- Kuptoni rëndësinë e vlerave gjithëpërfshirëse
- Kuptoni aftësinë e kufizuar të përcaktuar sipas modelit social

Materiale përgatitore:

- Laptop
- Projektor
- Bokse
- Ekране të bardha
- Mikrofona
- Flipcharts
- Shirit ngjitës
- Stilolapsa
- Lapustil
- Letra me ngjitje për shënime (Post It)
- Flipchart “vendparkimi” (për shënime shtesë)
- 1 flipchart ‘Njeriu prej kek xhenxherfilli’ për çdo grup
- Prezantimet:
 - ‘ToT, Dita 1’
- Materialet:
 - Materiali 1 – Dita 1: ‘Le të njihemi’ Bingo, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 2 – Dita 1: Fletë Pune për Arsimin Gjithëpërfshirës, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 3 – Dita 1: Çfarë është arsimi gjithëpërfshirës, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 4 – Dita 1 - Lulja me vlerat gjithëpërfshirëse, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 5 – Dita 1: Rrathë barrierash dhe mundësish, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 6 – Dita 1: Barrierat potenciale të të nxëniet dhe pjesëmarrjes, 1 kopje për pjesëmarrës
- Videot:
 - Videoja “Say Yes” [thuaj po]: https://www.youtube.com/watch?v=bP_f5oWth1E
 - Videoja e Sarah-s W-DARE [Gratë guxojnë]: <https://www.youtube.com/watch?v=qx2gWjEVcnM>

Axhenda:

Koha	Tema	Aktivitet
09.00 - 10.00	Mirëseardhja dhe Prezantimi	Aktiviteti 1 - Hyrje (30 min)
		Aktiviteti 2 – Lojë për nxehje: Bingo (30 min)
10.00 – 11.00	Përkufizimi i arsimit gjithëpërfshirës	Aktiviteti 3 – Fletë Pune për Arsimin Gjithëpërfshirës (15 min)
		Aktiviteti 4 - Prezantim mbi arsimin gjithëpërfshirës (45 min)
11.00 – 11.15	Pushimi i çajit	
11.15 – 12.00	Vlerat gjithëpërfshirëse	Aktiviteti 5 - Prezantimi i vlerave (20 min)
		Aktiviteti 6 - Burri prej xhenxhefile (vazhdim) (25 min)

		min)
12.00 – 13.00	Dreka	
13.00 – 13.30	Vlerat gjithëpërfshirëse (vazhdim)	Aktiviteti 7 - Burri prej xhenxhefili (vazhdim) (30 min)
13.30 – 14.30	Përkufizimi i aftësisë së kufizuar	Aktiviteti 8 - Prezantimi i aftësisë së kufizuar (15 min)
		Aktiviteti 9 - Barrierat (45 min)
14.30 – 15.15	Modeli social i aftësisë së kufizuar	Aktiviteti 10 - Prezantimi i modelit social (20 min)
		Aktiviteti 11 - Modelet e aftësisë së kufizuar – reflektim (25 min)
15.15 – 15.30	Pushimi i çajit	
15.30 – 16.30	Reflektim dhe shtjellim i ideve	Aktiviteti 12 – Fletë Pune për arsimin gjithëpërfshirës (20 min)
		Aktiviteti 13 - Reflektimi (20 min)
		Aktiviteti 14 - Përmbledhja dhe mesazhet kyçe (20 min)

Hyrje

Aktiviteti 1 - Hyrje

Koha: 30 minuta (09:00 – 09:30)

Çfarë të bëni

Prezantim 5-minutësh i projektit nga një përfaqësues i UNICEF

Përdorni faqet e prezantimit në PowerPoint për të prezantuar:

- Ekipin konsulent
- Objektivat e trajnimit
- Objektivat e ditës së parë
- Agjendën e trajnimit

Çfarë të bëni

Prezantoni konceptin e “vendparkimit”

Çfarë të thoni

“Gjatë seancës së trajnimit mund t’iu lindin pyetje ose komente mbi përmbajtjen. Duke qenë se kohën e kemi të kufizuar, nuk do të na mjaftojë për t’i adresuar menjëherë. Mbi tavolinë keni disa letra me ngjitës dhe stilolapsa. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem shkruajeni dhe vendoseni në “vendparkim”. Këtë gjë mund ta bëni në çdo çast gjatë seancës së trajnimit. Unë do t’i kontrolloj pyetjet rregullisht dhe do t’iu përgjigjem gjatë trajnimit. Disave nga pyetjet mund t’iu kthej përgjigje në seanca të mëvonshme. Në fund të secilës dite, kemi parashikuar një seancë për reflektim dhe përpunim. Nëse nuk keni marrë përgjigje për pyetjet tuaja, do t’i trajtojmë gjatë seancës së reflektimit dhe përpunimit.

Çfarë të bëni

Gjeni 3 vullnetarë që duan të lehtësojnë nxehtjen pas drekës (1 vullnetar për secilën ditë trajnimi). Sqaroni se nxehtja mund të jetë çfarëdolloj loje, kënge apo kërcimi që shërben për t'i gjallëruar pjesëmarrësit pas pushimit të drekës. Duke qenë se nuk kemi shumë kohë në dispozicion, secili aktivitet do të zgjasë 5 minuta, duke përfshirë edhe udhëzimet.

Aktiviteti 2 – Lojë për nxehtje: Bingo

Koha: 30 minuta (09:30 – 10:00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Njohja me pjesëmarrësit
- Aktivitete për të thyer akullin
- Zbulimi i mendimit dhe ndjenjave të pjesëmarrësve për arsimin gjithëpërfshirës

Fokusi

- Nxitja e pjesëmarrësve që të fillojnë e të bisedojnë me njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë, do të gjejnë pikat e përbashkëta dhe mbase do t'i njohin kolegët dhe shokët e klasës nga një këndvështrim tjetër. Në fletën e bingos janë shkruar disa pohime mbi arsimin gjithëpërfshirës, çka mund t'ju ndihmojë të hartëzoni përvojat, njohuritë dhe aftësitë paraprake të pjesëmarrësve.

Materiale

- Materiali 1 – Dita 1: Bingo “Le të njihemi”, 1 kopje për pjesëmarrës
- Stilolapsa

Metoda

- Lojë

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

“Secila ditë do të fillojë me një lojë për nxehtje. Njerëzit mësojnë në mënyra të ndryshme. Shumica prej nesh mëson në mënyrë aktive dhe angazhuese. Lojërat për nxehtje na ndihmojnë të thyejmë akullin, të përqendrohemi te seanca dhe të krijojmë një atmosferë të shtendosur dhe miqësore. Të gjithë këta faktorë përmirësojnë të nxënit. Nëse është e mundur, krijoni një lidhje midis lojërave për nxehtje dhe përmbajtjes së kreut. Sot, do të luajmë një lojë prezantimesh për t'u njohur me njëri-tjetrin dhe për të filluar të kuptojmë përvojat tona me arsimin gjithëpërfshirës. Gjatë seancave të trajnimit, do t'ju shpjegoj arsyen përse do të zhvillojmë disa aktivitete. Në këtë mënyrë mund të frymëzoheni për aktivitete të reja në klasë për të mbështetur të nxënit e fëmijëve. Veç kësaj, ju mësoni më mirë nëse e dini se çfarë të prisni. Po ashtu, këshillohet që në klasë të shpjegoni qartë aktivitetet që do të realizoni, arsyet përse dhe pritshmëritë tuaja ndaj fëmijëve.”

Çfarë të ndani

Secilit pjesëmarrës jepini një kopje të Materialit 1 – Dita 1, fleta e bingos Sigurohuni që të gjithë kanë nga një stilolaps.

Flet më shumë se 1 gjuhë	Nuk i pëlqen pica	Mund të vrapojë deri në 10km	Ka mace një	Ka njohje personale me fëmijët me aftësi të kufizuara
Mund të luajë në një instrument muzikor	Këtë javë ka pastruar kuzhinën	Ka dëgjuar më parë për arsimin gjithëpërfshirës	Shkon në punë me biçikletë	Është mëngjarash
Ka frikë nga merimangat	Ka mësuar fëmijët me aftësi të kufizuara në klasën e tij/saj	Pi kafe çdo ditë	Ka qenë pjesë e një shfaqjeje teatrore	Ka 1 ose më shumë fëmijë
Ka bërë të mundur lehtësimin e një trajnimi	Njeh një person të famshëm	Mban lente	Ka qenë pjesë e një trajnimi për mësuesit	Ka ose ka pasur një pseudonim
Ka lindur në mars	Di të bëjë punë me grep	Ka vizituar një shtet tjetër	I vesh këpucët pa lidhëse	I pëlqen tava e kosit

Çfarë të thoni

“Do të fillojmë me një lojë të shkurtër për t’u njohur me njëri-tjetrin. Të gjithë kanë marrë nga një fletë bingoje. Në tabelë përfshihen kuti me karakteristika. Kaloni disa minuta duke lëvizur nëpër sallë, duke folur dhe duke i bërë pyetje njëri-tjetrit. Sapo të gjeni personin që ka një karakteristikë të caktuar, shënojani emrin në kutinë përkatëse. Lojën e fiton personi i parë që i plotëson 5 emrat në një rresht, duke përfshirë edhe rreshtat vertikalë, horizontalë dhe diagonalë.”

3 shembuj të “bingos”, 5 kuti rresht

Çfarë të bëni

Lejojuni pjesëmarrësve 5-10 minuta për të biseduar dhe për të plotësuar fletën e bingos. Sigurohuni që të gjithë i kanë kuptuar udhëzimet. Nëse i kanë kuptuar, mos ndërhyuni dhe lejojini të bisedojnë.

Çfarë të bëni

Sapo dikush ta fitojë bingon ose të kenë kaluar 10 minuta lojë, kërkojuni të gjithëve të ulen në vendet e tyre. Drejtoni disa pyetje për një ose disa pjesëmarrës, por nëse nuk keni shumë kohë në dispozicion, mos i mbuloni të gjitha. 2 pyetjet e fundit janë më të rëndësishmet.

- A mund të përmendni një karakteristikë që nuk e ka askush?
- A mund të përmendni një karakteristikë që e kanë të gjithë?
- A ka ndjekur ndonjëri nga ju ndonjë program për zhvillimin e mësuesit më parë? Na flisni pak për përvojën tuaj.
- A ju keni dhënë mësim fëmijëve me aftësi të kufizuara më parë? Na flisni pak për përvojën tuaj.

Përkufizimi i arsimit gjithëpërfshirës

Aktiviteti 3 – Fletë Pune për Arsimin Gjithëpërfshirës

Koha: 15 minuta (10:00 – 10:15)

Përmbledhje

Qëllimi

- Zbulimi i rrugëtimit individual të secilit pjesëmarrës në arsimin gjithëpërfshirës.
- Shprehja e mendimeve, njohurive dhe ndjenjave të tyre gjatë seancës për arsimin gjithëpërfshirës.

Fokusi

- Fleta për rrugëtimin reflektues individual mbi arsimin gjithëpërfshirës

Metoda

- Reflektim individual

Materiale

- Materiali 2 – Dita 1: Fleta e punës për arsimin gjithëpërfshirës, 1 kopje për pjesëmarrës
- Prezantimi ‘TT, dita 1’

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

“Gjatë kësaj seance do t’ju kërkohet t’iu ktheni përgjigje të gjitha pyetjeve që janë shkruar në kutitë e fletës së punës. Fleta e punës për arsimin gjithëpërfshirës synon t’ju drejtojë gjatë rrugëtimit tuaj për të kuptuar arsimin gjithëpërfshirës. Ju nxisim të reflektoni dhe të tregoheni sa më të sqartë dhe të hapur. Asnjë përgjigje nuk quhet e gabuar. Synimi i vetëm i arsimit gjithëpërfshirës është mirëkuptimi dhe mbështetja.

Në seancat e trajnimit kanë rëndësi çastet e reflektimit individual, pasi i ndihmojnë pjesëmarrësit të përpunojnë të nxënësit dhe ta lidhin me përmbajtjen, njohuritë aktuale ose me përvojat e mëparshme, si dhe të fillojnë të mendojnë se si mund t’i përdorin aftësitë e reja që kanë përvetësuar. Shpeshherë seancat e trajnimit janë të ngjeshura, dhe nuk ka kohë mjaftueshëm për të paraqitur punën individuale ose në grup. Plotësimi i kësaj flete pune nxit reflektimin më shpejt sesa diskutimet në grup apo prezantimet.”

Çfarë të thoni

“Pyetja që duhet shtruar para se të fillojmë zyrtarisht me kreun është: “Çfarë kuptoni me arsim gjithëpërfshirës?””

Çfarë të shfaqni

P1


Çfarë kuptoni me **Arsim Gjithëpërfshirës?**

Çfarë të bëni

Lejoni pjesëmarrësit të punojnë me fletët e punës për arsimin gjithëpërfshirës dhe t'i shkruajnë përgjigjet në kuti. Ky ushtrim është individual.

Pjesëmarrësit kanë 5 minuta kohë për t'u përgjigjur.

Çfarë të shfaqni



Çfarë të thoni

“Me të mbaruar njoftojini lehtësuesit, në mënyrë që të vijojmë me prezantimin. Ju lutem mos i ndani përgjigjet me të tjerët, pasi qëllimi i kësaj seance është reflektimi individual.”

Çfarë të bëni

Pasi të gjithë pjesëmarrësit i janë përgjigjur P1, shfaqni faqen e prezantimit ku shpjegohet fokusi i Ditës 1 të trajnimit.

Pasi të prezantoni faqen e prezantimit, vazhdoni me aktivitetin e radhës.

Çfarë të shfaqni

Duhet të kuptojmë përse fëmijët e marginalizuar përjashtohen nga arsimi

- Çfarë i frenon fëmijët e marginalizuar (përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara) të kenë akses në arsim?
- Çfarë i frenon fëmijët me aftësi të kufizuara nga të nxënëit e efektshëm?
- Si mund të krijojmë shkolla dhe shoqëri gjithëpërfshirëse?

Aktiviteti 4 – Prezantim mbi arsimin gjithëpërfshirës

Koha: 45 minuta (10:15 – 11:00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Prezantimi i arsimit gjithëpërfshirës me bazë të drejtat
- Njohja me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për arsimin gjithëpërfshirës, si dhe parimet dhe konceptin e tij.

Fokusi

- Ofrimi i informacioneve për arsimin gjithëpërfshirës, veçanërisht lidhur me konventat dhe legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsimin gjithëpërfshirës dhe cilësor.

Materiale

- Materiali 2 – Dita 1: Fleta e punës për arsimin gjithëpërfshirës, 1 kopje për pjesëmarrës
- Materiali 3 – Dita 1: Çfarë është arsimit gjithëpërfshirës, 1 kopje për pjesëmarrës
- Kompjuter, projektor dhe ekran
- Videoja “Thuaj Po”: https://www.youtube.com/watch?v=bP_f5oWth1E
- Prezantimi ‘TT, dita 1’

Metoda

- Prezantim
- Video
- Reflektim

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

“Pasi të shkruani se çfarë kuptoni me arsimin gjithëpërfshirës, do të diskutojmë për përkufizimet kombëtare dhe ndërkombëtare mbështetur mbi konventa dhe politika të ndryshme, që garantojnë zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës.”

Çfarë të bëni

Shpërndani Materialin 3 – Dita 1: Çfarë është arsimit gjithëpërfshirës, 1 kopje për pjesëmarrës.

Çfarë të thoni

“Për më shumë hollësi, ju lutem referojuni Materialit 3 - Dita 1. Nëse dëshironi, mund t’i studioni më vonë, por fillimisht lexoni politikat e shënuara me ngjyrë.”

Çfarë të shfaqni

Me bazë të drejtat

Arsimi gjithëpërfshirës bazohet në të drejtën themelore të të gjithë fëmijëve për të përfituar arsim cilësor

Ky pohim mbështetet nga dokumente ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë:

- Deklaratën e OKB-së për të Drejtat e Njeriut, 1948
- Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, 1989
- Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2006
- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, 1998
- Ligjin për Kuvendin Nr. 18/2017
- Ligjin për Sistemin Arsimor Parauniversitar Nr. 69/2012
- Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara Nr. 93/2014

Çfarë të bëni

Nëpërmjet faqe prezantimive prezantoni KDPAK-në dhe Komentin e Përgjithshëm Nr. 4 (KP4)

Çfarë të shfaqni

KDPAK-ja dhe Arsimi Gjithëpërfshirës

KDPAK-ja ka rëndësi, sepse është marrëveshja e parë ligjore që i detyron shtetet të zbatojnë arsimin gjithëpërfshirës

Pikat kyçe në përkufizimin e arsimit gjithëpërfshirës të KDPAK-së janë:

- Fëmijët me aftësi të kufizuara nuk mund të përjashtohen nga sistemi i arsimit të përgjithshëm
- Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të kenë akses në arsim në kushte të barabarta me të tjerët, në komunitetet ku jetojnë
- Në sistemin arsimor të përgjithshëm duhet të ofrohet akomodim dhe mbështetje e arsyeshme

Arsimi gjithëpërfshirës **nuk** i veçon fëmijët me aftësi të kufizuara në shkolla të veçanta

Komenti i Përgjithshëm Nr. 4 i KDPAK-së

KDPAK-ja parashikon drejtimin e përgjithshëm të politikave drejt arsimit gjithëpërfshirës

KP Nr. 4 parashikon udhëzues mbi mënyrën e zbatimit, me çështje kyçe, si:

- AGJ kërkon reformë në mbarë sistemin
- AGJ fillon nga vlerat gjithëpërfshirëse
- Pranimi se të gjithë fëmijët mësojnë ndryshe, ndaj pedagogjia me në qendër fëmijën është më e përshtatshme
- Nevoja për të krijuar mjedise të nxëni të aksesueshme dhe miqësore ndaj fëmijës
- Nevoja e mësuesve për trajnim dhe mbështetje

Çfarë të bëni

Shpjegoni pikat kryesore që shfaqen në faqe prezantimi

Çfarë të shfaqni

SHUMË PËRKUFIZIME, ELEMENTE TË PËRBASHKËTA Ekzistojnë shumë përkufizime dhe kuptime të arsimit gjithëpërfshirës. Elementet e përbashkëta përfshijnë:

- Arsimi gjithëpërfshirës është një **proces i vazhdueshëm** për ta bërë shkollën më mikpritëse, të dobishme dhe me në qendër fëmijën

Nuk është projekt i njëhershëm

- Përqendrohet te **ristrukturimi i kulturës, politikave dhe praktikave, në mënyrë që t'iu përgjigjen një sërë lexuesish**

Nuk përqendrohet vetëm tek arsimimi i FAK në mjedise të zakonshme

- Përfshin **ndryshimin e shkollës**, për t'i përfshirë të gjithë nxënësit

Nuk përpiqet të ndryshojë fëmijët për t'iu përshtatur strukturave arsimore ekzistuese

- Është një përpjekje e vazhdueshme **për të identifikuar dhe për të hequr barriera specifike**, në mënyrë që të gjithë fëmijët të kenë akses në arsim në komunitetin e tyre

Nuk ekziston një procedurë standarde për të zbatuar arsimin gjithëpërfshirës në çdo shkollë

Nuk iu ofron ndihmë fëmijëve vetëm për t'u regjistruar në shkollë

- Është një **proces** që duhet të zbatohet **me pjesëmarrjen e një sërë palësh interesi**

Nuk mund të zbatohet vetëm nga mësuesit dhe/ose ekspertët

Çfarë të bëni

Pasi të diskutoni për kuadrin legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe perceptimet e gabuara dhe përkufizimet e arsimit gjithëpërfshirës, shfaqni videon "Thuaj Po" dhe vijoni me ushtrimin ku pjesëmarrësit ndajnë reflektimet e tyre.

Çfarë të thoni

“Tani do të shihni një video për një vajzë që quhet Tima. Ju lutem kushtojni vëmendje të veçantë përvojës që ka kaluar në shkollë, pasi do t’ju bëj disa pyetje mbi reflektimet tuaja.

Çfarë të shfaqni

Shfaqni videon “Thuaj Po”: https://www.youtube.com/watch?v=bP_f5oWth1E

Çfarë të thoni

“Po ju le pak kohë të mendoni dhe të reflektoni individualisht për videon që patë, pa diskutuar me njëri-tjetrin. (1 minutë reflektim)

Çfarë të thoni

“Tani le t’i kthehemi fletës së punës për arsimin gjithëpërfshirës, për t’iu përgjigjur P2:

- Si reaguat ndaj videos?
- Si u ndjetë?”

Çfarë të bëni

Lëruni pjesëmarrësve 5 minuta kohë për t’u përgjigjur, dhe 2-3 prej tyre duhet t’i ndajnë reagimet dhe ndjenjat që patën kur panë videon.

Më pas, nxitini pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës nga pikëpamja e fëmijëve me aftësi të kufizuara si Tima, të cilët janë të predispozuar ndaj përjashtimit.

Çfarë të shfaqni

P2:

Si reaguat ndaj videos?
Si u ndjetë?

Çfarë të thoni

“Gjatë dekadave të fundit, në botë janë krijuar shumë praktika të mira ndaj arsimit gjithëpërfshirës. KDPAK-ja ofron një udhëzues të gjithanshëm për të mbështetur përfshirjen e plotë dhe shumë vende i kanë harmonizuar dhe vazhdojnë t’i harmonizojnë politikat dhe parimet themelore të arsimit gjithëpërfshirës. Megjithatë, ende ka shumë vështirësi, pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive. Përse fëmijët vazhdojnë të përballen me vështirësi në aksesin ndaj arsimit gjithëpërfshirës?”

Çfarë të bëni

Prezantoni faqen e prezantimit e radhës dhe kërkojuni pjesëmarrësve t’i rikthehen fletës së punës për arsimin gjithëpërfshirës për t’iu përgjigjur P3. Lejojuni 2 minuta për t’iu përgjigjur individualisht.

Me të mbaruar shumica, kërkojuni disa pjesëmarrësve të ndajnë përgjigjet e tyre derisa të dëgjoni fjalët kyçe (qëndrim,

Çfarë të shfaqni

P3: Cila mendoni se është barriera numër 1 për fëmijët me aftësi të kufizuara në aksesimin e arsimit gjithëpërfshirës?

qëndrim negativ). Nëse nuk i thonë këto fjalë, atëherë ju duhet t'iu kujtoni pjesëmarrësve se barriera më e madhe që hasi Tima ishte qëndrimi negativ.

Çfarë të bëni

Paraqitni faqen e prezantimit e radhës.

Shpjegoni se qëndrimet negative shpien drejt marginalizimit, diskriminimit dhe përjashtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Çfarë të shfaqni

Barriera Nr. 1

Qëndrim negativ

Vlerat gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 5 – Prezantimi i vlerave

Koha: 20 minuta (11:15 – 11:35)

Përmbledhje

Qëllimi

- Njohja e rëndësisë dhe domethënies së vlerave në arsimin gjithëpërfshirës.

Fokusi

- Prezantimi i domethënies së vlerave në arsimin gjithëpërfshirës. Theksi do të vendoset mbi faktin se gjithsecili është unik dhe se vlerat tona gjithëpërfshirëse na shtyjnë të zbatojmë arsimin gjithëpërfshirës.

Materiale

- Materiali 4, dita 1, Lulja me Vlerat Gjithëpërfshirëse, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
- Kompjuter, projektor dhe ekran
- Prezantimi 'TT, dita 1'

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

“Pikënisja për të adresuar qëndrimin negativ të njerëzve ndaj aftësisë së kufizuar janë vlerat gjithëpërfshirëse në cilat besojmë.”

Çfarë të bëni

Kaloni te faqja tjetër e prezantimit.


Çfarë të thoni

“Kjo thënie e Ghandi-t do t’ju shtyjë të mendoni për vlerat gjithëpërfshirëse. Në kuadrin e arsimit gjithëpërfshirës, thënia tregon se nuk duhet të prisni që zgjidhjet të vijnë nga të tjerët. Nëse vërejnë pabarazi ose padrejtësi në shkollë, janë mësuesit dhe drejtorët ata që ofrojnë zgjidhjet e duhura.

Arsimi gjithëpërfshirës fillon nga vetja. Është përgjegjësia jonë që të bëjmë zgjedhjen e duhur.”

Çfarë të shfaqni

Le të fillojmë me vlerat gjithëpërfshirëse



Çfarë të thoni

“Dua të ndaj me ju një poezi të shkruar nga një prind i një fëmije me aftësi të kufizuara. Është e thjeshtë, por e bukur.”

Çfarë të bëni

Lexojeni poezinë e shfaqur në PowerPoint.

Përsërisni 3 rreshtat e fundit ... “secili nga ne është i ndryshëm, i veçantë, dhe i bukur.”

Çfarë të thoni

“Çdo fëmijë është i ndryshëm, sepse...”

Çfarë të shfaqni

Një flutur në erë

Fëmija është si flutura në erë

Disa fluturojnë më lart Por secila bën më të mirën.

Përse t'i krahasojmë me njëra-tjetrën?

Secila është ndryshe.

Secila është e veçantë.

Secila është e bukur.



Çfarë të thoni

“Të gjithë jemi unikë. Të gjithë jemi të ndryshëm. Të gjithë jemi të barabartë.”

Nënvizoni se ky është mesazh kyç, të cilit do t’i ktheheni kur të diskutoni për praktikat gjithëpërfshirëse, pedagogjinë me në qendër fëmijët dhe Dizenjimin Universal të të Nxënës.

Çfarë të shfaqni

Të gjithë jemi unikë

Të gjithë jemi të ndryshëm. Të gjithë jemi të barabartë.



Çfarë të thoni


“Shpeshherë, nuk i dimë vlerat që kemi dhe si ndikojnë te veprimet tona. Pavarësisht nëse i dimë apo jo, të gjithë kemi vlera që ndikojnë te mënyra si veprojmë dhe ndërveprojmë në klasë dhe në shkollë.”

Zhvillimi i vlerave gjithëpërfshirëse me mësuesit është hapi i parë drejt zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm. Sipas studimeve ndërkombëtare, arsimi gjithëpërfshirës është edhe më i qëndrueshëm kur lidhet me bindjet e njerëzve. Ai funksionon plotësisht kur të gjithë mendojnë se është gjëja e duhur.”

Çfarë të bëni

Pasi të diskutoni lulen me vlerat gjithëpërfshirëse të Indeksit të Përfshirjes të Ainscow dhe Booth, shpërndajeni ilustrimin te të gjithë pjesëmarrësit si Materiali 4 – Dita 1

Çfarë të shfaqni



Vlerat e gjithëpërfshirjes
Indeksi për Gjithëpërfshirjen nga Ainscow dhe Booth

Ilustrimi 2: Materiali D: Lulja me vlerat gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 6 - Burri prej xhenxhefile

Koha: 25 minuta (11.35 – 12.00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Njohja me mënyrën se si e kuptojnë pjesëmarrësit rolin e tyre
- Identifikimi i vlerave gjithëpërfshirëse sipas pikëpamjes së pjesëmarrësve

Fokusi


- Ky aktivitet iu mundëson pjesëmarrësve të shprehin se çfarë kuptojnë me “të qenit gjithëpërfshirës”. Në këtë mënyrë do të kuptoni se çfarë do të thotë koncepti “arsim gjithëpërfshirës” për pjesëmarrësit, dhe do t’i përcaktoni vlerat gjithëpërfshirëse sipas pikëpamjes së pjesëmarrësve, çka do të mbështesë përgjegjësinë që ndiejnë ndaj vlerave dhe vizionit që do të krijojnë gjatë seancës.

Metoda

- Diskutim në grup

Materiale

- Vizatoni nga një burrë prej xhenxhefile (shihni ilustrimin 2) në tabelën me fletë të bardha për 4-5 pjesëtarë grupi, në varësi të numrit të grupit.
- Shirit ngjitës
- Lapustila
- Prezantimi 'TT, dita 1'



Hapat e aktivitetit

Çfarë të bëni

Ndajini pjesëmarrësit në grupe me 4-5 pjesëtarë. Secilit grup jepini disa lapustila dhe një fletë të bardhë, ku të keni vizatuar një burrë prej xhenxhefile. Me t'u formuar grupet, shfaqni faqet e prezantimit me udhëzimet e aktivitetit.

Çfarë të thoni

"Ju lutem mbyllini sytë. Mendoni për rolin tuaj si mësues ndihmës. Mund të mendoni për veten në veçanti, ose për profesionin në përgjithësi. Mendoni se çfarë bën mësuesi ndihmës, si sillet në klasë dhe në shkollë, si dhe çfarë thotë. Sapo të krijoni një imazh mendor të përfshirjes, hapini sytë. Diskutoni në grup për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimin që duhet të ketë mësuesi ndihmës për arsimin gjithëpërfshirës."

Çfarë të bëni

Paraqitini rezultatet e diskutimit, si vijon:

- Koka: Çfarë njohurish duhet të ketë mësuesi ndihmës?
- Zemra: Çfarë qëndrimesh duhet të ketë mësuesi ndihmës?
- Krahët dhe këmbët: Çfarë aftësish duhet të ketë mësuesi ndihmës?

Jepuni pjesëmarrësve 15 minuta kohë për aktivitetin. Më pas, të gjitha komentet varini në mur. Kërkojuni pjesëmarrësve të lexojnë punimet e njëri-tjetrit gjatë pushimit të drekës.

Çfarë të shfaqni

Burri prej xhenxhefile 1

Secili grup duhet të përfytyrojë një mësues gjithëpërfshirës dhe të diskutojë për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimin që duhet të ketë mësuesi ndihmës.

Grupet duhet të shkruajnë njohuritë në KOKË, aftësitë në KRAHË dhe këmbët, dhe qëndrimet në BARK.



Aktiviteti 7 - Burri prej xhenxhefile (vazhdim)

Koha: 30 minuta (13:00 – 13:30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Njohja me mënyrën se si e kuptojnë pjesëmarrësit rolin e tyre
- Identifikimi i vlerave gjithëpërfshirëse sipas pikëpamjes së pjesëmarrësve

Fokusi

- Ky aktivitet u mundëson pjesëmarrësve të shprehin se çfarë kuptojnë me “të qenit gjithëpërfshirës”. Në këtë mënyrë do të kuptoni se çfarë do të thotë koncepti “arsim gjithëpërfshirës” për pjesëmarrësit, dhe do t’i përcaktoni vlerat gjithëpërfshirëse sipas pikëpamjes së pjesëmarrësve, çka do të mbështesë përgjegjësinë që ndejnë ndaj vlerave dhe vizionit që do të krijojnë gjatë seancës.

Materiale

- Flipchart
- Shirit ngjitës
- Lapustila
- Prezantimi ‘TT, dita 1’

Metoda

- Diskutim në grup

Hapat e aktivitetit

Çfarë të bëni

Jepuni pjesëmarrësve disa minuta kohë më shumë për të lexuar punimet e njëri-tjetrit, nëse kanë nevojë. Diskutoni përse ka rëndësi ky aktivitet, duke u përqendruar tek ato që kanë shkruar pjesëmarrësit te zemra lidhur me qëndrimet. Shpjegoni se këto qëndrime pasqyrojnë vlerat e mësuesve gjithëpërfshirës.

Shtjelloni se mësuesit nuk janë mësuar duke e mbështetur punën mbi vlerat gjithëpërfshirëse. Madje ata mund të mos jenë në dijeni të vlerave që fshihen brenda tyre lidhur me arsimin dhe përfshirjen, si dhe të mënyrës se si ndikojnë te praktika në klasë dhe në shkollë.

Çfarë të bëni

Kërkojuni pjesëmarrësve të kthehen te grupet e tyre. Tregojuni faqen e prezantimit me pyetjet kyçe për diskutimin në grup. Kërkojuni të reflektojnë mbi diskutimet e deritanishme, mbi arsimin gjithëpërfshirës me bazë të drejtat dhe vlerat gjithëpërfshirëse. Sipas këtij reflektimi, pyetini se çfarë konsiderojnë rol kyç në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës. A përbën fokusin aktual të punës? Nëse po, kërkoni shembuj. Nëse jo, pyetini se çfarë mund të ndryshojnë. Cilat janë disa prej vështirësive që hasin?

Grupet kanë 15 minuta kohë për këtë aktivitet, dhe më pas dëgjoni përgjigjet e tyre. Jo të gjitha grupet do të bëjnë një prezantim të plotë.

Çfarë të shfaqni

Diskutim në grup

Pyetjet e diskutimit:

Duke marrë parasysh diskutimet e paradites, mbi arsimin gjithëpërfshirës me bazë të drejtat dhe vlerat gjithëpërfshirëse,

- Cili është roli juaj kyç si mësues ndihmës në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës?
- A përbën fokusin aktual të punës?
- Nëse po, jepni shembuj.
- Nëse jo, çfarë mund të ndryshoni?

Përkufizimi i aftësisë së kufizuar

Aktiviteti 8 – Prezantimi i aftësisë së kufizuar

Koha: 15 minuta (13:30 – 13:45)

Përmbledhje

Qëllimi

- Njohja me përkufizimin e aftësisë së kufizuar në KDKPAK
- Njohja me aftësinë e kufizuar si dukuri sociale komplekse

Fokusi

- Përkufizimi me bazë të drejtat i aftësisë së kufizuar

Materiale

- Prezantimi 'TT, dita 1'
- Kompjuter, projektor dhe ekran

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

“Paradite mësuam mbi konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Me miratimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) në vitin 2006, Shtetet Palë nga mbarë bota kanë bërë ndryshime në politika për të garantuar mbrojtjen e të drejtave individuale të personave me aftësi të kufizuara, si dhe zbatimin e pandërprerë të reformave afatgjata për të përmirësuar ndryshimet në sistemet, që mbështesin të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në kushte të barabarta me të tjerët.

Për ta kuptuar këtë çështje më në thellësi, duhet të dimë se kush i gëzon të drejtat kur bëhet fjalë për “personat me aftësi të kufizuara”.

Çfarë të thoni

“Sipas Neni 1 të KDKPAK-së... (lexoni faqen e prezantimit ku paraqitet përkufizimi dhe çështjet kyçe)

Çfarë të thoni

‘Ajo që e bën një person me aftësi të kufizuar është marrëdhënia e atij personi me barriera të ndryshme dhe mjedisin e tij/saj për shkak të një dëmtimi. Kështu, aftësia e kufizuar shihet nga një prizëm krejtësisht ndryshe. Më parë vëmendja i kushtohet vetëm karakteristikave

Çfarë të shfaqni

Neni 1 i KDKPAK-së

“**Personat me aftësi të kufizuara** përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

individuale, por tani fokus përbëjnë edhe barrierat në mjedisin përreth.

Çfarë të bëni

Përdorini shembujt në faqe prezantimi për të bërë dallimin midis “dëmtimit” dhe “aftësisë së kufizuar”.

Çfarë të thoni

“Përfshirja e faktorëve mjedisorë në përkufizimin e aftësisë së kufizuar e zhvendos vëmendjen nga “shkaku” tek “efekti” i aftësisë së kufizuar. Nuk mendohet më për kategorizimin sipas tipareve fizike, por për personin që fshihet pas emërtimit.

Çështjet kryesore në përkufizimin e KDPAK-së

- Rëndësia e faktorit mjedisor dhe kontekstual në përkufizimin e aftësisë së kufizuar
- Zhvendosja e fokusit nga shkaku tek efekti i aftësisë së kufizuar

Aftësia e kufizuar krijohet si dukuri sociale komplekse. Nevojitet zhvendosja e mendësisë nga tiparet fizike dhe kategorizimi me bazë dëmtimin drejt një koncepti më të gjerë që thekson personin që fshihet pas emërtimit.

Koncepti "aftësi e kufizuar" përfshin:

- Karakteristika individuale (dëmtim)

DHE

- Një barrierë sociale që pengon pjesëmarrjen e plotë në shoqëri

Shembull:

Dëmtim: Dëmtim fizik

+

Barrierë: Rrugë të pakalueshme, që e bëjnë të pamundur që një fëmijë në karrocë të shkojë në shkollë

=

Aftësi e kufizuar

Aktiviteti 9 - Barrierat

Koha: 45 minuta (13:45 – 14:30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Ndërgjegjësimi mbi barrierat dhe mundësitë që kanë fëmijët me aftësi të kufizuara

Fokusi

Identifikimi i barrierave dhe mundësive që kanë fëmijët me aftësi të kufizuara në kontekstin shqiptar

Materiale

- Flipchart
- Lapustila
- Shirit ngjitës
- Prezantimi ‘TT, dita 1’
- Materiali 5 – Dita 1: Rrathë barrierash dhe mundësish, 1 kopje për grup (4-5 pjesëtarë)
- Materiali 6 – Dita 1: Barrierat e mundshme të të nxëniet dhe pjesëmarrjes, 1 kopje për pjesëmarrës

Metoda

- Diskutim në grup

Hapat e aktivitetit

Çfarë të bëni

Kërkojuni pjesëmarrësve t'iu rikthehen grupeve të vogla dhe të flasin për fëmijët me aftësi të kufizuara që njihin. Këta fëmijë mund të jenë nga shkolla, nga lagja ose të afërm. Lëroni grupeve 5 minuta kohë për të zgjedhur një fëmijë, të cilin do ta analizojnë më në thellësi.

Kërkojuni pjesëmarrësit që e njih të japë më shumë informacione për fëmijën: kush është fëmija? Sa vjeç është? A është djalë apo vajzë? Ku jeton? Çfarë dini për familjen e këtij fëmije?

Çfarë të bëni

Shfaqni faqen e prezantimit me rrathët e barrierave dhe mundësive, dhe secilit grup shpërndajini një kopje të Materialit 5 – Dita 1: Rrathë barrierash dhe mundësish.


Kërkojuni grupeve të diskutojnë për barrierat dhe mundësinë që kanë fëmijët në nivelet e mëposhtme:

- Komunitet
- Shkollë
- Familje
- Fëmijë

Udhëzohjuni pjesëmarrësit të përdorin lapustilën **E KUQE** për barrierat dhe **TË GJELBRËN** për mundësitë

Jepuni grupeve 15 minuta kohë për të diskutuar

Çfarë të shfaqni



Ilustrimi i rrathëve të barrierave dhe mundësive.

Çfarë të bëni

Kërkojuni grupeve që të ndajnë me njëri-tjetrin barrierat dhe mundësitë, duke treguar kujdes që të mos përsërisin çfarë është thënë nga grupet e tjera, por vetëm të shtojnë elemente të reja. Mbani shënime në flipchart.

Filloni të analizoni diagramin me pjesëmarrësit. Gjatë diskutimit në grup mund të bëni pyetjet e mëposhtme:

- A ka më shumë barriera sesa mundësi?
- Cili nivel përmban më shumë barriera?
- Cili nivel përmban më shumë mundësi?
- Cilat janë barrierat më të shpeshta (barrierat që hasen më shumë në flipchart)?
- Cilat janë mundësitë më të shpeshta (mundësitë që hasen më shumë në flipchart)? A janë realiste në komunitetin dhe shkollën tuaj këto mundësi?
- Te cilat barriera mund të ndikojmë ne si mësues? Po me barrierat e tjera çfarë ndodh në këtë rast?

Pas diskutimit në grup, jepuni pjesëmarrësve një kopje të Materialit 6 – Dita 1: Barrierat e mundshme të të nxëniet dhe pjesëmarrjes. Verifikoni nëse është lënë ndonjë barriera pa përmendur. Diskutoni me pjesëmarrësit nëse barrierat që mungojnë, ekzistojnë në shkollën dhe komunitetin e tyre.

Modeli social i aftësisë së kufizuar

Aktiviteti 10 – Prezantimi i modelit social

Koha: 20 minuta (14:30 – 14:50)

Përmbledhje

Qëllimi

- Njohja me modelin social të aftësisë së kufizuar dhe si lidhet me aftësinë e kufizuar

Fokusi

Njohja me modelin social dhe mjekësor të aftësisë së kufizuar

Materiale

- Prezantimi 'TT, dita 1'

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktivitetit

Çfarë të bëni

Shfaqini faqet e prezantimit për të shpjeguar se çfarë është aftësia e kufizuar

Çfarë të thoni

“Modeli i aftësisë së kufizuar është një pikëpamje specifike mbi personat me aftësi të kufizuara. Ndikon te hartimi i politikave, shërbimet e disponueshme dhe ndërveprimi.

Modeli mjekësor, individual ose tradicional i aftësisë së kufizuar përqendrohet mbi individin, ose thënë ndryshe te fakti që personi ka probleme. Nuk merren parasysh as faktorët as barrierat mjedisore që kontribuojnë në mospjesëmarrjen e personit në shoqëri.

Këndvështrimi mjekësor ose individual i aftësisë së kufizuar i lë në hije dinamikën dhe kompleksitetin e qasjes me bazë të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar, pasi na bën që ta shikojmë personin nën optikën e

Çfarë të shfaqni

Modeli Mjekësor i Aftësisë së Kufizuar

Perceptimi i personave me aftësi të kufizuara	<ul style="list-style-type: none">Personat me aftësi të kufizuara, shihen si 'pacientë', si njerëz me kufizime ose defekte që duhen kuruarAftësia e kufizuar shihet si një problem i personit
Lloji i mbështetjes	Mbështetja për personat me aftësi të kufizuara ofrohet në qendra speciale dhe të veçuara, ku specialistët fokusohen në rehabilitimin dhe trajtimin e tyre.
Avantazhet	Kjo mënyrë e të menduarit e ka shtuar disi njohuritë në fushën mjekësore
Disavantazhet	<ul style="list-style-type: none">Ndarja e personave me aftësi të kufizuara nga familjet e tyre dhe ngajeta në komunitetMohimi i të drejtës themelore për t'u rritur në një familje dhe për të qenë anëtarë të shoqërisë me të drejta të plota.Në shumë vende: cilësi e dobët e kujdesit dhe arsimin në mjedis të posaçme dhe rreziki i lartë për abuzim dhe dhunëRëndësia e madhe që i kushtohet termit 'defekt' ka ndikim negativ në vetëbesimin e këtyre personave.

Çfarë është modeli i aftësisë së kufizuar?

Këndvështrim tipik i aftësisë së kufizuar, personave me aftësi të kufizuar, familjeve, aftësive dhe nevojave të tyre


Modeli aktual ndikon te politikat kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me personat me aftësi të kufizuara dhe llojin e mbështetjes që përfitojnë

gjendjes/diagnozës mjekësore. Në këtë mënyrë, personin e etiketojmë sipas aftësisë së kufizuar.”

Çfarë të bëni

Shfaqini 2 faqet e prezantimit e radhës për të shpjeguar ndikimin e modelit mjekësor mbi arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Modeli Mjekësor: Ndërlikimet për t'u arsimuar



Vështirësitë me pikëpamjet individuale mbi nevojat arsimore të veçanta

- Etiketimi shpie drejt pritshmërive më të ulëta ndaj fëmijës
- Përforcon idenë se të gjithë fëmijët në një nëngrup duhet të mësojnë në një mënyrë dhe me burime të veçanta
- Ul vetëbesimin e mësuesve të përgjithshëm
- Fokusi individual shpie drejt humbjes së mundësive për të përmirësuar shkollën për të gjithë
- Fëmijët me aftësi të kufizuara veçohen nga fëmijët e tjerë

Çfarë të bëni

Shfaqni faqet e prezantimit për të shpjeguar modelin social të aftësisë së kufizuar

Çfarë të thoni

‘Nëse me anë të arsimit gjithëpërfshirës duam t'i ndihmojmë fëmijët si Tima në videon që pamë, duhet të ndryshojmë këndvështrimin mbi aftësinë e kufizuar. Duhet të harrojmë modelin mjekësor tradicional të aftësisë së kufizuar dhe të shkojmë drejt modelit social.

Ndryshimi i paradigmës është i nevojshëm, sepse¹

- Nuk janë vetëm fëmijët me

Çfarë të shfaqni

Aftësia e kufizuar sipas kuptimit të modelit social

Perceptimi ndaj personave me aftësi të kufizuara	<ul style="list-style-type: none"> • Persona me aftësi të kufizuara shihen si qytetarë me të drejta dhe përgjegjësi • Aftësia e kufizuar konsiderohet si tipar dallues të njerëzve, siç konsiderohet gjinia, etnia, feja dhe kombësia n • Problemi qëndron te shoqëria, jo tek individi
Lloji mbështetjes	<ul style="list-style-type: none"> • Personat me aftësi të kufizuara marrin mbështetje nga shërbimet e zakonshme me anë të dizanjimit universal, të përshtatura sipas nevojave e tyre
Avantazhet	<ul style="list-style-type: none"> • Respektimi i të drejtave themelore të personave me aftësi të kufizuara • Vlerësimi i diversitetit në komunitet • Shërbimet miqësore ndaj aftësisë së kufizuar janë shërbime më të mira për të gjithë

aftësi të kufizuara që hasin vështirësi të nxëni në shkollë, por edhe shumë fëmijë të tjerë.

- Këto vështirësi mund të sjellin mënyra për të përmirësuar mësimdhënien.
- Përmirësimi mund të shpjerë drejt kushteve më të mira të të nxënit për të gjithë fëmijët.
- Mësuesit duhen mbështetur në krijimin e praktikave gjithëpërfshirëse (në vend që të mundësohen specialistë për t'i trajtuar fëmijët me aftësi të kufizuara veçmas).

Është me rëndësi të nënvizohet fakti se nëse problem konsiderohet arsimit, dhe barrierat në akses dhe pjesëmarrje fillojnë të adresohen, sistemi arsimor nuk do të përmirësohet vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara, por për të gjithë. Shkollat gjithëpërfshirëse janë shkolla cilësore për të gjithë. Në Programin 3 dhe 4, do të analizojmë se si pedagogjia dhe klasat gjithëpërfshirëse mbështetin të nxënit e efektshëm për të gjithë fëmijët.

Modeli social Ndërlidhimet për arsimin



Bindjet kyçe

- Nuk janë vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara që hasin vështirësi të nxëni në shkollë, por edhe shumë fëmijë të tjerë.
- Këto vështirësi mund të sjellin mënyra për të përmirësuar mësimdhënien.
- Përmirësimi mund të shpjerë drejt kushteve më të mira të të nxënit për të gjithë fëmijët.
- Mësuesit duhen mbështetur në krijimin e praktikave gjithëpërfshirëse (në vend që të mundësohen specialistë për t'i trajtuar fëmijët me aftësi të kufizuara veçmas).
- Dizenjimi universal dhe pedagogjia me në qendër fëmijën garanton arsimim cilësor për të gjithë fëmijët

Aktiviteti 11 - Modelet e aftësisë së kufizuar – reflektim

Koha: 25 minuta (14:50 – 15:15)

Përmbledhje

Qëllimi

- Ofrimi i kohës për të reflektuar me qëllim përpunimin e njohurive të reja mbi modelin mjekësor dhe social të aftësisë së kufizuar

Fokusi

- Reflektimi mbi modelet mbizotëruese në Shqipëri

Materiale

- Flipchart
- Lapustila
- Shirit ngjitës

Metoda

- Diskutim në grup

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

Në këtë aktivitet do t'ju lëmë kohë dhe hapësirë për të reflektuar mbi modelet e aftësisë së kufizuar. Reflektimi ju ndihmon të përpunoni njohuritë e reja dhe mbështet procesin e të nxënit.

Çfarë të bëni

Ndajini pjesëmarrësit në grupe me 4-5 pjesëtarë.

Shfaqni slide-in me pyetjet kyçe për diskutimin në grup. Sigurohuni që pyetjet kyçe i kanë kuptuar të gjithë. Lëroni grupeve 10 minuta kohë për të diskutuar. Secilit grup duhet t'i jepet një flipchart dhe lapustilë për të bërë përmbledhjen e diskutimit.

Çfarë të shfaqni

Reflektim mbi modelet e aftësisë së kufizuar

Pyetje kyçe për diskutimin në grup:

- Cili nga modelet e aftësisë së kufizuar mbizotëron në Shqipëri?
- Përse?
- Çfarë nënkupton për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri?

Çfarë të bëni

Pasi të kenë përfunduar me përmbledhjen e diskutimit, udhëzoni grupet t'i varin fletët e flipchart-it në mur dhe t'i paraqesin punimet e tyre. Sigurohuni që grupet nuk përsërisin njëri-tjetrin.

Reflektim dhe përpunim

Aktiviteti 12 – Fletë pune për arsimin gjithëpërfshirës

Koha: 20minuta (15:30 -15:50)

Përmbledhje

Qëllimi

- Reflektim mbi njohuritë e përvetësuara sot

Fokusi

- Vërtetimi se gjithëpërfshirja e plotë e një fëmije me aftësi të kufizuara bëhet e mundur edhe me burime shumë të pakta dhe pa bërë asnjë ndryshim në kurrikulë.

Materiale

- Materiali 2 – Dita 1: Fletë pune për arsimin gjithëpërfshirës, e shpërndarë në aktivitetin 3
- Kompjuter, projektor dhe ekran
- Videoja e Sarës "W-DARE": <https://www.youtube.com/watch?v=qx2gWjEVcnM>
- Prezantimi 'TT, dita 1'

Metoda

- Video dhe reflektim individual

Hapat e aktivitetit

Çfarë të thoni

“Tani do t’ju tregoj një video mbi historinë e një vajze me emrin Sara. Gjatë këtij kursi treditor trajnimi, do të shfaqim shumë videoklipe nga shkollat e vendeve të tjera, që e kanë zbatuar me sukses arsimin gjithëpërfshirës. Shumë nga këto videoklipe janë xhiruar në vendet me të ardhura të mesme dhe të ulëta. Janë përzgjedhur me kujdes për të treguar se arsimi gjithëpërfshirës nuk kushton shumë dhe mund të zbatohet edhe në mjedise me burime të kufizuara. Kjo gjë është e rëndësishme pasi shkollave nuk iu duhet të presin për t’u financuar nga qeveria për të filluar me krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse. Krahas kësaj, vlen edhe për shkollat në fshatra më të vogla ose më të thella, që kanë më pak burime sesa qytetet e mëdha.

Çfarë të shfaqni

Shfaqni videon W-DARE të Sarës: <https://www.youtube.com/watch?v=qx2gWjEVcnM>

Çfarë të thoni

“Po ju lë pak kohë të mendoni dhe të reflektoni për videon që patë.” (2 minuta reflektim)

Çfarë të thoni

“Ju lutem referojuni fletës së punës për arsimin gjithëpërfshirës dhe përgjigjuni pyetjeve.”

Çfarë të bëni

Lexoni P4 në slide. Pjesëmarrësit kanë 3 minuta kohë për t’u përgjigjur. Shpjegojuni se nuk duhet të diskutojnë në grup, por të reflektojnë individualisht.

Çfarë të shfaqni

P4

Çfarë mendoni se e bëri të mundur pjesëmarrjen e suksesshme të Sarës në një klasë me orë mësimore të rregullta?

Çfarë të thoni

"Gjatë kësaj seance diskutuam mbi shumë informacione për aftësinë e kufizuar sipas modelit social. Tani shtrohet pyetja..."

Çfarë të bëni

Shfaqni P5 dhe lexojeni. Pjesëmarrësit kanë 5 minuta kohë për t'u përgjigjur. Shpjegojuni se nuk duhet të diskutojnë në grup, por të reflektojnë individualisht.

Çfarë të shfaqni

P5

Çfarë mësuat nga seanca e sotme dhe si do të ndikojë në praktikën tuaj? Citoni 3 pika veprimi.

Aktiviteti 13 - Reflektimi

Koha: 20 minuta (15:50 – 16:10)

Përmbledhje

Qëllimi

- Lejimi i pjesëmarrësve të përpunojnë njohuritë që përvetësuan në seancën e sotme mbi arsimin gjithëpërfshirës
- Analiza nga ana e pjesëmarrësve nëse ka ndryshuar ndonjë ndjenjë apo bindje

Fokusi

- Vërtetimi se arsimi gjithëpërfshirës është rrugëtim ose proces.

Materiale

- Laptop, projektor, ekran
- Prezantimi 'TT, dita 1'

Metoda

- Reflektimi individual dhe shkëmbimi

Hapat e aktivitetit

Çfarë të bëni

Si përmbyllje të Ditës 1, lejojini pjesëmarrësit të reflektojnë mbi ato çka kanë mësuar për arsimin gjithëpërfshirës duke rishikuar Fletën e Punës për Arsimin Gjithëpërfshirës (Materiali 2 – Dita 1). Jepuni 5 minuta kohë për rishikim dhe drejtojuni pyetjet në slide

Për secilën pyetje, kërkojuni 2-3 vullnetarëve t'i ndajnë përgjigjet me grupin.

Çfarë të shfaqni

Pyetje për reflektim individual

- A ka ndryshuar mendimi juaj për arsimin gjithëpërfshirës në fillim (siç keni shkruar në P1 te fleta e punës) dhe tani, pas Ditës 1 të trajnimit?
- Çfarë "mësimesh të reja" keni nxjerrë për arsimin gjithëpërfshirës pas Ditës 1 të trajnimit?
- A do të ndryshonit diçka në punën tuaj si mësues ndihmës, mbështetur nga mësimet që nxorët sot?

Aktiviteti 14 – Përmbledhja dhe mesazhet kyçe

Koha: 20 minuta (16.10 – 16.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Përmbledhja e mësimeve të ditës

Fokusi

- Theksimi i mesazheve kyçe

Materiale

- Laptop, projektor, ekran
- Prezantimi 'TT, dita 1'

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktivitetit

Çfarë të bëni

Përmbledhni mësime të ditës duke shfaqur slide-et në vijim

Çfarë të shfaqni

Përmbledhje

Pasoja e arsimit gjithëpërfshirës me bazë të drejtat mbi mësuesit ndihmës:

- Puna e mësuesve ndihmës zhvillohet në shkolla dhe klasa të zakonshme
- Përfshin identifikimin dhe heqjen e barrierave të të nxënësve dhe pjesëmarrjes
- Fokusi nuk është mësime individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara për t'u siguruar se do të kapin ritmin e bashkëmoshatarëve pa aftësi të kufizuara
- Mësuesve ndihmës nuk iu kërkohet të bëhen "mësues të posaçëm", që ulen pranë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përqendrohet vetëm tek ata
- Detyra e mësuesve ndihmës është të bashkëpunojnë me mësuesit e zakonshëm për të përshtatur mjedisin e klasës, pedagogjinë, kurrikulën, mjetet ndihmëse për të nxënësit, në mënyrë që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe të mësojnë
- Përfshin punën me mësuesit, prindërit, fëmijët dhe komunikimin për ta kuptuar më mirë arsimin gjithëpërfshirës dhe për të adresuar qëndrimet negative

Mesazhet kyçe

- Të gjithë fëmijët kanë të drejtën themelore të frekuentojnë shkollën e zakonshme të lagjes dhe të mësojnë me bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara
- Fokusi nuk është ndryshimi i fëmijëve, por ndryshimi i shkollave dhe sistemeve arsimore
- Duhet shmangur çfarëdolloj forme veçimi dhe përjashtimi
- Zbatimi i arsimit gjithëpërfshirës përfshin bashkëpunimin për të identifikuar dhe për të hequr barrierat e të nxënësve dhe pjesëmarrjes

Çfarë të bëni

Kontrolloni nëse ka pyetje në fletën e vendparkimit të cilave tashmë mund t'ju jepet përgjigje. Sipas nevojës, referojuni seancave në ditët e ardhshme për t'ju siguruar që çështjet do të adresohen më vonë gjatë trajnimit.

Materiale - Dita 1

Materiali 1 Dita 1: 'Le të njihemi' Bingo

Dita 1 – Konceptet kyçe

Aktiviteti 2 – Lojë për nxehje: Bingo

Flet më shumë se 1 gjuhë	Nuk i pëlqen pica	Mund të vrapojë deri në 10km	Ka një mace	Ka njohje personale me fëmijët me aftësi të kufizuara
Mund të luajë në një instrument muzikor	Këtë javë ka pastruar kuzhinën	Ka dëgjuar më parë për arsimin gjithëpërfshirës	Shkon në punë me biçikletë	Është mëngjarash
Ka frikë nga merimangat	Ka mësuar fëmijët me aftësi të kufizuara në klasën e tij/saj	Pi kafe çdo ditë	Ka qenë pjesë e një shfaqjeje teatrore	Ka 1 ose më shumë fëmijë
Ka bërë të mundur lehtësimin e një trajnimi	Njih një person të famshëm	Mban lente	Ka qenë pjesë e një trajnimi për mësuesit	Ka ose ka pasur një pseudonim
Ka lindur në mars	Di të bëjë punë me grep	Ka vizituar një shtet tjetër	I vesh këpucët pa lidhëse	I pëlqen tava e kosit

P1: Çfarë do të thotë për ju ARSIM
GJITHËPËRFSHIRËS?

P2: Cili ishte reagimi
juaj për videon?

P5: Çfarë keni mësuar nga
sesioni i sotëm dhe si do të
ndikojë në mësimdhënien
tuaj? Citoni 3 pika veprimi.

P4: Çfarë mendoni se e bëri të
mundur pjesëmarrjen e
suksesshme të Sarah-s në një
klasë të zakonshme?

P3: Cila mendoni se është
barriera numër 1 në aksesin e
arsimit gjithëpërfshirës për
fëmijët me aftësi të kufizuara?

P2: Si u ndjetë nga ky fakt?

Materiali 3 – Dita 1: Çfarë është arsimit gjithëpërfshirës?

Dita 1 – Konceptet kyçe

Aktiviteti 4 – Prezantim

Çdo fëmijë ka të drejtën e arsimit cilësor. Ky pohim mbështetet nga dokumente ligjore ndërkombëtare, si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriutⁱⁱ(OKB, 1948, f. 30)(OKB, 1948, f. 30), Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëveⁱⁱⁱdhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara^{iv}.

Neni 24 i KDPAK-së^v parashikon një përkufizim të dobishëm të arsimit gjithëpërfshirës. KDPAK-ja i njeh të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për arsim, dhe me qëllim garantimin e tyre pa diskriminim dhe në kushte të barabarta, shtetet nxiten të zbatojnë arsimin gjithëpërfshirës. Këtu përfshihet:

- Sigurimi që personat me aftësi të kufizuara nuk përjashtohen nga sistemi arsimor i përgjithshëm
- Sigurimi i aksesit ndaj arsimit fillor dhe të mesëm falas, cilësor dhe gjithëpërfshirës, në kushte të barabarta me të tjerët, në komunitetet ku jetojnë
- Plotësimi i arsyeshëm i kërkesave të individit
- Garantimi se personat me aftësi të kufizuara përfitojnë mbështetjen e nevojshme nga sistemi arsimor i përgjithshëm
- Ofrimi i masave mbështetëse të individualizuara në mjedise që maksimizojnë zhvillimin social dhe akademik, në përputhje me objektivin e përfshirjes së plotë

Arsimi gjithëpërfshirës **nuk** përfshin asnjë formë veçimi ose përjashtimi nga arsimi, si përfshirja e pjeshme ose arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të veçanta ose njësi të posaçme brenda shkollave të rregullta.

Megjithëse shpeshherë arsimi gjithëpërfshirës shihet si regjistrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të zakonshme, koncepti i tij është shumë më i gjerë. Arsimit gjithëpërfshirës synon reformimin e sistemit arsimor për të garantuar që politikat, kultura dhe praktikët i përgjigjen diversitetit dhe adresojnë të drejtat dhe nevojat e të gjithë fëmijëve të marginalizuar, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara. Të gjithë fëmijët kanë të drejtën e arsimit gjithëpërfshirës, përkrah bashkëmoshatarëve të tyre, në shkollat e komuniteteve vendore. Ndaj, arsimi përfshirës shkon përtej garantimit të aksesit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm, duke përmirësuar cilësinë e arsimit dhe duke ndryshuar strukturuar, në mënyrë që të gjithë fëmijët të mësojnë së bashku në të njëjtat shkolla.

Qeveria shqiptare ka punuar për përmirësimin e legjislacionit dhe politikave për të mbështetur arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, çka është vërtetuar me nënshkrimin e konventave dhe traktateve ndërkombëtare, në veçanti me ratifikimin e KDPAK-së në vitin 2012. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në vitin 1998 (ndryshuar në vitin 2012) parashikon bazën e përpjekjeve të vendit për të kaluar në një sistem arsimor më gjithëpërfshirës. Neni 18 garanton se qytetarët trajtojnë me barazi para ligjit dhe mbrohen nga diskriminimi "për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhë, përkatësive politike, fetare, filozofike, kushteve ekonomike, arsimit, statusit social apo prejardhjes." Ligji Nr. 18/2017 parashikon me detaje të drejtat dhe mbrojtjen e të gjithë fëmijëve, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në vitin 1998 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Neni 5 parashikon parimet e përgjithshme të ligjit ku fëmijët kanë të drejtën për "barazi dhe mosdiskriminim dhe se të gjithë fëmijët duhet të përfitojnë "shërbime të posaçme dhe të specializuara". Neni 18 përcakton të drejtën për arsim, ku fëmijët kanë akses në arsim cilësor, falas, që zhvillohet vazhdimisht, jodiskriminues, të sigurt dhe fleksibël. Të drejtat e të fëmijëve me aftësi të kufizuara të barabarta me të gjithë fëmijët e tjerë garantohen nga


Neni 32. Aksesit pa barriera në të gjitha shërbimet shtetërore, përshtatja e arsyeshme dhe pjesëmarrja në politikëbërje garantohet po ashtu. Neni 34 parashikon një sistem bashkërendimi, bashkëpunimi dhe harmonizimi të përpjekjeve të niveleve qendrore dhe vendore të qeverisë për të garantuar zbatimin e legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Ndonëse fokusi është mosdiskriminimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara, përdorimi i termit "fëmijë me aftësi të kufizuara" në Nenin 32 nuk e vë theksin te personi, por tek aftësia e kufizuar, duke forcuar etiketimin dhe stereotipat. Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" garanton të drejtën për arsimin për të gjithë nxënësit, pa asnjë formë diskriminimi, duke përfshirë aftësinë e kufizuar. Kjo shtjellohet në Nenin 6, që garanton të drejtën për arsim cilësor, mbrojtjen nga çfarëdolloj diskriminimi, ku të gjithë nxënësit, prindërit dhe partnerët arsimorë kontribuojnë dhe marrin pjesë në zhvillimin e institucionit arsimor. Nenet 17, 18 dhe 19 parashikojnë dispozita për shkollat jo të rregullta dhe "kujdes të veçantë" për "kategori të veçanta nxënësish", çka promovon përjashtimin dhe veçimin e nxënësve dhe është në kundërshtim me përkufizimin e gjithëpërfshirjes në KDKPAK.

Meqenëse arsimi gjithëpërfshirës është term i cili keqkuptohet shpeshherë, ndaj mendimet e pandryshueshme të njerëzve mund të shpjen drejt kuptimeve të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme^{vi} paraqiten disa qartësime:

Arsimi gjithëpërfshirës është ...	Arsimi gjithëpërfshirës nuk është ...
... një proces ndryshimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm në shkolla dhe sistemin arsimor, për ta bërë arsimin më mikpritës, miqësor ndaj nxënësve dhe të dobishëm për një mori njerëzish	... një projekt i njehershëm që mund të realizohet dhe të përfundohet brenda një afati të shkurtër kohor
...i përqendruar te ristrukturimi i kulturës, politikave dhe praktikave arsimore për t'iu përgjigjur llojeve të ndryshme të nxënësve , si: mashkull, femër, me apo pa aftësi të kufizuara, i një etnie tjetër, me një gjuhë, besim fetar dhe gjendje financiare ndryshe, në mosha të ndryshme, si dhe me vështirësi të ndryshme shëndetësore, cenueshmërie, migracioni apo refugjati	...i përqendruar që të zhvillojë vetëm arsimim për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme
...i përqendruar te ndryshimi i sistemit arsimor, në mënyrë që të jetë mjaftueshëm fleksibël për të akomoduar çdo nxënësi	...i përqendruar te ndryshimi i nxënësit, që t'i përshtatet sistemit arsimor të pandryshueshëm
...një përpjekje e vazhdueshme për të identifikuar dhe për të hequr barrierat që i përjashtojnë nxënësit në çdo situatë unike	...i mbështetur te ndjekja e një seti veprimesh që mund të përdoren në çfarëdolloj situatë
...i përqendruar tek identifikimi dhe heqja e barrierave të nxënësve ndaj aksesit në arsim, pjesëmarrjes në procesin e të nxënësve, si dhe arritjet sociale dhe akademike	...i përqendruar thjesht te ofrimi i ndihmës që nxënësit të përfitojnë akses në shkollë ose në klasë
...një proces ku duhet të marrin pjesë të gjitha palët e interesit (mësuesit, nxënësit, prindërit, komuniteti, politikëbërësit qeveritarë, drejtuesit vendorë, OJF-të, etj.)	...një projekt që mund të zbatohet vetëm nga ekspertë ndërkombëtarë ose drejtues të arsimit
...diçka që mund të ndodhë si jashtë ashtu edhe brenda sistemit arsimor formal (arsimi gjithëpërfshirës mund të realizohet në hapësira të nxënësve joformale, alternative, me bazë komunitetin, etj., duke nisur nga fëmijë të vegjël deri te të moshuarit)	...thjesht një proces që realizohet në shkolla formale


Materiali 4 – Dita 1: Lulja e arsimit gjithëpërfshirës^{vii}

Dita 1 – Koncepte kyçe
Aktiviteti 5 –Prezantim



Materiali 5 – Dita 1: Rrathët e barrierave dhe mundësive

Dita 1 – Konceptet kyçe
Aktiviteti 7: Barrierat



Materiali 6 – Dita 1: Barrierat e mundshme ndaj të Nxënit dhe Pjesëmarrjes

Dita 1 – Konceptet kyçe

Aktiviteti 7: Barrierat

Barrierat në nivelin e fëmijës

Ndonëse në nivelin e fëmijës mund të identifikohen disa barrierat, që vështirësojnë aksesin në arsim dhe të nxënit, duhet theksuar se përgjegjësia e mosvajtjes apo mosnxënies nuk bie mbi fëmijën. Çdo fëmijë, pavarësisht prejardhjes apo kushteve sfiduese të jetesës, ka gjithmonë të drejtën për arsim. Është përgjegjësia e shkollës dhe e komunitetit që të identifikojnë dhe të adresojnë barrierat me të cilat mund të përballen fëmijët në aksesimin e arsimit. Një koment që dëgjohet shpeshherë është "fëmija nuk dëshiron të shkojë në shkollë". Kjo mund të jetë pikënisje e rëndësishme për diskutim dhe reflektim mbi arsyen përse fëmija nuk dëshiron të shkojë në shkollë dhe se çfarë mund të bëjë shkolla dhe komuniteti për ta ndryshuar.

Nevoja për punë

Disa fëmijë mund të ndihen nën trynë për të kontribuar për jetën e familjes në vend që të shkojnë në shkollë. Këto familje dhe fëmijë zakonisht nuk i vjelin përfitimet afatgjata të arsimimit, pasi mund të jenë shumë të varfër dhe mund të kenë nevojë për të ardhura shtesë për të mbijetuar, ose mund të preken nga konfliktet politike. Disa nga fëmijët që punojnë kanë pak ose aspak kontakte me familjet dhe jetojnë në rrugë, si dhe janë në rrezik të lartë shfrytëzimi dhe abuzimi.

Sëmundje dhe uri

Fëmijët nuk mësojnë mirë nëse janë të sëmurë, të uritur ose të kequshqyer. Shpeshherë mungojnë në shkollë dhe mund të klasifikohen si "nxënës të ngadaltë". Nëse nuk iu jepet vëmendja e nevojshme, mund të ndihen sikur nuk janë pjesë e klasës dhe mund ta braktisin shkollën. Efektet e sëmundjes ose kequshqyerjes mund të kenë pasoja gjatë gjithë jetën, nëse shkaktojnë dëme fizike ose intelektuale.

Certifikata e lindjes

Në disa vende, nëse nuk ka certifikatë lindjeje, fëmija nuk mund të regjistrohet në shkollë ose mund të lejohet disa vite shkollim. Nga kjo mund të preken veçanërisht vajzat, migrantët, personat nga pakicat kombëtare, grupet kulturore dhe refugjatët.

Frikë nga dhuna

Kur ka frikë se mund të dhunohet në shkollë, fëmija nuk e frekuenton. Me dhunë nënkuptohet bullizmi, agresioni fizik (rrahja), agresioni verbal, si dhe abuzimi apo ngacmimi seksual.

Aftësia e kufizuar

Në disa vende, shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk janë në shkollë, veçanërisht kur shkollat dhe sistemet arsimore nuk kanë as politika as programe për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këta fëmijë mund të mos kenë shkuar kurrë në shkollë, për shkak të qëndrimeve dhe bindjeve negative se nuk mund të mësojnë. Prindërit dhe komuniteti mund të mos jenë në dijeni të faktit se këta fëmijë kanë të drejtë të arsimohen dhe duhet të shkojnë në shkollë. Ata fëmijë me aftësi të kufizuara që shkojnë në shkollë rrezikojnë më shumë braktisjen, sepse arsimi dhe infrastruktura nuk i plotësojnë nevojat e tyre.

Shtatzënia

Në disa vende dhe komunitete, vajzat që mbeten shtatzënë përjashtohen nga shkolla dhe nuk iu lejohet të kthehen.

Barrierat në nivelin e familjes

Njësoj si me barrierat në nivelin e fëmijës, as në këtë nivel nuk është me vlerë që të "fajësohen" prindërit sepse nuk i çojnë fëmijët në shkollë. Shpeshherë, fakti që "prindërit nuk duan t'i çojnë fëmijët në shkollë" shihet si i pandryshueshëm. Megjithatë, shërben si mundësi për të reflektuar mbi arsyen përse prindërit nuk duan t'i çojnë fëmijët në shkollë dhe çfarë mund të bëjë shkolla dhe komuniteti për ta adresuar këtë fakt.

Varfëria dhe vlera praktike e arsimit

Barra financiare shpeshherë e bën të pamundur që prindërit të ofrojnë kushtet bazë të jetesës, ndaj fëmijët duhet të sjellin të ardhura në shtëpi, duke sakrifikuar arsimimin dhe të ardhmen e tyre. Kjo ndodh veçanërisht në familjet që mendojnë se arsimi nuk ka vlerë në jetën e përditshme. Krahas kësaj, prindërit mund të besojnë se fëmijëve do t'ju ofrohet arsim jociësor, dhe aftësitë që do të përvetësojnë në punë të ndryshme do të jenë më të vlefshme sesa ato që do të përvetësojnë në shkollë.

Kujdes i papërshtatshëm

Për shkak të nevojës për të fituar para, prindërit mund të detyrohen të largohen nga shtëpia për një periudhë afatshkurtër ose afatgjatë. Si rrjedhojë, mund t'i lënë fëmijët nën kujdesin e gjyshërve apo personave të tjerë, të cilët mund të mos kenë njohuritë, përvojën ose burimet për t'iu ofruar fëmijëve kujdes të qëndrueshëm. Ata mund të mos e vlerësojnë as arsimimin në çastin kur iu duhen para, si dhe disa prindër mund të shndërrohen në kujdestarë të papërshtatshëm kur krijojnë varësi ndaj alkoolit ose lëndëve narkotike.

Diskriminimi dhe stigmatizimi për shkak të HIV/SIDA

Fëmijët prindërit e të cilëve kanë ndërruar jetë prej SIDA-s kanë më pak gjasa të shkojnë në shkollë sesa ata që nuk i kanë humbur prindërit. Në disa vende, fëmijët, sidomos vajzat, hiqen nga shkolla për t'u kujdesur për vëllezërit ose motrat që janë sëmurë, ose për t'i sjellë të ardhura familjes. Në raste të tjera, këta fëmijët mund të shihen si "sëmundje ngjitëse", ndaj edhe komuniteti dhe mësuesit i përjashtojnë nga shkolla në mënyrë aktive.

Barrierat në nivelin e komunitetit

Diskriminimi gjinor

Bindjet tradicionale për statusin dhe rolin e meshkujve kundrejt femrave mund ta kufizojë aksesin e vajzave në arsim. Në komunitetet ku femrat shihen si inferiore ndaj meshkujve, shpeshherë vajzat nuk shkojnë në shkollë, sepse duhet të bëjnë punët e shtëpisë. Prindërit nuk shohin asnjë arsye që të shpenzojnë para për të arsimuar vajzat e tyre.

Dallimet kulturore dhe traditat vendase

Fëmijët që vijnë nga familje që janë ndryshe nga komuniteti, në drejtim të gjuhës, fesë ose veçorive të tjera kulturore kanë më pak gjasa për të pasur akses në shkollë. Ndonjëherë, ata përfitojnë akses në mjedise arsimore të veçuara dhe nën standard, arsimimi jociësor dhe më pak materiale mësimore. Krahas kësaj, ata kanë edhe më pak mundësi për të vazhduar arsimin e lartë. Në disa komunitete, traditat vendase diktojnë që njerëzit duhet të fillojnë të punojnë që në fëmijëri, pa përfituar arsim cilësor.

Qëndrimet negative

Qëndrimet negative ndaj fëmijëve me prejardhje ndryshe, dhe sidomos ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, mund të jenë barriera më e madhe e përfshirjes së këtyre fëmijëve në shkollë. Qëndrimet negative gjenden në të gjitha nivelet: prind, komunitet, shkollë, mësues, zyrtarë qeveritarë, madje edhe te vetë fëmijët e marginalizuar. Frika, tabutë, turpi, padija dhe keqinformimi ndër të tjera, nxisin qëndrime negative ndaj fëmijëve dhe situatave në të cilat ndodhen. Këta fëmijë, madje edhe familjet e tyre, mund të fillojnë të vuajnë nga vetëvlërësimi i ulët, duke shmangur kështu ndërveprimin social dhe duke u shndërruar në anëtarë të padukshëm të komuniteteve të tyre, çka mund të shpjerë drejt përjashtimit nga shkolla.

Barrierat në nivelin e shkollës

Kostot (të drejtpërdrejta dhe të fshehura)

Shumë familje të varfra nuk i çojnë fëmijët në shkollë pasi nuk mund të përballojnë elemente si: pagesa e shkollës dhe e provimeve, kontributi për shkollën ose shoqatat prind-mësues, madje edhe kostot e librave, lapsave, uniformës ose transportit.

Vendndodhja

Në zonat rurale, nëse shkolla ndodhet larg komunitetit, fëmijët rrinë në shtëpi. Për sa iu përket vajzave në veçanti, largësia e shkollës nga shtëpia mund të jetë shkak për mosfrekuentim, pasi prindërit kanë frikë për sigurinë e tyre. Edhe fëmijët me aftësi të kufizuara mund të mos e frekuentojnë shkollën nëse nuk ka transport të përshtatshëm.

Oraret

Oraret dhe kalendari i shkollës mund të bien ndesh me oraret e punës së fëmijëve, ndaj ata "nuk mund të mësojnë dhe të fitojnë para njëkohësisht". Krahas kësaj, vajzat mund ta braktisin shkollën kur ndikon te përgjegjësitë familjare, si punët e shtëpisë apo kujdesi ndaj fëmijëve të vegjël.

Mjediset

Nëse në shkolla nuk ka mjedise të përshtatshme, fëmijët mund të mos e frekuentojnë. Për shembull, mungesa e tualeteve të veçanta ku adoleshentet janë me cikël mund të shkaktojë mosfrekuentimin e shkollës. Krahas kësaj, mjediset e papërshtatshme ndikojnë veçanërisht te fëmijët me aftësi të kufizuara.

Gatishmëria

Një nga arsyet më të zakonshme përse fëmijët me prejardhje dhe aftësi ndryshe përjashtohen nga shkolla është sepse as shkolla as mësuesit nuk janë të përgatitur për t'iu dhënë mësim. Ata nuk dinë se si t'i mësojnë, sepse nuk janë trajnuar, nuk kanë as idetë as informacionet e nevojshme për t'i ndihmuar këta fëmijë të mësojnë. Si rrjedhojë, edhe nëse vijnë në shkollë, këtyre fëmijëve mund t'iu kushtohet më pak vëmendje dhe mund t'iu ofrohet arsim më pak cilësor sesa fëmijëve të tjerë.

Përmasat e klasave, burimet dhe ngarkesa e punës

Klasat e mëdha janë të zakonshme në të gjitha vendet dhe mund të jenë barrierë për përfshirjen e fëmijëve me prejardhje dhe aftësi ndryshe. Mësuesit ndërmarrin ngarkesë më të madhe pune dhe janë të stresuar. Megjithatë, përmasat e klasave nuk janë domosdoshmërisht faktor i rëndësishëm për gjithëpërfshirjen efikase, nëse qëndrimi është pozitiv dhe mikpritës. Ka shumë shembuj të fëmijëve me prejardhje dhe aftësi ndryshe që përfshihen në klasa të mëdha me efikasitet. Barrierat e qëndrimit ndaj gjithëpërfshirjes të stafi dhe administratorët e shkollës shpeshherë janë më të mëdha sesa burimet e papërshtatshme të materialeve.

Dita 2 – Praktika gjithëpërfshirëse: Çfarë është një mësues ndihmës dhe si mund të krijojmë një mjedis të nxëni gjithëpërfshirës?

Vështrim i Përgjithshëm

Objektivat:

- Të qartësojmë rolin, përgjegjësitë dhe detyrat e mësuesit ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës
- Të reflektojmë mbi mënyrat se si të përmirësojmë bashkëpunimin me mësuesit e zakonshëm
- Të prezantojmë pedagogjinë me në qendër fëmijën dhe Dizenjimin Universal për të Nxënit si bazat për arsimin gjithëpërfshirës

Materiale përgatitore:

- Laptop
- Projektor
- Bokse
- Ekране të bardha
- Mikrofona
- Flipcharts
- Shirit ngjitës
- Stilolapsa
- Lapustila
- Letra me ngjitje për shënime (Post It)
- Letër në format A4
- Flipchart “vendparkimi” (për shënime shtesë)

Prezantime:

- ‘ToT Dita 2’
- Materialet:
 - Materiali 1 Dita 2 - Pedagogjia e veçantë ose me në qendër fëmijën, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 2 Dita 2, Karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 3 Dita 2, Stile të ndryshme të të nxënit, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 4 Dita 2, 1 parimet e DUN-së, 1 kopje për pjesëmarrës
 - Materiali 5 Dita 2, Këshilla për përshtatjen e mjediseve të të nxënit, 1 kopje për pjesëmarrës
- Videot:
 - Vështrim i përgjithshëm i DUN-së:
<https://www.youtube.com/watch?v=bDvKnY0g6e4>
 - Përmirësimi i mjedisit të të nxënit:
<https://www.youtube.com/watch?v=4cscJcRKYxA>
 - Pedagogjia me në qendër mësuesin kundrejt asaj me në qendër fëmijën:
<https://www.youtube.com/watch?v=I09uSOHAgP4>

Axhenda:

Koha	Tema	Aktivitet
09.00 – 09.30	Mirëseardhja dhe Prezantimi	Aktiviteti 1 – Hyrje (10min)
		Aktiviteti 2 – Lojë për nxemje: aeroplanët (20min)
09.30 – 10.30	Mësuesi ndihmës	Aktiviteti 3 Prezantimi i rolit të mësuesit ndihmës (20min)
		Aktiviteti 4 – Diskutimi i rolit dhe i përgjegjësive në grup (40min)
10.30 – 10.45	Pushimi i çajit	
10.45 – 11.40	Bashkëpunim	Aktiviteti 5 – Prezantim mbi bashkëpunimin (25 min)
		Aktiviteti 6 – Diskutim në grup (30 min)
11.40 – 12.00	Pedagogjia me në qendër fëmijën	Aktiviteti 7 – Prezantim mbi rëndësinë e pedagogjisë me në qendër fëmijën (20min)
12.00 – 13.00	Dreka	
13.00 – 14.00	Pedagogjia me në qendër fëmijën (vazhdim)	Aktiviteti 8 – Prezantim mbi mënyrën e realizimit të pedagogjisë me në qendër fëmijën
14.00 – 15.00	Pushimi i çajit	
15.00 – 16.00	Dizenjimi Universal për të Nxënit	Aktiviteti 9 – Parimet bazë të DUN-së (20min)
		Aktiviteti 10 – Përshtatja e mjedisit të të nxënit (40min)
16.00 – 16.30	Reflektimi dhe përpunimi	Aktiviteti 11 – Reflektimi bashkëpunues (20min)
		Aktiviteti 12 – Përmbledhja dhe mesazhet kyçe (10min)

Hyrje

Aktiviteti 1 - Hyrje

Koha: 10 min (09.00 – 09.10)

Çfarë të bëni

Përdorni prezantimet në Powerpoint për të prezantuar:

- Objektivat për ditën e dytë
- Axhenda e trajnimit

Rikujtojini nxënësve 'vendparkimin'.

Aktiviteti 2 – Lojë për nxemje: Aeroplanët

Koha: 20min (09.10 – 09.30)

Vështrim i Përgjithshëm

Qëllimi

- Të thyejmë akullin përpara se të nisim aktivitetet
- Të krijojmë grupe të përziera për të nxitur diskutime midis pjesëmarrësve që nuk e njohin mirë njeri-tjetrin
- Të prezantojmë pedagogjinë me në qendër fëmijën

Fokusi

- Aktivitete argëtuese për të përzier grupet dhe për të demonstruar metoda të ndryshme të mësimdhënies

Materiale

- Letër në format A4
- stilolapsa

Metoda

- Loja

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Kërkojuni pjesëmarrësve të pajisen me letër dhe stilolaps. Jepuni udhëzime se si të përgatisin një aeroplan me letër. Sigurohuni që çdo pjesëmarrës të shkruajë emrin e tij të plotë në aeroplan. Pjesëmarrësit mund t'i vizatojnë aeroplanët sipas dëshirës.

Jepuni pjesëmarrësve pak minuta kohë për të përfunduar aeroplanët. Pasi të gjithë të kenë përfunduar, kërkojuni të ngrihen në këmbë. Kërkojuni të gjithë pjesëmarrësve të hedhin aeroplanët sa më larg të jetë e mundur, duke synuar pjesën e përparme të sallës së mbledhjes.

Zgjidhni në mënyrë rastësore 4 ose 5 aeroplanë. Lexoni me zë të lartë emrat e shkruar mbi to. Kështu, emrat e personave që do të lexohen do të formojnë grupet e diskutimit për ditën e sotshme.

Çfarë të thoni

'Aktivitete të tilla të shkurtra, të cilat janë pjesë e pedagogjisë me në qendër fëmijën, mund të përdoren edhe në klasë. Këto lloj aktivitetesh e bëjnë procesin e të nxënësve argëtues dhe aktiv. Ato mbështesin idenë se nxënësit nuk duhet që thjesht të qëndrojnë ulur dhe të dëgjojnë gjatë gjithë ditës. Të nxënësve bashkëpunues përbën një nga aspektet kyçe të pedagogjisë me në qendër fëmijën. Loja me aeroplanë mund të ndihmojë në përzierjen e grupeve. Kjo gjë mund të jetë e dobishme për t'iu dhënë fund stereotipeve negative (për shembull: roli drejtues merret gjithmonë nga të njëjtët nxënës), si dhe për të nxitur krijimin e raporteve midis nxënësve të ndryshëm. Loja me aeroplanë mund të përdoret në mënyra të ndryshme. Për shembull, nxënësit mund t'i shkruajnë përgjigjet e pyetjeve tek aeroplanët dhe më pas t'i hedhin ato larg. Ndryshe, mund t'u kërkonte të vizatojnë ose të shkruajnë mendimet e tyre tek aeroplanët, të cilët mund të zgjidhen dhe të komentohen nga fëmijët e tjerë. Në vazhdimësi sot, do të diskutojmë më shumë rreth pedagogjisë me në qendër fëmijën.

Mësuesi ndihmës

Aktiviteti 3 - Prezantimi i rolit të mësuesit ndihmës

Koha: 20 minuta (09.30 – 09.50)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të qartësojmë rolin, përgjegjësitë dhe detyrat e mësuesit ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës

Fokusi

- Roli i mësuesit ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës

Materiale

- Prezantimi: 'ToT, dita 2'
- Laptop, projektor

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Paraqitni dhe shpjegoni faqet e prezantimit në Power Point mbi rolin e mësuesit ndihmës (mësuesit e arsimit gjithëpërfshirës) në arsimin gjithëpërfshirës.

Çfarë të shfaqni

Roli i mësuesit ndihmës në AGJ

- Garantimi i aksesit të barabartë në arsimin e cilësisë së lartë për fëmijët me aftësi të kufizuara, në të njëjtat nivele me fëmijët e tjerë
- Mbështetja e shkollave në krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse, të sigurta, stimuluese dhe mbështetëse

Përgjegjësitë dhe detyrat

- Promovimi i ecursisë, përfshirjes dhe mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Mbështetja e shkollave në njohjen dhe përmbushjen e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Puna me drejtorin e shkollës dhe mësuesit e tjerë për garantimin e përshtatjeve të arsyeshme dhe marrëveshjeve për akses për fëmijë me aftësi të kufizuara është duke u realizuar
- Mbështetja e monitorimit dhe rishikimi i ecursisë dhe arritjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Ofrimi i mbështetjes në mësimdhënie (duke përfshirë mësimdhënien në bashkëpunim, mësimdhënien në grupe të vogla dhe modelimin e strategjive të mësimdhënies), për garantimin e aksesit të barabartë në kurrikulën kombëtare për të gjithë fëmijët
- Zhvillimi dhe përshtatja e metodave të mësimdhënies mbi përmbushjen e nevojave individuale të nxënësve

	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat</p> <p>Zhvillimi dhe përmirësimi i mësimdhënies së të tjerëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshillimi dhe mbështetja e zhvillimit të politikave dhe praktikave mbarëshkollore dhe gjithëpërfshirëse • Këshillimi mbi zhvillimin dhe përdorimin e burimeve për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara • Mbështetja e planifikimit dhe ofrimit të trajtimit në detyrë për shkollat dhe partnerët e tjerë • Garantimi i zbatimit të efektshëm i Planeve për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës
	<p>Përgjegjësitë dhe detyra</p> <p>Promovimi i partneriteteve dhe praktikave të integruara të punës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe e familjeve të tyre në të gjitha konsultimet, që lidhen me ecurinë e tyre • Puna në bashkëpunim me profesionistë të tjerë mbi përmbushjen e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla • Marrëdhëniet e punës me profesionistë të tjerë, si: punonjës socialë, terapistë të të folurit dhe gjuhës, fizioterapistë dhe psikologë arsimorë • Puna e ngushtë me prindërit dhe kujdestarët ligjorë
	<p>Përgjegjësitë dhe detyra</p> <p>Ndërmarrja e detyrave të përgjithshme, duke përfshirë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Angazhimin për mbrojtjen dhe promovimin e mirëqenies emocionale të nxënësve • Organizimi i të nxënit jashtë klasës, në aktivitete si: vizita në komunitet, ekskursione jashtë shkollës ose evente sportive • Kryerja e detyrave administrative, duke përfshirë përditësimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave për ecurinë e nxënësve • Mësimdhënia individuale ose në grup brenda klasës • Përgatitja e mësimëve dhe burimeve • Vënia e notës dhe vlerësimi i punës së nxënësve
	<p>Koncepte të gabuara</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koncepti 1: Vetëm mësuesi ndihmës është përgjegjës për edukimin dhe progresin e të nxënit të fëmijëve me aftësi të kufizuara <p>Por: Të dy mësuesit janë përgjegjës për edukimin dhe progresin e të nxënit të të gjithë fëmijëve. Ata bashkëpunojnë për të planifikuar dhe realizuar aktivitete të nxënit për të gjithë fëmijët, si dhe vlerësojnë rezultatet e të nxënit dhe planifikojnë ndryshime në strategji sipas nevojës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Koncepti 2: mësuesi ndihmës i mënjanon fëmijët me aftësi të kufizuara nga klasa e zakonshme për t'u ofruar udhëzime të veçuara dhe individuale <p>Por: mësuesi ndihmës ofron mbështetje brenda klasës për të shmangur paragjykimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe që të marrë pjesë në aktivitetet e klasës së zakonshme me qëllim rritjen e ndjenjës së 'përkatësisë' në këtë klasë</p>

Koncepte të gabuara

- **Koncepti 3:** Mësuesi ndihmës ulet pranë fëmijës me aftësi të kufizuara dhe e ndihmon atë vetëm për të ndjekur udhëzimet e mësuesit të zakonshëm

Por: por mësuesit japin udhëzime dhe ofrojnë mbështetje për të gjithë klasën, grupe të vogla dhe individuale. Në këtë mënyrë, shmangen barrierat në komunikim ndërmjet fëmijës me aftësi të kufizuara dhe shokëve/shoqeve të klasës, redukton ndjesinë e izolimit dhe paragjykimin

- **Koncepti 4:** Vetëm mësuesi ndihmës është përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e CFSP-së

Por: mësuesi ndihmës mund të ketë rol lehtësues në procesin CFSP. Zhvillimi dhe realizimi i planit është përgjegjësi e përbashkët e ekipit të palëve të interesit

Aktiviteti 4: Diskutimi i rolit dhe i përgjegjësi në grup

Koha: 40 minuta (09.50 – 10.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të reflektojmë mbi rolin dhe detyrat aktuale, si dhe mbi ndryshimet e mundshme

Fokusi

- Roli i mësuesit ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës

Materiale

- Prezantimi: 'ToT, dita 2'
- Laptop, projektor
- Flipchart-e
- Lapustila
- Shirit ngjitës

Metoda

- Diskutim në grup

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Kërkojuni pjesëmarrësve të punojnë në grupe të vogla (grupet e formuara gjatë aktivitetit me aeroplanë). Shpërndajini secilit grup një flipchart, shirit ngjitës dhe lapustila. Shfaqni pyetjet në faqet e prezantimit për diskutimin në grup. Bëni me dije paraprakisht se prezantimi i punës së çdo grupi nuk duhet të zgjasë më shumë se 2 minuta.

Çfarë të shfaqni

Pyetje për diskutim në grup

- Cilat janë detyrat dhe roli juaj aktual në arsimin gjithëpërfshirës?
- Çfarë mund të bëni ndryshe për të përmirësuar realizimin e arsimit gjithëpërfshirës?
- Cilat janë disa prej sfidave në pozicionin tuaj aktual?
- Çfarë këshillash mund të ndani me kolegët tuaj për të realizuar arsimin gjithëpërfshirës?

Jepuni grupeve 25 minuta kohë për të diskutuar pyetjet kyçe. Sigurohuni që pyetjet dhe udhëzimet të jenë të qarta. Pas diskutimeve, kërkojini një anëtar të çdo grupi të diskutojë punimin. Për të shmangur vonesat, jini të rreptë në respektimin e kohës.

Bashkëpunim

Aktiviteti 5 – Prezantim mbi bashkëpunimin

Koha: 25 minuta (10.45 – 11.10)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të vendosim theksin mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve të zakonshëm dhe atyre ndihmës në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës.
- Të japim këshilla dhe modele për të përmirësuar bashkëpunimin

Fokusi

- Bashkëpunimi ndërmjet mësuesve të zakonshëm dhe atyre ndihmës

Materiale

- Prezantimi: 'ToT, dita 2'
- Laptop, projektor

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Shfaqni dhe shpjegoni faqet e prezantimit mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve të zakonshëm dhe atyre ndihmës në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Çfarë të shfaqni

Bashkëpunimi mësues i zakonshëm-mësues ndihmës

- Në mënyrë që gjithëpërfshirja të realizohet me sukses, është thelbësore që të gjithë partnerët të punojnë së bashku.
- Bashkëpunimi ndërmjet mësuesve ndihmës dhe mësuesve të zakonshëm është veçanërisht i rëndësishëm.
- Bashkëpunimi pa probleme brenda klasës do të rrisë cilësinë e arsimit për të gjithë fëmijët.

Këshilla

Le të njihemi

- Njihuni me rolet, përgjegjësitë dhe detyrat e njëri-tjetrit.
- Njihuni profesionalisht dhe personalisht

- Marrëdhënia e besimit përmirësojnë bashkëpunimin dhe realizimin e suksesshëm të arsimit gjithëpërfshirës
- Duke u njohur me pikat e forta dhe interesat e njëritjetrit, ndihmon në përdorimin më të mirë të burimeve të njerëzore të disponueshme.

Këshilla

Komunikim i qartë dhe i hapur

- Diskutoni rreth pritshmërive, vizioneve, ideve dhe metodës së preferuar të punës
- Hartoni një planifikim javor, mujor dhe vjetor.
- Organizoni të paktën një mbledhje ballë për ballë në javë, për të diskutuar për punën në klasë, ecurinë e nxënësve, strategjitë e klasës, përshtatjet dhe qëllimet
- Ruani komunikim të vazhdueshëm përmes email-it, telefonit ose mesazheve me tekst.

Këshilla

Kuptim i njëjtë i objektivave

- Zhvilloni kuptimin e njëjtë për arsimin gjithëpërfshirës:
- Të dy kolegët duhet të kuptojnë që qëllimi i bashkëpunimit të tyre është përfshirja e plotë e të gjithë nxënësve
- Të dy partnerët nuk presin që njëri prej tyre t'i ndajë fëmijët me aftësi të kufizuara
- Zhvilloni kuptimin e njëjtë për qëllimet e të nxënësve.
- Qëllimi është që të gjithë fëmijët të kenë akses në kurrikulën e së njëjtës cilësi të lartë, si dhe të përparojnë në procesin e të nxënësve.


Modelet e mësimdhënies në bashkëpunim

'Mësimdhënia hije', ku mësuesi ndihmës i qëndron pranë dhe e mbështet vetëm fëmijën me aftësi të kufizuara duhet shmangur sepse:

- Mësuesi i zakonshëm nuk mund të kuptojë plotësisht barrierat që përjeton fëmija për të ndjekur mësimet dhe kryer detyrat
- Mund të rrisë stigmën që rrethon fëmijët me aftësi të kufizuara
- Fëmijët me aftësi të kufizuara mund të bëhen të varur ndaj mësuesit ndihmës dhe do ta ndiejnë më pak nevojën, për të bashkëpunuar me nxënësit e tjerë në klasë
- Mësuesi mund të ndihet më pak përgjegjës për nxënësit me aftësi të kufizuara


Mësimdhënia në bashkëpunim është një mënyrë e mirë për të përdorur burimet njerëzore të disponueshme në klasë.

Njëri jep mësim, tjetri vëzhgon




Mësuesi ose mësuesi ndihmës drejton mësimin e një grupi të madh, tjetri vëzhgon për të mbledhur të dhëna mbi të nxënësit të nxënësve, stilit të mësimdhënies ose sjelljet dhe ndërveprimin në klasë

Mësimdhënia me grupe pune




Nxënësit ndahen në tri grupe (grupe me aftësi të përziera) Mësuesit ndërtojnë tri aktivitete ose grupe pune në klasë. Mësuesi i zakonshëm ndihmon grupin 1, mësuesi ndihmës grupin 2, ndërsa nxënësit e grupit 3 punojnë në mënyrë të pavarur.

Mësimdhënia paralele




Mësuesi dhe mësuesi ndihmës secili i japin të njëjtin mësim gjysmës së grupit. Mësimdhënia në grupe të vogla ndihmon në diferencimin më të madh dhe në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve.

Mësimdhënia alternative




Mësuesi ose mësuesi ndihmës punon me pjesën më të madhe të nxënësve, kurse tjetri punon me një grup më të vogël. Grupi më i vogël mund të fokusohet në përsëritjen e koncepteve kyçe, duke ofruar njohuri më të thella të përmbajtjes ose vlerësimit.

Ndarje në grup



Të dy, edhe mësuesi edhe mësuesi ndihmës, drejtojnë mësimdhënien në një grup të madh në të njëjtën kohë. Ata të dy lehtësojnë pjesë të ndryshme të mësimdhënies, përfaqësojnë perspektiva të ndryshme ose ilustrojnë mënyra të ndryshme të zgjidhurit të problemeve.

Njëri jep mësim, tjetri asiston



Mësuesi ose mësuesi ndihmës drejton mësimin për grupin e madh, ndërsa tjetri lëviz në klasë për t'iu dhënë ndihmë shtesë individëve ose grupeve të vogla. Ndihma shtesë mund t'i jepet çdo nxënësi, jo vetëm atyre me aftësi të kufizuara.

Aktiviteti 6 – Diskutim në grup

Koha: 30 minuta (11.10 – 11.40)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të reflektojmë së bashku me mësuesit mbi bashkëpunimin aktual, si dhe të diskutojmë mënyrat për të tejkaluar sfidat

Fokusi

- Bashkëpunimi ndërmjet mësuesve ndihmës dhe atyre të zakonshëm

Materiale

- Prezantimi: 'ToT, dita 2'
- Laptop, projektor
- Flipchart-e
- Lapustila
- Shirit ngjitës

Metoda

- Diskutim në grup

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Kërkojuni pjesëmarrësve të punojnë në të njëjtat grupe të vogla. Shpërndajini secilit grup një flipchart, shirit ngjitës dhe lapustila. Shfaqni pyetjet në faqet e prezantimit për diskutimin në grup. Bëni me dije paraprakisht se nuk do të ketë kohë për prezantime

Jepuni grupeve 15 minuta kohë për të diskutuar pyetjet kyçe. Sigurohuni që pyetjet dhe udhëzimet të jenë të

Çfarë të shfaqni

Pyetje për Diskutim në Grup

- Aktualisht, a keni hasur sfida në bashkëpunimin me mësuesit e zakonshëm? Çfarë sfidash? Përse?
- Mund të ndani disa këshilla me kolegët tuaj për përmirësimin e bashkëpunimit me mësuesit e zakonshëm?

qarta. Pas diskutimeve, kërkojuni grupeve të varin fletët e tyre të flipchart në mur. Nxitini pjesëmarrësit t'u hedhin një sy punimeve të njëritjetrit gjatë pushimit të drekës.

Pedagogjia me në qendër fëmijën

Aktiviteti 7 – Prezantim mbi rëndësinë e pedagogjisë me në qendër fëmijën

Koha: 20 minuta (11.40 – 12.00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të kuptojmë rëndësinë e pedagogjisë me në qendër fëmijën në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës

Fokusi

- Vëmendja e këtij prezantimi përqendrohet mbi faktin se nuk ekziston asnjë 'pedagogji e veçantë' për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nëse mësuesit aplikojnë pedagogjinë me në qendër fëmijën, do t'i lehtësojë ata që të mësojnë të gjithë fëmijët në një klasë gjithëpërfshirëse

Materiale

- Prezantimi – ToT, dita 2
- Laptop, projektor dhe ekran
- Materiali 1, dita 2 - Pedagogjia e veçantë ose me në qendër fëmijën, 1 kopje për çdo pjesëmarrës

Metoda

- Prezantim
- Lexim individual

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të thoni

'Ky prezantim përqendrohet në arsyen e zbatimit të pedagogjisë me në qendër fëmijën në klasat gjithëpërfshirëse. Hidhni një sy faqes së prezantimit dhe reflektoni mbi kuptimin e saj.'

Çfarë të shfaqni

Ideja që ka pedagogji speciale për fëmijët me aftësi të kufizuara është vetëm një mit.


Çfarë të bëni

Shpërndajuni pjesëmarrësve një kopje të materialit 1, dita 2, 'Pedagogjia e veçantë dhe me në qendër fëmijën' dhe më pas kërkojuni ta lexojnë atë individualisht. Nuk është e nevojshme që të lexohet me zë të lartë, pasi faqet vijuese të prezantimit japin një përmbledhje të përmbajtjes.

Çfarë të ndani

1. A janë nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara të veçanta apo të ndryshme?

Kjo pyetje na kthen pas të përkufizimit të arsimit gjithëpërfshirës dhe aftësisë së kufizuar në Programin e Arsimit Gjithëpërfshirës Bazuar në të Drejta. Në kreun 2.2 diskutuam 2 mënyrat e mënyrës në konsideratë të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Diskutuan dy këndvështrime:



Këndvështrimi individual mbështetet në supozimet e mëposhtme:

- Mund të identifikohet një grup fëmijësh që janë të veçantë apo të ndryshëm;
- Këta fëmijë kanë nevojë për mësimdhënie speciale që i përgjigjet problemit të tyre;
- Është më mirë që fëmijët me probleme të ngjashme të mësojnë së bashku;
- Fëmijët e tjerë janë normalë dhe përfitojnë nga format ekzistuese të shkollimit.

Në kreun 2.2 kemi diskutuar rezultatet negative të këtij këndvështrimi. Ai ul pritshmëritë ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe për pasojë ndikon negativisht në rezultatet e të nxënimit, ul vetëbesimin e mësuesve për të mësuar fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përforcon mendimin se vetëm specialistët mund të mësojnë fëmijët me aftësi të kufizuara, gjë që mund të çojë në veçim dhe përjashtim, dhe fokus në karakteristikat individuale ul mundësitë për pëmirësimin e mësimdhënies dhe të të nxënimit për të gjithë fëmijët.

Çfarë të thoni

‘Nuk ka fakte që mbështesin argumentin se të gjithë nxënësit në një nëngrup kanë të njëjtat nevoja. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka fakte të qarta që mbështesin argumentin se për disa nëngrupe nevojiten strategji specifike të mësimdhënies që ndryshojnë ndjeshëm nga strategjitë e përgjithshme të mësimdhënies.

Për të mbështetur nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të vendosin në qendër fëmijët, si dhe t’u përgjigjen nevojave të tyre të përbashkëta dhe të veçanta si fëmijë. Të dhënat kanë treguar se të gjithë fëmijët përfitojnë dhe mësojnë në mënyrë efikase në një klasë ku fëmijët vendosen në qendër’

Çfarë të bëni

Lexoni fjalinë e fundit në faqen e prezantimit dhe mbaje mend se të qenit një mësues i cili vendos në qendër fëmijët, përbën hapin e parë për të mbështetur nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat gjithëpërfshirëse.

Çfarë të thoni

‘Nxitja e mësuesve për të besuar se nevojiten qasje të veçanta mësimdhënieje për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk është aspak e dobishme. Mësuesit duhet t’i mësojnë të gjithë fëmijët në një klasë të zakonshme në mënyrë efikase.’

Çfarë të shfaqni

Pedagogjia dhe shërbimet e specializuara

- Nuk ka asnjë provë të bazuar për një pedagogji të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kurrikula duhet të përshtatet për disa fëmijë herë pas here, por të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë të njëjtën kurrikulë dhe të mësojnë nëpërmjet të njëjtave qasje konstruktive.
- Shërbimet e specializuara dhe burimet do të kenë gjithmonë një rol të rëndësishëm, por ato duhet të projektohen dhe të jenë në gjendje të mbështesin mësuesit e zakonshëm dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjedise të zakonshme, të paveçuara duke zbatuar parimet universale gjithëpërfshirëse të bazuara në të drejtë.

Ne jemi të gjithë UNIKË DHE TË NDRYSHËM

- Nevojat janë të njëjta, por në të njëjtën kohë, edhe unike
- Nuk ka prova që ka një strategji specifike për mësimdhënien në "nëngrupe"

Për të mbështetur nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përqendrohen te fëmijët dhe t’u përgjigjen nevojave të tyre të përbashkëta dhe të veçanta të fëmijëve.



Aktiviteti 8 – Prezantim mbi mënyrën e realizimit të pedagogjisë me në qendër fëmijën

Koha: 60 minuta (13.00 – 14.00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të prezantojmë karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën

Fokusi

- Prezantim dhe aktivitete të shkurtra për të paraqitur karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën në klasat gjithëpërfshirëse

Materiale

- Prezantimi 'ToT, dita 2'
- Laptop, projektor dhe ekran
- Materiali 2, dita 2 - Karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
- Materiali 3, dita 2, Stile të ndryshme të të nxënit, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
- Video: Pedagogjia me në qendër mësuesin kundrejt asaj me në qendër fëmijën: <https://www.youtube.com/watch?v=I09uSOHAgP4>

Metoda

- Prezantim
- Aktivitete të shkurtra duke përfshirë reflektimin individual, si dhe ushtrime dhe bisedime të shkurtra me të gjithë grupin
- Video

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të thoni

'Çdo mësues në shkollë do të përballë me fëmijë me kontekste, aftësi, interesa dhe nevoja të larmishme të të nxënit. Duke qenë se nuk ekziston një pedagogji e veçantë për të mësuar fëmijët me aftësi të kufizuara, mësuesit në mjediset gjithëpërfshirëse duhet të zbatojnë pedagogjinë me në qendër fëmijën, me qëllim përmbushjen e nevojave të të gjithë fëmijëve. Në prezantim vijues do të paraqesim karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën'.

Çfarë të thoni


"Pedagogji" është një term i përdorur gjerësisht në sistemin arsimor. I referohet "aktit të mësimit bashku me ligjërimin e tij shoqëruar. Ka të bëjë me gjërat që duhet të mësohen dhe aftësitë që duhet të zotërohen".^{viii}

Zakonisht, gjatë aplikimit të pedagogjisë me në qendër fëmijën, mësuesit duhet të ndryshojnë mënyrën e sjelljes së tyre në klasë për të ndërtuar praktika më gjithëpërfshirëse. Në një mjedis tradicional ose sipas pedagogjisë më të përqendruar te mësuesi, zakonisht mësuesi qëndron para klasës, rregullon bankat në kolona dhe rreshta, u jep nxënësve të gjitha njohuritë, si dhe u tregon nëse përgjigjet e tyre janë të sakta apo të gabuara. Në të kaluarën, shpesh

Çfarë të shfaqni

Çelësi i pedagogjisë me në qendër fëmijët është sjellja e mësuesit gjatë mësimit në klasë.

<p>kjo ishte mënyra se si mësuesve u mësohej se si duhej të ishte një mësues i mirë dhe autoritar.</p> <p>Çështja kryesore në pedagogjinë e përqendruar te fëmija qëndron në sjelljen e mësuesit. Ka të bëjë me mënyrën se si ai/ajo qëndron përpara klasës, si i përdor burimet në klasë, si ndërvepron me fëmijët, si dhe mënyrën e vlerësimit të të nxënimit të fëmijëve.</p>	
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shpërndajuni pjesëmarrësve një kopje të 'Dita 2 - Materiali E', Karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën. Bëjeni të qartë se qëllimi i materialit është të japë informacione dhe këshilla të detajuara, të cilat mund të lexohen pas trajnimit. Nuk ka nevojë ta lexoni materialin në mënyrë individuale ose ta lexoni atë me zë të lartë për të gjithë grupin. Materialin mund ta gjeni të përmbledhur në faqet e mëposhtme të prezantimit.</p>	<p>Çfarë të ndani</p> <p>Karakteristikat kyçe të pedagogjisë me në qendër fëmijën</p> <p>1. Mundësi të rëndësishme për të nxënimit</p> <p>Nëse nxënësit kuptojnë qëllimin e orëve mësimore dhe aktiviteteve shkollore, ata ndihen më të motivuar. Është e rëndësishme të bëhet lidhja ndërmjet asaj që mësohet dhe mënyrës se si zbatohet kurrikula me jetën e përditshme të fëmijëve. Kjo gjë mund të bëhet vetëm nëse mësuesit përpiqen të krijojnë një raport me nxënësit e tyre, të kuptojnë se çfarë është e rëndësishme për ta, si dhe të krijojnë një atmosferë të qetë në të cilën nxënësit të ndihen të sigurt për të shkëmbyer ide me njëri-tjetrin dhe mësuesin. Ka disa mënyra për ta realizuar këtë raport:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikoni mësimet mbi njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të nxënësve. Mësuesi duhet t'i njohë shumë mirë nxënësit dhe t'u japë atyre mundësi të tregojnë atë që dinë, si dhe të japin kontribute domethënëse në mësimet. • Gjatë shpjegimit të koncepteve të reja, përdorni përvojat e përditshme të fëmijëve si shembuj. Në këtë mënyrë, do të rritni rëndësinë e mësimet për fëmijët. Nxënësit mund të nxiten të sjellin materiale nga shtëpia, si dhe të ndajnë historitë dhe përvojat e tyre. Gjithashtu, mësuesi duhet të jetë i mirë informuar mbi kushtet e jetesës dhe kulturën e nxënësve. • Bëjeni të nxënimit të qëllimshme duke u dhënë fëmijëve mundësi të vënë në zbatim ato që kanë mësuar në situata të përditshme. • Bëni lidhjen e asaj që fëmijët mësojnë në një lëndë me atë që kanë mësuar në një tjetër. Shumë lëndë janë të ndërlidhura dhe është e rëndësishme të tregohet kjo koherencë pasi përforcon procesin e të nxënimit.
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shfaqni faqen e prezantimit dhe shpjegoni përmbajtjen e saj</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p> <p>Pedagogjia me në qendër fëmijët: Elementet kyçe</p> <p>1. Bëji që mundësitë e të nxënimit të kenë kuptim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bëji të qartë qëllimin e mësimet dhe çfarë pret nga nxënësit • Ndërtojeni mësimin mbi -çka nxënësit dinë deri tani • Ndërtojeni me eksperiencat e përditshme të nxënësve • Krijoni një lidhje midis shtëpisë dhe shkollës • <u>Ofrojeni</u> nxënësve mundësi që të praktikojnë atë çfarë kanë mësuar nga situatat e përditshme • <u>Ofrojeni</u> nxënësve mundësi të tregojnë çfarë dinë dhe të japin kontribut domethënës për mësimin
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shfaqni faqen e prezantimit dhe nxitini pjesëmarrësit të mendojnë për pyetjet, qoftë në mënyrë individuale apo me personin që kanë në krah. Jepuni 5 minuta kohë të mendohen.</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p>

	<p>Pedagogjia me në qendër fëmijët: Mundësi kuptimplota të të Nxënit</p>  <p>Moment reflektimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mendoni për disa minuta në mënyrë individuale ose diskutoni me personin pranë jush se çfarë do të thotë 'të krijosh mundësi për të nxënë' në klasën tuaj: <ul style="list-style-type: none"> • Si do të dukej? • A e keni provuar deri tani? • Si ndihmon kjo në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara?
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shfaqni faqen e prezantimit dhe shpjegoni përmbajtjen e saj. Shpërndajuni pjesëmarrësve një kopje të Dita 2 - Materiali F, Stile të ndryshme të të nxënit. Duke qenë se synimi i materialit është që të studiohet me vëmendje pas përfundimit të kreut, nuk është e nevojshme që të lexohet gjatë seancës.</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p> <p>Pedagogjia me në qendër fëmijët: Elementet kyçe</p> <p>2. Pranoni se të gjithë fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme</p> <p>Të gjithë fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme, në momente të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Verbale: të nxënit nëpërmjet fjalës së shkruar ose të folur (memorizimi, rikujtimi) • Logjike: të nxënit nëpërmjet arsytimit dhe llogaritjeve (numra, struktura, masa) • Pamore: të nxënit nëpërmjet ndihmave pamore (hartat, diagrama, foto) • Kinestetike: të nxënit nëpërmjet lëvizjes (në lojëra, në drama) • Muzikore: të nxënit nëpërmjet tingujve (rryma, ritmi, përsëritja) • Ndërpersonale: të nxënit nëpërmjet punës në grup (marrëdhënieve shoqërore) • Vetjake: të nxënit nëpërmjet vetëreflektimit (punë individuale, përqendrimi)
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shfaqni faqet e mëposhtme të prezantimit për 'ToT, dita 2' me imazhe të aktiviteteve të të nxënit. Lëri pjesëmarrësit të identifikojnë se për cilat stile të të nxënit vlejné këto aktivitete. Mund të vlejë për më shumë se një për aktivitet. Ky është një aktivitet i shpejtë me të gjithë grupin. Pjesëmarrësit mund t'i japin përgjigjet e tyre pa i diskutuar ato më parë në grup</p>	
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shfaqni faqen e prezantimit dhe shpjegoni përmbajtjen e saj. Jepini pjesëmarrësit disa minuta kohë për të reflektuar rreth pyetjes në mënyrë individuale.</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p> <p>Pedagogjia me në qendër fëmijët: Elementet kyçe</p> <p>3. Të nxënit në bashkëpunim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jepuni nxënësve mundësi të punojnë dhe mësojnë në grupe • Mos i gruponi nxënësit sipas aftësive; <u>diversiteti</u> pasuron përvojën e të nxënit <p>Moment reflektimi</p> <p>Shpenzoni disa minuta kohë për të menduar ose diskutuar përvojat tuaja me punën në grup në klasën tuaj</p>

<p>Çfarë të bëni Shfaqni faqen e prezantimit dhe shpjegoni përmbajtjen e saj.</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p> <p>Pedagogjia me në qendër fëmijën: Elementet kyçe</p> <p>4. Hapësira tërheqëse dhe të aksesueshme të nxënit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurohuni që hapësirat dhe aktivitetet të janë të aksesueshëm për të gjithë • Ide: biblioteka e klasës, ekspozitë me punët e të gjithë fëmijëve • Krijoni mundësi të të nxënit argëtuese, aktive dhe të aksesueshme
<p>Çfarë të bëni Shfaqni faqet e mëposhtme të prezantimit për 'ToT, dita 2' me imazhe të modeleve të ndryshme për klasat me në qendër fëmijën. Theksoni fleksibilitetin e strukturës dhe këndeve të ndryshme për të lejuar përdorimin e stileve të ndryshme të mësimdhënies. Në këtë mënyrë, mund të krijoni hapësira tërheqëse dhe të aksesueshme të të nxënit në situata me pak burime.</p>	
<p>Çfarë të bëni Shfaqni faqen e prezantimit dhe shpjegoni përmbajtjen e saj. Informoni grupet se në seancat e ardhshme do të trajtohet vlerësimi formues dhe ai gjithëpërfshirës në mënyrë më të detajuar</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p> <p>Pedagogjia me në qendër fëmijët: Elementet kyçe</p> <p>5. Vlerësimi formues</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jepuni mundësi fëmijëve të tregojnë çfarë dinë dhe sa të aftë janë, duke përdorur një gamë mënyrash të ndryshme (me shkrim, me gojë, me anë të portofolave, vëzhgimeve,...) • I vazhdueshëm, jo vetëm në fund të vitit • Për të informuar fëmijët, mësuesit dhe prindërit rreth progresit të të nxënit dhe për të mundësuar rregullimet, në vend që të gjykojnë arritjet e fëmijës
<p>Çfarë të bëni Shfaqni videon për të përmbledhur ndryshimin ndërmjet pedagogjisë me në qendër mësuesin dhe asaj me në qendër fëmijën</p>	<p>Çfarë të shfaqni Pedagogjia me në qendër mësuesin kundrejt asaj me në qendër fëmijën: https://www.youtube.com/watch?v=I09uSOHAgP4</p>

Dizenjimi Universal për të Nxënit

Aktiviteti 9 – Parimet bazë të DUN-së

Koha: 20 minuta (15.00 – 15.20)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të prezantojmë parimet e Dizenjimit Universal të të Nxënit (DUN) për të ofruar një skemë për heqjen e barrierave dhe përshtatjen e kurrikulave, si dhe udhëzime dhe vlerësime në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund të mësojnë në klasë.

Fokusi

- Korniza për Dizenjimin Universal të të Nxënit (DUN) u vjen në ndihmë mësuesve për të krijuar dhe vlerësuar orët mësimore, me qëllim përfshirjen e të gjithë fëmijëve në klasë. Aktiviteti u tregon pjesëmarrësve se si të përgatisin orët mësimore dhe të nxënit e nxënësve duke përdorur forma të ndryshme të paraqitjes së materialit, veprimit dhe të shprehurit, si dhe të angazhimit të të gjithë fëmijëve në procesin e të nxënit.

Materiale

- Laptop, projektor, ekran
- Prezantimi 'ToT, dita 3'
- Materiali 4, dita 2, parimet e DUN-së, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
- Vështrim i përgjithshëm i DUN-së me video
<https://www.youtube.com/watch?v=bDvKnY0g6e4>

Metoda

- Prezantim
- Video

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të thoni

Dizenjimi Universal të të Nxënit (DUN) është një qasje që u vjen në ndihmë mësuesve për të hartuar plane mësimore dhe mjedise të të nxënit, të cilat ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit. Ditën e djeshme, grupeve iu kërkua të lexonin 'Parimet e DUN-së' dhe 'Listën e kontrollit të DUN-së', si dhe të shikonin 2 video me shembujt e DUN-së'

Çfarë të thoni

'DUN synon:

- Të ofrojë të nxënit për të gjithë nxënësit
- T'i bëjë nxënësit të ndihen të aftë, të sigurtë dhe të suksesshëm gjatë procesit të të nxënit
- Të krijojë dhe të mbështesë një mjedis të nxënit ku të gjithë nxënësit të ndihen të mirëpritur dhe të vlerësuar'

Çfarë të shfaqni

Ka për qëllim:

- Të bëjë të nxënit të aksesueshme për të gjithë nxënësit
- T'i bëjë nxënësit të ndihen të aftë, të sigurtë dhe të suksesshëm në të nxënit
- Të krijojë dhe sigurojë qëndrueshmërinë e një mjedisi mësimor, ku të gjithë nxënësit të ndihen të mirëseardhur dhe të vlerësuar



UNIVERSAL
LEARNING
DESIGN

Çfarë të bëni

Diskutoni 3 parimet e DUN-së

Çfarë të shfaqni

	<h2>Parimet kyçe të DUN</h2> <ul style="list-style-type: none"> • Mënyra të shumta të paraqitjes: Çfarë Paraqitja e informacionit dhe përmbajtjes në mënyra të ndryshme • Mënyra të shumta veprimi dhe shprehjeje: Si Mënyra të ndryshme nëpërmjet të cilave nxënësit mund të shprehin çfarë dinë dhe kanë mësuar në një mjedis me të cilin ndihen komode • Mënyrat e shumta të angazhimit: Pse? Nxitja e interesit dhe motivimit të nxënësve për të nxënë
<h3>Çfarë të bëni</h3> <p>Vijoni me shfaqjen e videos si përmbledhje për DUN-në dhe parimeve të saj.</p>	<h3>Çfarë të shfaqni</h3> <p>Video: Vështrim i përgjithshëm i DUN-së</p>
<h3>Çfarë të bëni</h3> <p>Shfaqni faqe prezantimi me shembuj të tjerë të dizenjimit universal dhe dizenjimit universal të të nxënit</p>	<h3>Çfarë të shfaqni</h3> <h2>Shembuj të DUN</h2> <p>Tualetet në aeroporte</p> <ul style="list-style-type: none"> • Më parë: tualete standarde + 1 tualet ekstra, i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara • Tani, dizenjimi universal: të gjithë tualetet janë të aksesueshëm nga të gjithë  <h2>Shembuj të DUN</h2> <p>Rutina në klasë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Më parë: Fëmijët pa aftësi të kufizuara duhet të <u>memorizonin</u> rutinën e përditshme në klasë, ndërsa fëmijëve me <u>autizëm</u> u jepej një program pamor • Tani: iu jepet një program pamor të gjithë 



Çfarë të bëni

Vijoni me shfaqjen e videos si përmbledhje për DUN-në dhe parimeve të saj.

Çfarë të shfaqni

Video: Vështrim i përgjithshëm i DUN-së

Çfarë të bëni

Shpërndajuni pjesëmarrësve një kopje të Materialit 41 dita 2, Parimet e DUN-së 1

Çfarë të ndani

	Mjetet e shumëfishta të përfaqësimit - ÇFARË	Mënyrat e shumëfishta të veprimit dhe të shprehurit - SI	Mënyrat e shumëfishta të angazhimit - PËRSE
Çfarë?	Qasje fleksibel për krijimin dhe ofrimin I referohet prezantimit të informacionit dhe përmbajtjes në disa mënyra në mënyrë që të gjithë nxënësit të mësojnë në mënyrën e duhur	Qasje fleksibel në mënyrë që nxënësit të menaxhojnë dhe të tregojnë ato që kanë mësuar I referohet mënyrave të ndryshme përmes të cilave nxënësit mund të shprehin atë dinë dhe atë që kanë mësuar në formën që ata njohin më mirë	Qasje fleksibel për të angazhuar nxënësit në procesin e të nxënit I referohet nxitjes së interesave të nxënësve dhe motivimit për të mësuar
Si?	Mësuesit marrin në konsideratë nevojat dhe preferencat e ndryshme të të nxënit për nxënësit e tyre. Kjo gjë pasqyrohet në zgjedhjen e materialeve të kurrikulës dhe siguron promovimin e të nxënit efikas.	Mësuesit arrijnë të bëjnë dallimin ndërmjet mënyrës se si nxënësit përcjellin atë që kanë mësuar dhe kuptuar duke ofruar mundësi të ndryshme (fjalë të folura dhe të shkruara, fotografi, gjepte, manipulim të objektit etj.).	Ata u kushtojnë vëmendje interesave të nxënësve dhe burimeve të tyre të motivimit.

Aktiviteti 10 – Përshtatja e mjedisit të të nxënit

Koha: 40 minuta (15.20 – 16.00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të tregojmë se si mund të reduktohen barrierat në mjedisin e të nxënit në mënyrë që ky mjedis të jetë i aksesueshëm nga të gjithë fëmijët
- Të sugjerojmë strategji të thjeshta që mund të përdoren nga mësuesit, në mënyrë që mjedisi i të nxënit të jetë i aksesueshëm nga të gjithë fëmijët

Fokusi

- Në këtë aktivitet diskutohen strategji të thjeshta për mësuesit, në mënyrë që mjedisi i të nxënit të jetë më fleksibël.

Materiale

- Laptop, projektor, ekran
- Video: Përmirësimi i mjedisit të të nxënit: <https://www.youtube.com/watch?v=4cscJcRKYxA>
- Materiali 5, dita 2: Këshilla për përshtatjen e mjediseve të të nxënit, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
- Prezantimi 'ToT, dita 2'

Metoda

- Video
- Diskutim në grup

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni Shfaqni faqen e prezantimit me pyetjet e diskutimit për videon	Çfarë të shfaqni Video për diskutimin e pyetjeve <ul style="list-style-type: none">• Si rregullohen klasat në mënyrë që të maksimizohet të nxënit për të gjithë fëmijët?• Si mendoni që rregullimi i klasës mund t'i ndihmojë fëmijët me aftësi të kufizuara?• Cilat nga parimet kyçe të pedagogjisë me në qendër fëmijët njihni?• Çfarë rregullimesh në klasë mund të aplikohen në klasën tuaj? Përse?
Çfarë të bëni Kërkojuni pjesëmarrësve të shikojnë videon dhe të përpiqen që t'u japin përgjigje pyetjeve brenda grupit të tyre. Shfaqni sërish faqen e prezantimit me pyetje. Sqaroni se çdo grup do të ketë vetëm 2 minuta kohë për të prezantuar punimin e tyre. Nxisni pjesëmarrësit që nuk kanë bërë ende asnjë prezantim që të ndërmarrin rolin e paraqitur	Çfarë të shfaqni 'Dita 2 – Përmirësimi i mjedisit të të nxënit' https://www.youtube.com/watch?v=4cscJcRKYxA
Çfarë të bëni Jepuni grupeve 20 deri në 30 minuta kohë për diskutim në grup. Më pas, kërkojuni grupeve të prezantojnë punimet e tyre brenda 2 minutave, respektoni kohën rreptësisht. Udhëzoni grupet që të shtojnë vetëm informacione të reja, pra të mos përsëritin gjërat e ndara tashmë nga grupet e tjera. Dëgjoni përgjigjet dhe shikoni nëse informacioni bazë është ndarë dhe nëse jo, ndajeni vetë.	

Çfarë të bëni

Shpërndajuni pjesëmarrësve një kopje të 'Këshilla për përshtatjen e mjediseve të të nxënët', materiali 5, dita 2. Nuk është e nevojshme të lexohet gjatë seancës.

Çfarë të ndani

5 këshillat kryesore nga DUN për mjediset e të nxënët*

1. Krijoni hapësirë për përbushjen e qëllimit

Përcaktoni qëllimin e planit mësimor për një orë mësimi të caktuar. Më pas, mendoni se si mund të ndryshohen hapësirat fizike për t'u përpunur me qëllimet e synuara të aktiviteteve të ndryshme. Për shembull, nëse bashkëpunimi është pjesë e qëllimit, si mund të rregullohen bankat, karriget dhe pjesë të tjerë të mjedisit për të rritur bashkëpunimin? Nëse qëllimi do të ishte një diskutim me të gjithë klasën ose punë e pavarur, rregullimi do të ndryshonte.

Provojeni!

Në mësimin pasardhës, përcaktoni qëllimin specifik të orës mësimore dhe reflektoni se si mund të riorganizohen bankat, materialet dhe hapësirat e punës me qëllim përbushjen e qëllimit përkatës.

Pyetje reflektuese:

- A është fleksibel organizimi i klasës time për të përbushur qëllimet e të nxënët?
- Si mund t'i siguroj materialet ose burimet më të rëndësishme në hapësirën e të nxënët?

2. Siguroni këndet e burimeve për të gjithë

Këndet e burimeve ofrojnë struktura dhe mbështetje në mënyrë që nxënësit të mund t'i përdorin sipas nevojës. Për shembull, mund të ketë kënde me opsione të tilla si fjalorë, enciklopedi, makina llogaritëse, mjete shkrimi, organizues grafikësh, letra me kutia, grafikë ose letra me ngjyra. Këndi mund të ketë drita të dobëta, kufje dhe karrige të rehatshme. Në këtë mënyrë mund të krijoni një kënd për të shfaqur përmbledhjen e ideve kryesore çdo ditë. Ky burim mund të bëhet pjesë e hapësirës së punës që mund të zgjidhet nga nxënësit për të mbështetur procesin e të nxënët.

Provojeni!

Përgatitni një hapësirë të re për të nxënët dhe ofroni nxënësve opsionin për të përdorur hapësirën sipas nevojës gjatë orës së mësimi. Nxënësit mund të fillojnë të vënë re se si mjetet, materialet dhe burimet e ndryshme mbështesin procesin e tyre të të nxënët.

Pyetje reflektuese:

- Si mund të ofroj një kënd në mjedisin tim të të nxënët ku nxënësit kanë një larmi mjetesh, materialesh dhe burimesh?
- Si mund të reflektoj me nxënësit rreth përdorimit të këtyre burimeve në procesin e tyre të të nxënët?

Çfarë të thoni

'Materiali 5, dita 2 ju jep këshilla të tjera mbi krijimin e mjediseve përfshirëse dhe të aksesueshme të të nxënët. Materiali mund të lexohet pas seancës trajnuese'

Reflektimi dhe përpunimi

Aktiviteti 11 – Reflektimi bashkëpunues

Koha: 20 minuta (16.00 – 16.20)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të ofrojmë hapësirë për përpunimin e procesit të të nxënit

Fokusi

- Diskutim në grup për të reflektuar mbi të nxënit

Materiale

- Asnjë

Metoda

- Diskutim në të gjithë grupin

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Shpjegoni udhëzimet për aktivitetin.

Kini parasysh qëllimin e aktivitetit. Kjo është një hapësirë kohore për të përpunuar të nxënit, si dhe për ndarë opinione dhe mendime. Ky aktivitet nuk është një seancë me pyetje dhe përgjigje. Nëse shtohen pyetje, shtojini ato në listë dhe jepuni përgjigje më vonë gjatë trajnimit.

Në vend që t'ju japin një listë pyetjesh për t'u përgjigjur, nxitini pjesëmarrësit të reagojnë mbi kontributet e njëri-tjetrit.

Në seanca të tilla, pjesëmarrësit priren të përfshihen, si dhe të ndajnë mendimet dhe reagimet e tyre me personat që kanë pranë sesa të dëgjojnë kontributet. Menaxhoni mirë dinamikën e grupit dhe sigurohuni që të gjithë të jenë duke dëgjuar. Sqaroni se aktiviteti i radhës do të ofrojë hapësirë për diskutime në grupe të vogla.

Udhëzime

- Ky është një diskutim në të gjithë grupin
- Të gjithë ata që kanë dëshirë mund të ndajnë ide, mendime, reflektime ose shembuj të gjërave që kanë mësuar deri më tani.
- Të gjithë mund të reagojnë mbi këto kontribute
- Kjo nuk është një seancë me pyetje dhe përgjigje. Pyetjet e ngritura do të shtohen në listë dhe do të trajtohen më vonë gjatë trajnimit.
- Respektoni kontributet e njëri-tjetrit duke i dëgjuar të gjithë

Aktiviteti 12 – Përmbledhja dhe mesazhet kyçe

Koha: 10 minuta (16.20 – 16.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të përmbledhim ato që janë mësuar sot

Fokusi

- Vendosja e theksit mbi mesazhet kyçe

Materiale

- Laptop, projektor, ekran
- Prezantimi 'ToT, dita 2'

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Përmbliidhni gjërat e mësuara sot duke kaluar në faqe të ndryshme prezantimi

Çfarë të shfaqni

Përmbledhja

- Fokusi kryesor për mësuesit ndihmës: punoni me shkollën dhe prindërit për t'u siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin mbështetjen e nevojshme dhe burimet për të nxënë dhe marrë pjesë në të gjitha aktivitetet.
- Një pjesë e rëndësishme e punës si mësues ndihmës është të krijoni dhe mbani marrëdhënie të mira me mësuesit e zakonshëm.
- Edhe mësuesit e zakonshëm edhe mësuesit ndihmës duhet të jenë të njohur me pedagogjinë me në qendër fëmijët, Dizajnimin Universal të të Nxënës dhe strategjitë bazë në klasë për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse

Përmbledhja

- DUN = ta bëni të nxënës të aksesueshëm për të gjithë, në vend që të jepet mësim për shumicën dhe të bëhen përshtatje për të tjerët
- Pedagogjia me në qendër fëmijët= të pranoni që të gjithë fëmijët mësojnë në mënyra të ndryshme dhe se mund të kenë nevojë për mbështetje

Mesazhet kyçe:

- Të gjithë fëmijët janë unikë dhe mësojnë në mënyra të ndryshme, prandaj nuk ka strategji të veçanta mësimdhënie për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilat janë thelbësisht të ndryshme nga mësimdhënia e fëmijëve pa aftësi të kufizuara
- Aplikimi i pedagogjisë me në qendër fëmijët dhe DUN-it, do të përmirësojë cilësinë e arsimit për të gjithë fëmijët, jo vetëm ata me një aftësi të kufizuar. Shkollat gjithëpërfshirëse janë shkolla të mira për të gjithë fëmijët
- Shumica e këtyre parimeve dhe strategjive kyçe nuk janë shumë të ndryshme nga çfarë duhet të bëjë një mësues i mirë i zakonshëm. Ato mund të zbatohen pa pasur nevojë për shumë trajnime, pa mbështetje apo burime.

Çfarë të bëni

Kontrolloni nëse ka pyetje të listuara në flipchart, të cilave tashmë mund t'u jepet përgjigje. Nëse gjykohej e nevojshme, referojuni seancave në ditët e ardhshme për t'u siguruar që problemet do të adreson më vonë gjatë trajnimit.

Materiale, dita 2

Materiali 1, dita 2: Pedagogji e veçantë apo me në qendër fëmijën?^{ix}


Dita 2 – Praktika gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 7 – Prezantimi ‘Përse pedagogjinë me në qendër fëmijën’

Kur bëhet fjalë për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, shpesh diskutohet nëse politikëbërësit duhet ose jo të zhvillojnë një kurrikulë të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara apo nëse këta fëmijë mund të ndjekin të njëjtën kurrikulë, në kushte të pranueshme, si të gjithë fëmijët e tjerë. Në mënyrë të ngjashme, shpesh diskutohet nëse mësuesit duhet të trajnohen në pedagogji të veçantë për të mësuar fëmijët me aftësi të kufizuara apo nëse ata mund të aplikojnë të njëjtën pedagogji edhe për fëmijët e tjerë në klasë. Le t’u hedhim një sy dy pyetjeve kyçe të lidhura me këto çështje.

1. A janë të ndryshme ose të veçanta nevojat arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara?

Kjo pyetje na rikthen pas në mënyrën e përcaktimit të arsimit gjithëpërfshirës dhe aftësive të kufizuara në Programin 2 - Arsimi gjithëpërfshirës i bazuar në të drejta. Në kreun 2.2 u diskutuan 2 këndvështrimeve të edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ne diskutuam dy perspektiva:



Pikëpamja individuale bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Një grup fëmijësh mund të identifikohen si të veçantë ose të ndryshëm.
- Këta fëmijë kanë nevojë për mësimdhënie të veçantë për t’iu përgjigjur problemit të tyre.
- Fëmijët që ndajnë të njëjtat probleme duhet të mësojnë së bashku.
- Fëmijët e tjerë përfitojnë nga metodat ekzistuese të shkollimit.

Rezultatet negative të kësaj pikëpamjeje janë diskutuar në Kreun 2.2. Ul pritshmëritë ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke ndikuar negativisht në rezultatet e tyre të të nxënit; ul besimin e mësuesve për t’u dhënë mësim fëmijëve me aftësi të kufizuara; përforcon idenë se vetëm specialistët mund të mësojnë fëmijët me aftësi të kufizuara, kjo mund të çojë në veçim dhe përjashtim; si dhe përqendrimi në karakteristikat individuale pakëson mundësitë për të përmirësuar mësimdhënien dhe procesin e të nxënit për të gjithë fëmijët.

Pikëpamja sociale mbështetet nga kuadrot ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Supozimet kyçe përfshijnë:

- Çdo fëmijë mund të përjetojë vështirësi në shkollë, jo vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Këto vështirësi mund të venë në dukje mënyrat në të cilat mësimdhënia mund të përmirësohet.
- Këto përmirësime do të çojnë në kushte më të mira mësimi për të gjithë fëmijët.
- Mësuesit duhet të mbështeten në mënyrë që të zhvillojnë praktikën e tyre për tu bërë më gjithëpërfshirës (në vend që të sillen vetëm specialistë për tu marrë me fëmijët me aftësi të kufizuara).

→ Është thelbësore të kuptojmë se **në një moment të caktuar të gjithë fëmijët do të përballen me vështirësi ose do të kenë nevoja të të nxënimit**, si dhe faktin që **fëmijët me të njëjtat aftësi të kufizuara nuk kanë medoemos të njëjtat nevoja të të nxënimit**.

Ndaj, **nuk mund të themi se metodat përmes të cilave mësojnë fëmijët me aftësi të kufizuara janë të veçanta ose të ndryshme nga ato të fëmijëve të tjerë.**

2. A ekziston një pedagogji e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara?

Në të kaluarën është diskutuar nëse mësimdhënia e fëmijëve me aftësi të kufizuara kërkon qasje të veçanta mësimdhënieje apo nëse mësuesi mund të përdorë qasjet e zakonshme ndaj mësimdhënies. Dy qëndrimet kryesore në këtë debat janë 'qëndrimi për dallimet unike' dhe 'qëndrimi për dallimet e përgjithshme'.

- Qëndrimi për dallimet unike

Të gjithë nxënësit kanë nevoja të zakonshme si të gjithë, si dhe nevoja unike si individë. Në vend që të ngremë supozimin se ekziston një pedagogji e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, mësuesit përdorin pedagogjinë me në qendër fëmijën për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë nxënësve.

- Qëndrimi për dallimet e përgjithshme

Krahas nevojave të përgjithshme për të gjithë nxënësit dhe atyre unike individuale, nxënësit mund të kenë nevoja që janë specifike për nëngrupin e tyre. Megjithatë, ndarja e fëmijëve në nëngrupe nuk bëhet gjithmonë në mënyrën e duhur. Fëmijët mund të ndajnë nevoja specifike të të nxënimit me fëmijë të tjerë brenda nëngrupit të tyre (për shembull nëngrupi i 'fëmijëve me dëmtim në shikim'), por mund të kenë edhe nevoja të të nxënimit për të ndarë me fëmijët jashtë nëngrupit në fjalë ose që janë unike për ta.

→ Në përgjithësi, nxitja e mësuesve për të besuar se nevojiten qasje të veçanta mësimdhënieje për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk konsiderohet aspak e dobishme. Mësuesit duhet të nxiten të përfshijnë dhe të mësojnë të gjithë fëmijët në klasa të zakonshme. Konceptet '**vazhdimësia e qasjeve të mësimdhënies**' me '**nivele të larta dhe të ulëta intensiteti**' prezantohen për të theksuar se qasjet e mësimdhënies që mësuesit përdorin në klasë janë të njëjta për të gjithë fëmijët. Megjithatë, për disa fëmijë qasjet përdoren në shkallë të ndryshme.



Duke qenë se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk kanë krejtësisht nevoja të ndryshme ose të veçanta mësimore, si dhe nuk ekziston një pedagogji e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, mësuesit në klasa gjithëpërfshirëse përdorin **pedagogjinë me në qendër fëmijën** për të përmbushur nevojat e të nxënimit të të gjithë fëmijëve në rritjen e cilësisë së përgjithshme të mësimdhënies dhe të nxënimit.

Materiali 2, dita 2: - Karakteristikat kryesore të pedagogjisë me në qendër fëmijën^x

Karakteristikat kyçe të pedagogjisë me në qendër fëmijën

1. Mundësi të rëndësishme për të nxënit

Nëse nxënësit kuptojnë qëllimin e orëve mësimore dhe aktiviteteve shkollore, ata ndihen më të motivuar. Është e rëndësishme të bëhet lidhja ndërmjet asaj që mësohet dhe mënyrës se si zbatohet kurrikula me jetën e përditshme të fëmijëve. Kjo gjë mund të bëhet vetëm nëse mësuesit përpiqen të krijojnë një raport me nxënësit e tyre, të kuptojnë se çfarë është e rëndësishme për ta, si dhe të krijojnë një atmosferë të qetë në të cilën nxënësit të ndihen të sigurt për të shkëmbyer ide me njëri-tjetrin dhe mësuesin. Ka disa mënyra për ta realizuar këtë raport:

- Planifikoni mësimet mbi njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të nxënësve. Mësuesi duhet t’i njohë shumë mirë nxënësit dhe t’u japë atyre mundësi të tregojnë atë që dinë, si dhe të japin kontribute domethënëse në mësimet.
- Gjatë shpjegimit të koncepteve të reja, përdorni përvojat e përditshme të fëmijëve si shembuj. Në këtë mënyrë, do të rritni rëndësinë e mësimet për fëmijët. Nxënësit mund të nxiten të sjellin materiale nga shtëpia, si dhe të ndajnë historitë dhe përvojat e tyre. Gjithashtu, mësuesi duhet të jetë i mirë informuar mbi kushtet e jetesës dhe kulturën e nxënësve.
- Bëjeni të nxënit të qëllimshme duke u dhënë fëmijëve mundësi të vënë në zbatim ato që kanë mësuar në situata të përditshme.
- Bëni lidhjen e asaj që fëmijët mësojnë në një lëndë me atë që kanë mësuar në një tjetër. Shumë lëndë janë të ndërlidhura dhe është e rëndësishme të tregohet kjo koherencë pasi përforcon procesin e të nxënit.

2. Mënyrat e shumfishta të të nxënit

Fëmijët mund të mësojnë në mënyra të ndryshme (shiko Materialin C për një përmbledhje të stileve të mundshme të të nxënit). Pjesa më e madhe e fëmijëve i përdorin të gjitha mënyrat e ndryshme të të nxënit përgjatë këtij procesi. Mësuesit duhet të jenë në gjendje t’i lehtësojnë këto mënyra të shumta të të nxënit, duke përdorur qasje të ndryshme të mësimdhënies për t’u siguruar që të gjithë fëmijët të marrin pjesë dhe të mësojnë së bashku. Mësuesit bëhen reflektues sipas pedagogjisë me në qendër fëmijën. Ata nxiten të reflektojnë vazhdimisht mbi:

- Mënyrat e të të nxënit në klasë me të cilat fëmijët njihen më mirë.
- Arsyet se përse disa fëmijë nuk po përparojnë me të njëjtin hap si të tjerët.
- Strategjitë dhe teknikat që duhen përdorur në mënyrë që të gjithë fëmijët të mund të mësojnë dhe të arrijnë rezultate.
- Mënyrën se si mund të rregullohen burimet, aktivitetet dhe/ose qasje në mënyrë që të jenë të disponueshme për të gjithë.
- Motivimi dhe angazhimi i fëmijëve dhe se si ndikohet nga konteksti dhe përvojat e tyre të veçanta.
- Mënyrën se si supozimet e lidhura me kulturën që formësojnë ndërveprimin me dhe ndërmjet fëmijëve, mësuesve dhe prindërve të tjerë. Në varësi të disa faktorëve - të tilla si tema e mësimet, mënyrat e veçanta të të nxënit të nxënësve, konteksti dhe aftësitë e mësuesve etj. - mësuesi do të përdorë një larmi qasjesh të mësimdhënies, si p.sh.:
- T’u japë mundësi të eksplorojnë, të shprehin, të mësojnë dhe të konsolidojnë dijet.
- T’u japë fëmijëve lirinë e të përdorurit aftësitë individuale të kërkimit dhe zgjidhjes së

problemeve, si dhe t'i udhëzojë ata për të shfrytëzuar sa më mirë talentet e tyre të lindura.

3. Të nxënit bashkëpunues

Përmes të nxënit bashkëpunues, nxënësit ndajnë përgjegjësitë dhe burimet teksa punojnë për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Puna bashkëpunuese në grup mund të jetë e rëndësishme në rritjen e të kuptuarit të fëmijëve për konceptet dhe qëndrimet pozitive ndaj punës dhe njëri-tjetrit. Nëse zbatohet siç duhet, puna në grup u lejon mësuesve të kalojnë më shumë kohë me individë dhe grupe të vogla.

Ekzistojnë qasje të ndryshme për të nxënit bashkëpunues dhe punës në grup. Është e rëndësishme që mësuesit të planifikojnë se si t'i ndajnë fëmijët në grupe. Për t'u siguruar që puna në grup në klasat gjithëpërfshirëse të jetë efikase, veçanërisht në mësimdhënien e fëmijëve me aftësi të kufizuara, është mirë që të mos krijoni grupe sipas niveleve të aftësive. Vendosja e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në një grup është shumë paragjyquese dhe nuk u ofron fëmijëve mundësinë e duhur për bashkëpunim dhe të nxënit. Krijimi i grupeve të fëmijëve nga kontekste të ndryshme ofron mundësitë më të mira të të nxënit për të gjithë. Studimet kanë treguar se të gjithë fëmijët mësojnë më mirë në grupe dhe klasa me aftësi të përziera.

Mësuesit duhet të krijojnë një mjedis në të cilin fëmijët ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur, për të ndërmarrë rreziqe apo për të kontribuar. Për t'u siguruar që aktiviteti të jetë kuptimplotë për të gjithë, puna në grup duhet të planifikohet me kujdes. Gjithashtu, mësuesit duhet të jenë të pranishëm gjatë kryerjes së detyrave për të dhënë mbështetjen sipas nevojës. Në mënyrë që puna në grup të rezultojë e suksesshme, fëmijët do të duhet të mësojnë dhe vënë në zbatim aftësitë e tyre (kuptimi i detyrës, ndarja e detyrave dhe burimeve, radha e veprimeve, vlerësimi i kontributeve të njëri-tjetrit, shprehja e ideve, dëgjimi aktiv etj.)

Secili fëmijë në grup mund të kryejë një rol, p.sh. një fëmijë mund të mbajë shënime, një tjetër mund të kontrollojë kohën dhe një tjetër mund të drejtojë diskutimin. Sigurohuni që rolet të shkëmbehen, p.sh. të gjithë të bëhen drejtues të ekipit. Po ashtu, është mjaft e rëndësishme që fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin role të rëndësishme dhe thelbësore në punën në grup. Shpesh mund të lindë nevoja që përpara se të nisë puna në grup, të vendosen disa rregulla bazë së bashku me fëmijët.

Që të jetë domethënëse, grupi duhet të kalojë përtej situatave ku fëmijët kryejnë detyrat në mënyrë individuale dhe të ndihmojnë të tjerët sipas nevojës. Përvojat më interesante të të nxënit vijnë nga situatat ku fëmijët janë në varësi të njëri-tjetrit dhe duhet të bashkëpunojnë për të kryer një detyrë. Në format e ndryshme të ndërvarësisë gjatë punës në grup përmendim:

- Ndërvarësia e qëllimit: grupi ka një qëllim të vetëm
- Ndërvarësia e shpërblimit: çdo fëmijë ka burime të ndryshme (materiale dhe njohuri) që duhet të kombinohen për të përfunduar detyrën
- Ndërvarësia e rolit: çdo fëmijë ka rol të ndryshëm, i cili është i nevojshëm për të përfunduar detyrën (monitoruesi i kohës, raportues etj.).

4. Mjediset tërheqëse dhe të qasshme të të nxënit

Mjedisi i klasës dhe i shkollës mund të mbështesin të nxënit dhe mësimdhënien me në qendër fëmijën. Hapësirat e të nxënit me në qendër fëmijën janë efikase dhe të sigurta për të gjithë fëmijët, ofrojnë pjesëmarrje të barabartë të të gjithë nxënësve, si dhe fokusohen në vetë-zbulim.

Ndonëse është e rëndësishme që të krijohen hapësira mësimore tërheqëse dhe të qasshme për të gjithë, ky nuk është qëllimi përfundimtar, përkundrazi, është një mënyrë për të zbatuar qasje mësimore të përqendruara tek fëmijët, në të cilat vlerësohet dhe adresohet e drejta e të gjithë fëmijëve për të përfituar arsim cilësor.

Disa prej karakteristikave të hapësirave të të nxënimit me në qendër fëmijën janë:

- Hapësira fizike: sigurohuni që të gjithë fëmijët të mund të lëvizin lirshëm në klasë dhe shkollë, të punojnë individualisht dhe në grupe, si dhe të kenë qasje në burimet e të mësuarit sipas nevojës.
- Këndet e të nxënimit: vendosni kënde të ndryshme të të nxënimit në klasë ku fëmijët të mund të mësojnë në mënyrë të pavarur ose në grupe të vogla përmes të mësuarit autodidakt. Burimet dhe udhëzimet duhet të jenë të pranishme në çdo kënd. Këndet u japin nxënësve mundësinë të pasurojnë njohuritë e mëparshme, të zbatojnë aftësi të reja, si dhe të eksplorojnë koncepte të reja. Nxënësit mund të bëhen pjesë e planifikimit, organizimit dhe menaxhimit të këndeve të të nxënimit. Në këtë mënyrë, lidhja ndërmjet shtëpisë dhe shkollës mund të përforcohet.
- Këndet e prezantimit: përgatisni një tabelë prezantimi në klasë ku mund të shfaqni punimet e të gjithë fëmijëve dhe të jepni komente mbi aktivitetet. Ndryshojeni shpesh tabelën dhe përdoreni si një mjet ndihmës për mësimdhënie.
- Biblioteka e klasës: librat janë mjete ndihmëse mjaft efikase për mësimdhënie, të cilat i ndihmojnë fëmijët të mësojnë koncepte të reja, të zhvillojnë gjuhën dhe të kuptojnë mesazhet. Librat e marrë nga bibliotekat lokale ose librat e krijuara nga fëmijët mund të jenë po aq efikasë sa librat e shtrenjtë të fëmijëve.

5. Vlerësimi

Të gjithë mësuesit do të duan të dinë në periudha të ndryshme të mësimt, javës, semestrit ose vitit se çfarë kanë mësuar nxënësit e tyre dhe se si mund të zbatojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre. Me vlerësimin e vazhdueshëm formues të përdorur në klasa gjithëpërfshirëse dhe me në qendër fëmijën, të gjithë fëmijët kanë mundësinë të tregojnë atë që kanë mësuar në mënyra të ndryshme sipas mënyrave të ndryshme të të nxënimit. Vlerësimi i vazhdueshëm u jep mësuesve informacione, të cilët në çdo moment mund të rregullojnë orët mësimore, për t'u siguruar që të gjithë fëmijët të kuptojnë se çfarë po ndodh, si dhe për fëmijët që mësojnë se si mund të përparojnë. Kjo gjë i ndihmon mësuesit të komunikojnë rregullisht me prindërit pikat e forta dhe të dobëta të fëmijëve në mënyrë që ata të përfshihen në procesin mësimor të fëmijëve të tyre gjatë gjithë vitit shkollor. Në këtë qasje, vlerësimi ndihmon procesin arsimor duke promovuar të nxënimit dhe udhëzuar mësimdhënien. Vlerësimi është 'për' dhe 'i' të nxënimit. Kreu 4.6, 4.7 dhe 4.8 analizojnë me detaje vlerësimin me në qendër fëmijën.

6. Ndryshimi i roleve të mësuesve

Në mjediset më tradicionale të edukimit, mësuesi ka një rol të qartë: ai/ajo u siguron fëmijëve informacione. Nëse zbatohet një qasje që e vendos më në qendër fëmijën, roli i mësuesit do të ndryshojë. Kështu, mësuesi nuk ka më një rol të paracaktuar, por përshtatet sipas situatës. Disa role të mundshme për mësuesit janë:

- Lehtësues: ofron mundësitë e duhura të të nxënimit dhe nxit fëmijët të kontribuojnë ide në mënyrë konstruktive.
- Drejtues: planifikon dhe drejton diskutime për t'u siguruar që të gjithë fëmijët të mund të

kontribuojnë

- Vëzhgues: vëzhgon fëmijët ndërsa punojnë individualisht, në grupe dhe ndërsa luajnë. Kështu, mësuesi do ta ketë më të lehtë t'i kuptojë, si dhe të krijojë aktivitete më të mira të të nxënit.

Materiali 3, dita 2: Stilet e ndryshme të të nxënit^{xi}

Dita 2 – Praktika gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 8 – Prezantimi 'Çfarë është pedagogjia me në qendër fëmijën'

Të gjithë fëmijët - pa asnjë përjashtim – mund të mësojnë. Mënyra se si ata mësojnë në momente të ndryshme të jetës së tyre mund të ndryshojë, madje edhe për tema të ndryshme. Disa fëmijë mësojnë duke dëgjuar mësuesin, ndërsa të tjerë mund të preferojnë të bëjnë ushtrime, të përdorin mjete ndihmëse pamore ose të zhvillojnë diskutime në grup. Dallohen shtatë mënyra të ndryshme të të nxënit.

Stili	Karakteristikat:
Verbal ose gjuhësor	Fëmijët mendojnë dhe mësojnë përmes fjalëve të shkruara ose të folura, kujtesës dhe riprodhimit
Logjik ose matematikor	Fëmijët mendojnë dhe mësojnë përmes arsytimit dhe llogaritjes. Ata mund të përdorin lehtësisht numra, të njohin modele abstrakte dhe të bëjnë matje të sakta
Pamor ose hapësinor	Fëmijët mendojnë dhe mësojnë përmes mjeteve ndihmëse vizuale. Ata pëlqejnë artin, mund të lexojnë lehtësisht harta, diagrame dhe grafikë
Kinestetik	Fëmijët mësojnë dhe mendojnë përmes lëvizjes, lojërave dhe dramës
Muzikor ose ritmik	Fëmijët mësojnë përmes tingujve, rimës, ritmit dhe përsëritjes
Ndërpersonal	Fëmijët mësojnë në grupe përmes punës bashkëpunuese. Ata kuptojnë lehtësisht situatat shoqërore dhe krijojnë raporte pa pasur vështirësi
Vetjak	Fëmijët mësojnë përmes përqendrimit dhe vetëreflektimit vetjak. Atyre u pëlqen të punojnë individualisht dhe janë të vetëdijshëm për ndjenjat, pikat e tyre të forta dhe të dobëta

Në një klasë ku mësuesi përdor vetëm të nxënit mekanik, duke përsëritur vazhdimisht përmbajtjen mësimore, qasja e mësimdhënies do t'u përshtatet vetëm një grupi të vogël nxënësish (ata që preferojnë të nxënit verbal). Fëmijët e tjerë mund të kenë më shumë vështirësi në ndjekjen e mësimëve. Por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se këta fëmijë janë me aftësi të kufizuara apo kanë nevoja të veçanta.

Materiali 4, dita 2: Parimet e DUN-së^{xii}

Dita 2 – Praktika gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 9 – Parimet bazë të DUN-së

	Mjetet e shumëfishta të përfaqësimit - ÇFARË	Mënyrat e shumëfishta të veprimit dhe të shprehurit - SI	Mënyrat e shumëfishta të angazhimit - PËRSE
Çfarë?	<p>Qasje fleksibël për krijimin dhe ofrimin</p> <p>I referohet prezantimit të informacionit dhe përmbajtjes në disa mënyra në mënyrë që të gjithë nxënësit të mësojnë në mënyrën e duhur</p>	<p>Qasje fleksibël në mënyrë që nxënësit të menaxhojnë dhe të tregojnë ato që kanë mësuar</p> <p>I referohet mënyrave të ndryshme përmes të cilave nxënësit mund të shprehin atë dinë dhe atë që kanë mësuar në formën që ata njohin më mirë</p>	<p>Qasje fleksibël për të angazhuar nxënësit në procesin e të nxënësve</p> <p>I referohet nxitjes së interesave të nxënësve dhe motivimit për të mësuar</p>
Si?	<p>Mësuesit marrin në konsideratë nevojat dhe preferencat e ndryshme të të nxënësve për nxënësit e tyre. Kjo gjë pasqyrohet në zgjedhjen e materialeve të kurrikulës dhe siguron promovimin e të nxënësve efikas.</p>	<p>Mësuesit arrijnë të bëjnë dallimin ndërmjet mënyrës se si nxënësit përcjellin atë që kanë mësuar dhe kuptuar duke ofruar mundësi të ndryshme (fjalë të folura dhe të shkruara, fotografi, gjeste, manipulim të objektit etj.).</p>	<p>Ata u kushtojnë vëmendje interesave të nxënësve dhe burimeve të tyre të motivimit.</p>
Përse është e rëndësishme?	<p>Duke marrë parasysh nevojat e nxënësve në fazën e hartimit dhe shpërndarjes së udhëzimeve, barrierat që pengojnë procesin e të nxënësve pakësohen dhe mundësitë që nxënësit të kenë akses dhe të jenë të suksesshëm në përvetësimin e aftësive ose njohurive rriten.</p>	<p>Kështu, nxënësit kanë mundësi të tregojnë atë që kanë kuptuar. Gjithashtu, ndihmon mësuesit të monitorojnë nëse nxënësit kanë përvetësuar njohurinë dhe aftësitë e duhura për përmbajtjen.</p>	<p>Angazhimi dhe pjesëmarrja e nxënësve janë elemente thelbësore në nxitjen e një procesi të suksesshëm të të nxënësve.</p>

Materiali 5, dita 2: Këshilla për përshtatjen e mjediseve të të nxënës

Dita 2 – Praktika gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 10 – Përshtatja e mjedisit të të nxënës

5 këshillat kryesore nga DUN për mjediset e të nxënës^{xiii}

1. Krijoni hapësirë për përmbushjen e qëllimit

Përcaktoni qëllimin e planit mësimor për një orë mësimi të caktuar. Më pas, mendoni se si mund të ndryshohen hapësirat fizike për t'u përputhur me qëllimet e synuara të aktiviteteve të ndryshme. Për shembull, nëse bashkëpunimi është pjesë e qëllimit, si mund të rregullohen bankat, karriget dhe pjesë të tjerë të mjedisit për të nxitur bashkëpunimin? Nëse qëllimi do të ishte një diskutim me të gjithë klasën ose punë e pavarur, rregullimi do të ndryshonte.

Provojeni!

Në mësimin pasardhës, përcaktoni qëllimin specifik të orës mësimore dhe reflektoni se si mund të riorganizohen bankat, materialet dhe hapësirat e punës me qëllim përmbushjen e qëllimit përkatës

Pyetje reflektuese:

- A është fleksibël organizimi i klasës time për të përmbushur qëllimet e të nxënës?
- Si mund t'i siguroj materialet ose burimet më të rëndësishme në hapësirën e të nxënës?

2. Siguroni këndet e burimeve për të gjithë

Këndet e burimeve ofrojnë struktura dhe mbështetje në mënyrë që nxënësit të mund t'i përdorin sipas nevojës. Për shembull, mund të ketë kënde me opsione të tilla si fjalorë, enciklopedi, makina llogaritëse, mjete shkrimi, organizues grafikësh, letra me kutia, grafikë ose letra me ngjyra. Këndi mund të ketë drita të dobëta, kufje dhe karrige të rehatshme. Në këtë mënyrë mund të krijoni një kënd për të shfaqur përmbledhjen e ideve kryesore çdo ditë. Ky burim mund të bëhet pjesë e hapësirës së punës që mund të zgjidhet nga nxënësit për të mbështetur procesin e të nxënës.

Provojeni!

Përgatitni një hapësirë të re për të nxënës dhe ofrojeni nxënësve opsionin për të përdorur hapësirën sipas nevojës gjatë orës së mësimi. Nxënësit mund të fillojnë të vënë re se si mjetet, materialet dhe burimet e ndryshme mbështesin procesin e tyre të të nxënës.

Pyetje reflektuese:

- Si mund të ofroj një kënd në mjedisin tim të të nxënës ku nxënësit kanë një larmi mjetesh, materialesh dhe burimesh?
- Si mund të reflektoj me nxënësit rreth përdorimit të këtyre burimeve në procesin e tyre të të nxënës?

3. Integroni burimet dhe materialet dixhitale

Burimet dixhitale sigurojnë fleksibilitetin që nuk ofrohet nga materialet e printuara dixhitale. Tekstet dixhitale kanë karakteristika thelbësore për nxënës të caktuar, por janë të përshtatshme edhe për tjerë, si p.sh.:

- Kapaciteti për të lexuar me zë të lartë duke përdorur veglat e tekstit në ligjërim,
- Fleksibiliteti në shfaqjen e përmbajtjes (ngjyra, kontrasti, madhësia),
- Mbështetje të integruara siç janë fjalorët, theksimi dhe mbajtja e shënimeve,

- Titra me opsion aktivizimi dhe çaktivizimi
- Përshkrime audio për videon,
- Përshkrime me imazhe

Provojeni!

Merrni një burim nga ora pasardhëse dhe ofroni një version dixhital të aksesueshëm. Ndani disa prej karakteristikave kryesore dhe më pas reflektoni me nxënësit rreth mënyrës se si një prej opsioneve dixhitale ka mbështetur procesin e tyre të të nxënit.

Pyetje reflektuese:

- Cilat janë burimet dixhitale që ofrohen në shkollën time? (për shembull salla TIK, kompjuteri, celulari inteligjent)?
- Si mund ta rris disponueshmërinë e opsioneve dixhitale për burimet dhe materialeve të mia?
- Si mund t'u ofroj të gjithë nxënësve burimet dhe materialet e disponueshme?

4. Theksoni proceset e të nxënit në mjedis

Reagimi i vazhdueshëm dhe formues përbën një pjesë të rëndësishme të të nxënit (shiko edhe kreun 4.6, 4.7 dhe 4.8). Mjedis i të nxënit mund të theksojë procesin e të nxënit, por jo rezultatin përfundimtar. Duke shfaqur fazat e ndryshme të një projekti, nxënësit mund të kuptojnë vlerën e procesit drejt arritjes së produktit përfundimtar.

Provojeni!

Mendonini mënyra për të theksuar dhe shfaqur punën që përfaqëson procesin e të nxënit për një nga konceptet që po punoni me nxënësit. Për shembull, shfaqni punën e nxënësit që tregon procesin e hartimit të një eseje, procesin e zgjidhjes së një problemi të ndërlikuar matematikor ose krijimin e një posterit.

Pyetje reflektuese:

- Si mund të ofrohet dhe të bëhet i dukshëm procesi i të nxënit në mjedisin tim të të nxënit?
- Cilat janë mënyrat fleksibël përmes të cilave mund të nxis nxënësit të ndajnë procesin e tyre të të nxënit?

5. Siguroni akses në qëllimet e synuara në mjedisin e të nxënit

Nëse qëllimi i të nxënit është i qartë dhe i aksesueshëm në disa vende në mjedisin e të nxënit, mësuesit dhe nxënësit mund të bëjnë zgjedhje të qëllimshme rreth opsioneve të disponueshme dhe përdorimit të tyre.

Provojeni!

Ofroni të paktën dy mënyra përmes të cilave nxënësit mund të aksesojnë qëllimin e synuar të procesit të të nxënit në mjedisin përkatës. Për shembull, ju mund të përcaktoni qëllimin në mënyrë verbale, ta shkruani, ta diskutoni në grup dhe të theksoni qëllimet në të gjitha materialet. Duke ofruar qëllimet e mjedisit, rritet mundësia që nxënësit t'i referohen qëllimit në fjalë dhe të punojnë për ta arritur atë.

Pyetje reflektuese:

- Si mund t'i përfaqësoj qëllimet e të nxënit në mjedisin tim?
- Si mund t'i nxis nxënësit që t'i referohen në mënyrë të vazhdueshme qëllimit të të nxënit?

Dita 3 – Planifikimi për arsimin gjithëpërfshirës: Strategji praktike për mbështetjen efikase të mësuesve ndihmës në klasë

Përmbledhje

Objektivat:

- Prezantoni strategjitë bazë për mësuesit gjithëpërfshirës në klasë
- Prezantoni Planin për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës si një mjet për të përcaktuar mbështetjen dhe ofrimin
- Reflektoni mbi aftësitë e trajnimit dhe të lehtësimit

Materiale përgatitore:

- Laptop
- Projektor
- Altoparlantë
- Ekran i bardhë
- Mikrofonta
- Flipchart-e
- Shirit ngjitës
- Stilolapsa
- Lapustil
- Letra me ngjitje për shënim me ngjyra
- Flipchart
- Prezantimet:
 - ‘ToT, dita 3’
- Materialet e Shpërndara:
 - Materiali 1, dita 3, Strategjitë bazë në klasë, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
 - Materiali 2, dita 3, Plani për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
 - Materiali 3, dita 3, Studimi i rastit, 1 kopje për çdo pjesëmarrës
- Video:
 - Mësimdhënie dhe të nxëniet: <https://www.youtube.com/watch?v=e8Vx35Lym-8>
 - Këshilla për mësimdhënien e fëmijëve me autizëm: <https://www.readingrockets.org/article/three-ways-teachers-can-support-kids-autism>
 - Mos më kufizo: <https://www.youtube.com/watch?v=YOWDfnoek6E>

Axhenda:

Koha:	Tema	Aktiviteti
09.00– 09.30	Mirëpritja dhe prezantimi	Aktiviteti 1: Prezantimi (10 min.) Aktiviteti 2: Lojë për nxehje, Lëvizni-Bëhuni dyshe-Ndani (20 min.)
9.30– 10.30	Strategjitë bazë në klasë - E përgjithshme	Aktiviteti 3: Strategjitë bazë të prezantimit në klasë (20 min.) Aktiviteti 4: Strategjitë bazë të reflektimit në klasë (40 min.)
10.30– 10.45	Pushimi i çajit	
10.45– 12.00	Mësimdhënie e fëmijëve me autizëm	Aktiviteti 5: Prezantimi (30 min.)

	në klasa gjithëpërfshirëse	Aktiviteti 6: Njihuni me Julia (45 min.)
12.00– 13.00	Pushimi i drekës	
13.00– 14.00	Mësimdhënia e fëmijëve me sindromën Down në klasa gjithëpërfshirëse	Aktiviteti 7: Prezantim Aktiviteti 8: Ndarja e përvojave
14.00– 15.00	Planin për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës	Aktiviteti 9: Prezantimi i Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës (30 min.) Aktiviteti 10: Studimi i rasti (30 min.)
15.00– 15.15	Pushimi i çajit	
15.15– 15.45	Aftësitë e trajnimit	Aktiviteti 11: Reflektimi (30 min.)
15.45– 16.30	Reflektimi dhe përpunimi	Aktiviteti 12: Reflektimi mbi trajnimin (30 min.) Aktiviteti 13: Përmbledhja dhe mesazhet kyçe (15 min.)

Hyrje

Aktiviteti 1: Hyrje

Koha: 10 minuta (09.00 – 09.10)

Çfarë të bëni

Përdorni faqet e prezantimit në PowerPoint për të prezantuar:

- Objektivat e ditës së tretë
- Axhendën e trajnimit

Kujtojeni pjesëmarrësve 'listën'

Aktiviteti 2: Loja për nxehje, Lëvizni-Bëhuni dyshe-Ndani

Koha: 20 minuta (09.10 – 09.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të thyejmë akullin përpara se të nisim aktivitetet
- Të reflektojmë mbi të nxënit deri më tani
- Të prezantojmë temën e ditës

Fokusi

- Lojë për nxehje për të reflektuar mbi të nxënit deri më tani dhe prezantimi i temës së ditës

Materiale

- Asnjë

Metoda

- Loja

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Sigurohuni që pjesëmarrësit të dëgjojnë të gjitha udhëzimet përpara se të nisin aktivitetin.

Çfarë të thoni

'Do të jap 3 komanda të ndryshme gjatë lojës.

- Lëvizni: të gjithë duhet të lëvizin përreth sallës së mbledhjes
- Bëhuni dyshe: bëhuni dyshe me personin që ndodhet më pranë jush
- Ndani: diskutoni në çift rreth temës së dhënë'

Çfarë të bëni

Filloni me komandën e parë 'lëvizni'. Lëri pjesëmarrësit të lëvizin përreth dhe të përzihen përpara se të jepni komandën 'bëhuni dyshe'. Jepni komandën 'ndani' kur të gjithë të kenë gjetur një partner, nëse e shikoni të nevojshme krijoni grupe me nga 3 persona. Përsëriteni lojën 3 herë, duke pasur parasysh temat e mëposhtme për diskutim (ndani):

- Cila është kënga juaj e preferuar dhe përse?
- Cila është pika juaj kryesore e të nxënimit deri më tani dhe përse?
- Cilat kanë qenë përshtatjet e klasës që keni provuar më parë? Cili ishte rezultati?

Çfarë të thoni

'Ky aktivitet është një shembull i pedagogjisë me në qendër fëmijën. Është aktiv, gjë e cila i ndihmon disa fëmijë që të përqendrohen, përzien grupe dhe nxit ndërveprimin ndërmjet nxënësve të ndryshëm. Mund të bëni çdo lloj pyetje që të përshtatet me orën mësimore. Sot ne e kemi përdorur atë për të thyer akullin ('cila është kënga juaj e preferuar?'), për të reflektuar dhe përpunuar çfarë kemi mësuar deri më tani ('cila është pika kyçe e të nxënimit?'), si dhe për të lidhur temën e sotme (strategjitë bazë në klasë) me përvojat tuaja të mëparshme ('cilat kanë qenë përshtatjet e klasës që keni provuar më parë?')

Strategjitë bazë në klasë - E përgjithshme

Aktiviteti 3: Prezantimi i strategjive bazë në klasë

Koha: 20 minuta (9.30 – 9.50)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të prezantojmë modelet e strategjive të mësimdhënies gjithëpërfshirëse të shfaqur në situata me burime të pamjaftueshme
- Të mbështetim pjesëmarrësit të planifikojnë mënyrën e zbatimit ose përshtatjes së strategjive me në qendër nxënësin në klasë

Fokusi

- Strategjitë e mësimdhënies gjithëpërfshirëse

Materiale

- Video e mësimdhënies dhe të nxënimit: <https://www.youtube.com/watch?v=e8Vx35Lym-8>
- Laptop, projektor, ekran, altoparlantë
- Stilolapsa
- Letër
- Prezantimi 'ToT, dita 3'

- Materiali 1, dita 3, Strategjitë bazë në klasë,' 1 kopje për çdo pjesëmarrës

Metoda

- Prezantim
- Video
- Diskutime dyshe

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të thoni

'Do të shikojmë një video rreth mësimdhënies dhe të nxënit gjithëpërfshirës. Në mënyrë individuale, renditni praktikat e mësimdhënies të cilat mendoni se e vendosin fëmijën në qendër dhe mbështesin përfshirjen e të gjithë nxënësve në orën e mësimi. Sigurohuni që të keni stilolaps dhe letër për të mbajtur shënime.'

Çfarë të bëni

Shfaqni videon e një ore mësimi matematike me në qendër fëmijën.

Pasi të kenë parë videon, jepuni pjesëmarrësve 5 minuta kohë për të përfunduar në mënyrë individuale listën e strategjive të mësimdhënies me në qendër fëmijën.

Udhëzoni pjesëmarrësit të bëhen dyshe për diskutim. Sqaroni se nuk do të ketë prezantime.

Çfarë të shfaqni

Video: Mësimdhënia dhe të nxënit: <https://www.youtube.com/watch?v=e8Vx35Lym-8>

Çfarë të bëni

Shfaqni faqen e prezantimit me pyetje reflektuese. Jepuni grupeve dyshe 10 minuta kohë për të diskutuar. Shpjegoni se qëllimi është reflektimi dhe përpunimi. Nuk është e nevojshme që të shkruajnë përgjigjet apo të prezantojnë punimin.

Çfarë të shfaqni

- Pyetje për t'u diskutuar në dyshe Cilat strategji me në qendër fëmijët vutë re në këtë video?
- Si i ndihmojnë ato nxënësit që të nxënë?
- Cilat nga këto strategji keni provuar?
 - Cili ishte rezultati?
 - Çfarë funksionoi, çfarë nuk funksionoi mirë? Përse?
- Cilat strategji të reja do t'ju pëlqente të provonit?
 - Përse?

Çfarë të thoni

'Në këtë aktivitet, kemi parë shembuj të qasjeve të zakonshme të mësimdhënies që një mësues mund të prezantojë për ta bërë klasën më gjithëpërfshirëse. Këto strategji nuk kërkojnë shumë burime ose trajnim. Materiali 1, dita 3 jep këshilla të tjera mbi strategjitë bazë në klasë. Në këtë sesion do të përqendrohemi në strategjitë e përgjithshme të mësimdhënies. Më tej, do të prezantojmë strategjitë për të mbështetur të nxënit e fëmijëve me sindromën Down dhe fëmijët me autizëm në klasat gjithëpërfshirëse. Materiali përmban strategji për mbështetjen e të nxënit për fëmijët me lloje të ndryshme aftësish të kufizuara në klasa të zakonshme. Siç do të vëreni, këto strategji do të përmirësojnë procesin e të nxënit për të gjithë fëmijët dhe jo vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara'

Çfarë të bëni

Shpërndajuni të gjithëve një kopje të 'Materialit 1, dita 3, Strategjitë bazë në klasë' për t'u lexuar individualisht pas kursit të trajnimit.

Çfarë të bëni

Përdorni prezantimin për të përmbledhur strategjitë në klasë. Shfaqni videon dhe imazhet në faqet e prezantimit si shembuj

Çfarë të shfaqni

Strategjitë bazë në klasë

- Pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara (rreth 80%) mund të mësojnë në mjedisë të zakonshme nëse mësuesi aplikon pedagogji me në qendër fëmijët dhe DUN

të DUN-së

- Një grup i vogël (rreth 15%) mund të ketë nevojë për rregullime dhe përshtatje të vogla specifike në mjedisin mësimor dhe në qasjen ndaj mësimdhënies=strategji bazë në klasë
- Pak fëmijë me aftësi të kufizuara (rreth 5%) mund të kenë nevojë për mbështetje të specializuar (për shembull: mënyrë tjetër komunikimi, pajisje ndihmëse, strategji mësimdhënie më specifike). Zakonisht për këta fëmijë hartohet Plani për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes

Strategjitë bazë në klasë

- Strategjitë bazë në klasë janë të thjeshta dhe mund të aplikohen pa pasur nevojë për shumë trajnime apo burime
- Pjesa më e madhe e mësuesve që e vendosin fëmijën në i përdorin tashmë pjesën më të madhe të këtyre strategjive
- Strategjitë do të rrisin cilësinë e arsimit për të gjithë fëmijët, jo vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara

Strategjitë bazë në klasë-Të Përgjithshme

- Jini të qartë në atë që prisni, që mund të jetë e ndryshme për fëmijë të ndryshëm
- Përdorni parimet e Dizenjimit Universal: prezantoni mësimet kyçe në mënyra të ndryshme, duke organizuar veprimtari të ndryshme
- Ndërtojini veprimtaritë me nivele të ndryshme dhe lërinin nxënësit të zgjedhin atë që i duket më i përshtatshëm
- Ndërveproni me nxënësit gjatë mësimt:
 - Vëzhgoni, kontrolloni dhe monitoroni për t'u siguruar që ata po bëjnë atë që ju prisni që ata të bëjnë
 - Lavdërojini dhe inkurajojini
 - Kontrolloni nëse ju kanë kuptuar

Strategjitë bazë në klasë-Të Përgjithshme

- Përdorni logjikën
 - Tregohuni më të duruar me fëmijët që kanë nevojë për më shumë kohë për t'i kuptuar gjërat
 - Përsërisni informacionin dhe udhëzimet, kur është e nevojshme
 - Jepini më shumë kohë disa fëmijëve për të përfunduar detyrën
- Sigurohuni që fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë të gjithë të grupuar së bashku, formoni grupe me aftësi të përziera për aktivitetet
- Për testet kryesore:
 - Jepini mundësi fëmijëve me aftësi të kufizuara të kuptojnë pyetjet dhe për të shkruar përgjigje
 - me mbështetjen e ndihmësve ose të nxënësve të tjerë

Aktiviteti 4: Reflektimi i strategjive bazë në klasë

Koha: 40 minuta (9.50 – 10.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të reflektojmë mbi përdorimin e strategjive bazë në klasë për klasat gjithëpërfshirëse

Fokusi

- Diskutim në grup për të përpunuar të nxënësit sipas strategjive bazë të mësimdhënies

Materiale

- Laptop, projektor, ekran, altoparlantë

- Stilolapsa
- Letër
- Flipchart
- Lapustila
- Shirit ngjitës
- Prezantimi 'ToT, dita 3'

Metoda

- Diskutim në grupe të vogla

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Udhëzoni pjesëmarrësi të krijojnë grupe të vogla (4 ose 5 pjesëmarrës për grup). Sigurohuni që të gjithë grupet të kenë një flipchart dhe lapustila. Kërkojuni grupeve të kopjojnë tabelën nga faqja e prezantimit dhe të diskutojnë rreth pyetjeve kyçe. Kërkojuni grupeve të zgjedhin një prezantues, preferohet një i ri. Sqaroni se çdo grup do të ketë vetëm 2 minuta kohë për të bërë prezantimin.

Çfarë të shfaqni

Shfaqni faqet e prezantimit me pyetjet kyçe për diskutimin në grup.

Cilën prej këtyre strategjive përdorni aktualisht?	Si e përmirësojnë të nxënësit për të gjithë fëmijët këto strategji?	Cilat strategji të reja do t'ju pëlqente të provonit? Përse?

Çfarë të bëni

Jepuni grupeve 15 minuta kohë për të reflektuar dhe për të diskutuar. Kërkojuni të bëjnë një përmbledhje të diskutimit në një flipchart dhe më pas ta varin atë në mur. Çdo grup do të ketë 2 minuta kohë për të bërë prezantimin, respektoni kohën rreptësisht. Sigurohuni që grupet që mos përsërisin çfarë është ndarë nga grupet e mëparshme.

Mësimdhënie e fëmijëve me autizëm në klasa gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 5: Prezantim

Koha: 30 minuta (10.45 – 11.15)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të kuptojmë bazat e autizmit
- Të prezantojmë strategjitë e të nxënësit për të mbështetur fëmijët me autizëm në klasa të përgjithshme

Fokusi

- Strategjitë bazë të mësimdhënies për të mbështetur të nxënësit e fëmijëve me autizëm në

arsimin gjithëpërfshirës

Materiale

- Prezantimi: 'ToT, dita 3'
- Laptop, projektor

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni


Shfaqni faqet e prezantimit për t'u njohur me autizmin dhe për të dhënë ide për strategjitë e mësimdhënies në klasat gjithëpërfshirëse.

Jepni shembuj për të treguar se si të gjithë fëmijët do të përfitojnë nga këto strategji

Çfarë të shfaqni

Çfarë është autizmi?

- Termi 'autizëm' ose 'çrregullim i spektrit të autizmit' mbulon shumë çrregullime dhe sindroma të ndryshme
- Personat me autizëm kanë vështirësi në 3 fusha:
 - Të kuptuarit social dhe sjellja sociale
 - Komunikimi social
 - Mënyrë e ngurtë e të menduarit dhe vështirësi me imagjinatën sociale
- Shumë fëmijë pa autizëm mund të kenë pasur vështirësi të ngjashme, por fëmijët me autizëm kanë vështirësi në të treja fushat.
- Shkaqet e shfaqjes së autizmit janë gjerësisht të panjohura



Strategjitë e mësimdhënies

- Përdorni gjuhë të drejtpërdrejtë dhe konkrete, shmangni gjuhën figurative
- Përdorni fjali të shkurtra
- Vendosni një rutinë ditore të qartë dhe një strukturë, paramendojeni rutinën
- Jepni shenja për kalim nga një aktivitet te tjetri
- Përsërisni udhëzimet dhe kontrolloni që ju kanë kuptuar
- Jepini kohë shtesë për të përpunuar udhëzimet dhe pyetjet
- Kufizojeni kohën e leksioneve, përfshini më shumë aktivitete
- Përdorni objekte konkrete për të shpjeguar koncepte abstrakte

Strategjitë e mësimdhënies

	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorni teknika alternative komunikimi (tabela me foto, gjuhën e shenjave, gjeste,...) • Shmangni stimulimin e tepërt • Shmangni shpërqendrimin shqisor • Reduktoni stresin • Drejtojuni fëmijëve individualisht (tërhiqini vëmendjen, përsëritini udhëzimet) • Bëni lidhjen midis aktiviteteve në klasë dhe interesave personale
	<p>Strategjitë e mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetini fëmijët në aktivitetet e lira • Jepuni mundësi për të përgjithësuar aftësitë e mësuara nga një mjedis dhe për t'i aplikuar në situata/mjedise të tjera • Pranoni se disa probleme të sjelljes vijnë për shkak të ankthit • Përdorni përforsimin pozitiv në vend të ndëshkimit • Punoni me rregullat dhe aftësitë sociale (si mbajtja e radhës, distanca sociale) • Mbrojini fëmijët nga ngacmimet dhe bullizmi

Aktiviteti 6: Strategjia e mësimdhënies së fëmijëve me autizëm në mjediset gjithëpërfshirëse

Koha: 45 minuta (11.15 – 12.00)

Përmbledhje

<p>Qëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njihemi me autizmin • Të reflektojmë mbi strategjitë e mësimdhënies për fëmijët me autizëm <p>Fokusi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategjitë bazë të mësimdhënies për të mbështetur të nxënëit e fëmijëve me autizëm në arsimin gjithëpërfshirës <p>Materiale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi: 'ToT, dita 3' • Laptop, projektor • Video: https://www.readingrockets.org/article/three-ways-teachers-can-support-kids-autism <p>Metoda</p> <ul style="list-style-type: none"> • Video dhe diskutim në grup
--

Hapat e aktiviteteve

<p>Çfarë të bëni</p> <p>Prezantoni klipin me pyetjet e diskutimit përpara se të shfaqni videon.</p>	<p>Çfarë të shfaqni</p> <p>Pyetje për diskutim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cilën prej strategjive të mësimdhënies për fëmijët autikë njihni? • Çfarë strategjish të tjera mund t'ju vijnë ndërmend? • Si e përmirësojnë të nxënëit për fëmijët e tjerë këto strategji? • Çfarë duhet të ndodhë në shkollën tuaj në mënyrë që të keni mundësinë të zbatoni këto strategji? <p>(Për çfarë lloji mbështetjeje, burimesh, trajnimesh,... keni nevojë?)</p>
--	---

Çfarë të bëni

Shfaqni videon me këshilla për mësimdhënien e fëmijëve me autizëm.

Pasi të keni shfaqur videon, kërkojuni pjesëmarrësve të diskutoni pyetjet në grupet e tyre të vogla. Shpërndajini secilit grup një flipchart, lapustila dhe shirit ngjitës. Kërkojuni të përgatisin një prezantim të shkurtër jo më shumë se 2 minuta. Grupet duhet të përzgjedhin një prezantues të ri. Grupet mund të prezantojnë vetëm gjëra të tjera dhe jo të përsërisin atë që kanë ndarë grupet e mëparshme.

Çfarë të shfaqni

Këshilla për mësimdhënien e fëmijëve me autizëm:

<https://www.readingrockets.org/article/three-ways-teachers-can-support-kids-autism>

Mësimdhënia e fëmijëve me sindromën Down në klasa gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 7: Prezantim

Koha: 30 minuta (13.00 – 13.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të kuptojmë bazat e sindromës Down
- Të prezantojmë strategjitë e mësimdhënies për të mbështetur fëmijët me sindromën Down në klasa të përgjithshme

Fokusi

- Strategjitë bazë të mësimdhënies për të mbështetur të nxënit e fëmijëve me sindromën Down në arsimin gjithëpërfshirës

Materiale

- Prezantimi: 'ToT, dita 3'
- Video: Mos më kufizo: <https://www.youtube.com/watch?v=YOWDfnoek6E>
- Laptop, projektor

Metoda

- Prezantim
- Video për reflektim individual

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Shfaqni faqet e prezantimit për t'u njohur me sindromën Down dhe për të dhënë ide për strategjitë e mësimdhënies në klasat gjithëpërfshirëse.

Jepni shembuj për të treguar se si të gjithë

Çfarë të shfaqni

Çfarë është Sindroma Down?

- Sindroma Down është një çrregullim gjenetik, i shkaktuar nga një material gjenetik ekstra në kromozomin 21 (Sindroma Down quhet edhe trizonomia 21)
- Fëmijët me sindromën Down nuk kanë një lloj personaliteti të veçantë.
- Disa fëmijë me Sindromën Down mund të përdornin disa

fëmijët do të përfitojnë nga këto strategji	<p>mekanizma të përbashkëta për të përballuar situata të ndryshme, por ato nuk janë specifike për të gjithë fëmijët me Sindromën Down:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdorimi i një rutine, mbajtja e rregullit dhe njëtrajshmërisë si një mënyrë për të arsyetuar dhe kontrolluar jetën e tyre • e folura me vete për të kontrolluar sjelljet, shprehja e ndjenjave dhe përpjekja për të arritur të kuptojë çfarë po ndodh • shmangia e ndryshimit dhe ndjekja e rutinës në mënyrë që të ruajnë kontrollin dhe të kufizojnë ngatërresat
	<p>Strategjitë e mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorni fjalë të thjeshta dhe fjali të shkurtra. Sigurohuni që nxënësi të ketë kuptuar • Përdorni objekte reale për të shpjeguar koncepte, jo vetëm përdorimi i komunikimit verbal ose fjalëve të shkruara • Prezantoheni materialin në mënyra të ndryshme (mënyrë pamore, dëgjimore, praktike,...) • Përdorni tekste me shkronja të mëdha dhe shenja pamore • Jepni udhëzime të shkruara dhe verbale • Zhvilloni vetëm një aktivitet për radhë dhe lajmëroni qartazi kur njëri mbaron aktiviteti dhe kur fillon tjetri • Ndajeni detyrën në detyra më të vogla dhe objektiva mësimore
	<p>Strategjitë e mësimdhënies</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përpquni të lidhni detyrat me përvojat e përditshme të fëmijës dhe me jetën e përditshme • Injoroni sjelljen e padëshiruar, kur është e mundur Lavdëroni dhe jepini vëmendje fëmijës, kur ai sillet mirë • Motivoni fëmijët e tjerë në klasë ta përfshijnë fëmijën në lojërat jashtë klasës dhe aktivitetet sportive • Krijoni një sistem “miqsh” në të cilin fëmijët të ndihmojnë njëri-tjetrin për të kuptuar dhe përfunduar me sukses aktivitetet • Vazhdoni të mbani pritshmëri të larta
<p>Çfarë të bëni</p> <p>Shfaqni videon ‘Mos më kufizo’: https://www.youtube.com/watch?v=YOWDfnoek6E</p> <p>Jepuni pjesëmarrësve disa minuta kohë për të reflektuar në mënyrë individuale rreth mesazhit nga Megan. Pas disa minutash, pyetni 2 ose 3 pjesëmarrës se çfarë mund të mësojnë nga mesazhi i Megan për të përmirësuar punën e tyre si mësues ndihmës.</p>	

Aktiviteti 8: Ndarja e përvojave

Koha: 30 minuta (13.30 – 14.00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të ndajmë përvojat e mësimdhënies së fëmijëve me sindromën Down

Fokusi

- Strategjitë bazë të mësimdhënies për të mbështetur të nxënit e fëmijëve me sindromën Down në arsimin gjithëpërfshirës

Materiale

- Asnjë

Metoda

- Diskutim në të gjithë grupin

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Lehtësoni diskutimin në të gjithë grupin. Pyesni nëse ndonjë nga pjesëmarrësit ka përvojë në mësimdhënien me sindromën Down dhe nëse kanë dëshirë të ndajnë përvojën e tyre. Nëse askush nuk ka përvojë në mësimdhënien e fëmijëve me sindromën Down, zgjeroheni atë tek fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale.

Nëse ndonjë nga pjesëmarrësit ka dëshirë të ndajë përvojën e tij, kërkojini:

- Të thotë diçka më shumë rreth fëmijës: pikat e forta, interesat, vështirësitë
- Të reflektojë mbi barrierat e të nxënit dhe pjesëmarrjes për fëmijën
- Të ndajë strategjitë për kapërcimin e barrierave
- Të ndajë strategjitë e mësimdhënies dhe rezultatin përkatës

Të inkurajojë pjesëmarrësit e tjerë të dëgjojnë, reagojnë dhe të bëjnë pyetje. Të sigurohet që pyetja t'i drejtohet folësit dhe jo juve si lehtësues.

Planin për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës

Aktiviteti 9: Prezantim i Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës

Koha: 30 minuta (14.00 –14.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të prezantojmë Planin për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës si mjet për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse, si dhe për të ofruar mbështetje

Fokusi

- Prezantimi me informacione bazë rreth Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës

Materiale

- Projektor, laptop, ekran
- Prezantimi: 'ToT, dita 3'
- Materiali 2, dita 3, Plani për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës, 1 kopje për çdo pjesëmarrës

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të thoni

'Ashtu siç është diskutuar më parë, nëse mësuesi zbaton DUN-ën dhe parimet e pedagogjisë me në qendër fëmijën, pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuara (rreth 85%) mund të bëhet pjesë e klasave të zakonshme pa pasur nevojë për kushte specifike. Për një grup të vogël fëmijësh me aftësi të kufizuara (rreth 10%), mësuesi do t'i duhet të zbatojë strategji specifike dhe bazike në klasë. Disa fëmijë me aftësi të kufizuara (rreth 5%) kërkojnë më shumë mbështetje specifike, ofrim ose mbështetjen e një specialisti për të mësuar dhe marrë pjesë në klasa gjithëpërfshirëse. Plani për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës ndihmon në mbledhjen e informacioneve, vendosjes së qëllimeve të duhura, si dhe të tregojë mbështetje dhe ofrim për grupin e lartpërmendur të fëmijëve.'

Çfarë të bëni


Shpërndajuni të gjithë pjesëmarrësve një kopje të modelit të Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës: Materiali 2, dita 3, Plani për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës

Çfarë të ndani

Plani për mbështetjen e familjes dhe fëmijës

Emri i fëmijës:

Vendosni fotografinë e fëmijës këtu :



Ky plan nisi më:

Numri i planit:

Ky plan do të rishikohet më:

Data e rishikimit të fundit:

Çfarë të bëni

Shfaqni faqet e prezantimit për t'u njohur me përmbajtjen kyçe të Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës. Prezantoni broshurën plotësuese me informacione të tjera rreth temës.

Çfarë të shfaqni

- Plani për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes shërben si mjet për:
 - Mblidhni informacion për shkollën, shtëpinë dhe fëmijën
 - Vendosni objektiva personale dhe mësimore mbi këtë informacion
 - Planifikoni mbështetjen dhe masat paraprake për t'i arritur këto objektiva
- Ky është një proces me pjesëmarrje të një ekipi palësh të interesuara, që përfshijnë:
 - Fëmijën, prindërit dhe vëllezërit e motrat
 - Mësuesin, mësuesin kujdestar, shokët
 - Edukatorët specialë, terapistët, punonjësit socialë
- Zgjidhet një lehtësues për t'u siguruar që është zhvilluar plani, për të mbledhur ekipin, ndërmarrë fillimin e mbledhjeve, vëzhguar zbatimin dhe monitorimin

Çfarë të thoni

'Planet për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës' krijohen nga një model social ose i bazuar në rregulla të aftësisë së kufizuar. Kjo do të thotë se fokusi është mbi barrierat e aksesit

Përmbajtja kyçe

- Plani për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes e ka fokusin mbi:
 - Çfarë mund të bëjë fëmija
 - Endrrat, prioritetet dhe qëllimet
 - Mbështetja për përmbushjen e këtyre qëllimeve

Fokusi NUK është tek dobësitë ose mangësitë

dhe pjesëmarrjes, si dhe mbi atë që mund të bëjnë palët e interesuara nga komuniteti i shkollës për të mbështetur fëmijën në kapërcimin e këtyre barrierave. Fokusi nuk është mbi mënyrën e ndryshimit të fëmijës për ta përshtatur atë me sistemin aktual arsimor.’

<p>Struktura</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ballina, datat e rishikimit, detajet e kontaktit dhe informacioni kyç • Seksioni A ‘çfarë duhet të dinë profesionistët rreth fëmijës: pikëpamjet, interesat dhe shpresat e fëmijës dhe prindërve • Seksioni B ‘Vlerësimi’: pikat e forta, aftësitë dhe nevojat për mbështetje, për të arritur qëllimet personale në fushën e <ul style="list-style-type: none"> • Komunikimit dhe ndërveprimit • Aftësive njohëse dhe të nxënit • Shëndetit social, emocional dhe mendor • Nevojave ndijore dhe/ose fizike • Nevojave shëndetësore
<ul style="list-style-type: none"> • Seksioni C ‘Qëllimet’: qëllimet afatgjata dhe afatshkurtra të vendosura nga i gjithë ekipi • Seksioni D ‘Masat mbështetëse’: strategjitë për të arritur qëllimet, duke përfshirë mbështetjen e nevojshme, masat dhe burimet • Seksioni E ‘Rregullimet për rishikimin e planit’: pjesa kyçe, plani duhet të jetë dinamik dhe i vënë në praktikë
<p>Grackat e zakonshme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fokusimi mbi problemet e fëmijës <ul style="list-style-type: none"> → Në fakt, fokusi duhet të jetë në akomodimin e arsyeshëm në mjedis dhe bazuar në pedagogji, për t’u siguruar aksesin e fëmijës në kurrikulë • Plani hartohet nga vetë mësuesi ose mësuesi ndihmës <ul style="list-style-type: none"> → PMFF është një proces bashkëpunimi • Fëmija ose familja nuk përfshihet <ul style="list-style-type: none"> → Fëmija dhe familja duhet të përfshihen në të gjitha takimet dhe zëri i tyre duhet të dëgjohet. Për këtë, mund të jetë e nevojshme që të gjitha palët e interesuara të thjeshtëzojnë përmbajtjen, të përdorin metoda miqësore me fëmijët gjatë diskutimeve dhe të përdorin mënyra komunikimi alternative, nëse shihet e nevojshme
<ul style="list-style-type: none"> • Plani hartohet, por nuk vihet në praktikë <ul style="list-style-type: none"> → Arsytet e mundshme: qëllimet nuk ishin realiste ose me rëndësi, seksioni i vlerësimit mbase nuk ka përfshirë mjaftueshëm detaje për mënyrën se si duhet të përshtatet mjedisi shkollor dhe mësimi, seksioni i masave nuk qartëson mjaftueshëm cilat strategji do të përdoren për të arritur qëllimet ose strategjitë nuk janë përshtatur me qëllimet. • Plani nuk është rishikuar ose përditësuar <ul style="list-style-type: none"> → PMFF është dinamik dhe duhet rishikuar dhe përditësuar të paktën çdo 6 muaj • Mbështetja, masat dhe burimet janë kuptuar në mënyrë sipërfaqësore <ul style="list-style-type: none"> → Mbështetja është më tepër sesa ndërhyrja e ekspertëve, ajo përfshin gjithashtu mbështetjen e mësuesve, mbështetjen fëmijë-fëmijë, vullnetarë të komunitetit, ...

Mbledhja e të dhënave për PMFF

Vlerësimi bazohet në burime informacioni të ndryshme:

- Vlerësimi në klasë nga mësuesi i zakonshëm: rezultate të vlerësimit formues
- Vlerësimi nga specialistët: teste nga edukatorë specialë ose terapistë, kur është e nevojshme
- Informacioni i mbledhur nga fëmija, prindërit, vëllezërit e motrat dhe shokët

Aktiviteti 10: Studimi i rastit

Koha: 30 minuta (14.30 – 15.00)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të prezantojmë Planin për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës si mjet për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse, si dhe për të ofruar mbështetje

Fokusi

- Studimi i rastit për të reflektuar rreth Planit për Mbështetjen e Familjes dhe Fëmijës

Materiale

- Flipchart-e
- Lapustila
- Shirit ngjitës
- Projektor, laptop, ekran
- Prezantimi: ToT, dita 3
- Materiali 3, dita 3, Studimi i rastit, 1 kopje për çdo pjesëmarrës

Metoda

- Studimi i rastit me reflektim në grup

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Kërkojuni pjesëmarrësve të krijojnë grupe të vogla me 4 deri në 5 pjesëmarrës. Shpërndajuni pjesëmarrësve një kopje të Materialit 3, dita 3 me udhëzime për grupin e punës, studimin e rastit dhe pyetjet reflektuese. Jepuni pjesëmarrësve 20 minuta kohë për të punuar në grupin e tyre të punës. Nuk do të ketë prezantime.

Çfarë të ndani

Materiali 3 - Dita 3: Rast studimor

Dita 3 - Planifikimi për arsim gjithëpërfshirës
Aktiviteti 10 - Rast studimor

Udhëzime

- Lexoni historinë e Ling-Ling-ut
- Diskutoni pyetjet me grupin tuaj të vogël
- Mos raportoni

Historia e Ling-Ling-ut^{xiv}

Ling-Ling-u është një vajzë 4 vjeçe e gjysmë me sindromën Down. Ajo ka marrë ndërhyrje të hershme në një qendër shëndetësore vendase. Në fillim të vitit, mësuesja e ndërhyrjes së hershme ishte e shqetësuar për aftësitë e saj të vonuara të gjuhës së folur dhe ato motorike, dhe sugjeroi që Ling-Ling-u të merrte ndërhyrje terapeutike fizike dhe të gjuhës së folur. Tre muaj më vonë, mësuesja e Ling-Ling-ut ishte e frustruar nga fakti që Ling-Ling kishte pasur progres minimal në aftësitë e gjuhës së folur dhe motorike. Ajo gjithashtu zbuloi se prindërit e Ling-Ling-ut nuk e kishin ndjekur planin e ndërhyrjes në shtëpi, një përcaktues kritik i suksesit. Çfarë ajo nuk dinte ishte se familja e Ling-Ling-ut kishte shqetësime të tjera.

Të pasurit e një fëmije me aftësi të kufizuara ka një ndikim thelbësor dhe afatgjatë në familjen e Ling-Ling-ut. Kjo gjë ndryshon sistemin e besimit që familja ka ndjekur për breza me radhë. Budizmi është

	<p>feja e kësaj familjeje, dhe ata besojnë se çfarë do të bëjnë në këtë botë do të përcaktojë se çfarë do të bëhen në botën tjetër pas vdekjes. Z. Dhe Znj. Chan besonin se të pasurit e një fëmije me aftësi të kufizuara ishte dënim nga perëndia për një gabim të bërë prej tyre ose paraardhësve. Prandaj, e vetmja mënyrë për t'u përballur me aftësinë e kufizuar ishte të punuarit fort dhe pendesa. Ata nuk besonin se kishin fuqinë të ndryshonin ose përmirësonin gjendjen e Ling-Ling-ut. Të dy ata punonin me kohë të plotë. Ata nuk kishin shumë kohë për terapinë në shtëpi të Ling-Ling dhe ndiheshin më rehat të kërkonin mbështetje nga familjarët e tyre se sa të merrnin ndihmë profesionale. Ata e konsideronin përkujdesjen dhe mbrojtjen e Ling-Ling si përparësinë e familjes.</p>
<p>Çfarë të bëni Shfaqni në ekran faqet e prezantimit me pyetje për diskutim në grup</p>	<p>Çfarë të shfaqni Pyetje për rastin studimor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cila është vlera e shtuar e përfshirjes së fëmijëve në procesin e PMFF? (Ling-Ling, i vëllai Sam dhe shokët Sarah dhe Tom) • Cilat janë prioritetet për palët e ndryshme të interesuara? • Cilat janë pikat e forta dhe burimet në komunitetin e Ling-Ling? • Formuloni të paktën një qëllim afatgjatë për Ling-Ling
<p>Çfarë të bëni Pas 20 minutash, përmbliidhni shkurtimisht përgjigjet e mundshme për pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cila është vlera e shtuar për përfshirjen e fëmijëve në procesin CFSP? (Ling-Ling, vëllai Sam, si dhe miqtë Sarah dhe Tom) <ul style="list-style-type: none"> • Ling-Ling ka të drejtën themelore të përfshihet dhe të ngrejë zërin në vendimet që prekin jetën e saj • Intervistat me fëmijët sollën perspektiva të papritura dhe të reja gjatë diskutimeve • Kjo gjë u kujtoi të rriturve se Ling-Ling është një vajzë 4-vjeçare dhe ka ëndrra dhe pritshmëri të ngjashme me çdo fëmijë tjetër moshatar • Prindërit kuptuan se sa mirë Ling-Ling pranohet nga miqtë e saj • Cilat janë prioritetet për palët e ndryshme të interesit? <ul style="list-style-type: none"> • Ling-Ling dhe Sarah: të shikojnë njëri-tjetrin çdo ditë në shkollë • Tom: të luajë futboll me Ling-Ling • Sam: dëshiron që Ling-Ling të shkojë në universitet • Prindërit: Ling-Ling të ketë kujdesin më të mirë • Terapistët: të përmirësojnë aftësitë e ligjërimit dhe të gjuhës në mënyrë që Ling-Ling të mund të shprehë veten më mirë, si dhe të përmirësojë aftësitë bazë motorike • Cilat janë pikat e forta dhe burimet në komunitetin e Ling-Ling? <ul style="list-style-type: none"> • Ling-Ling ka miq që shqetësohen për të dhe që luajnë me të • Vëllai i saj është i dashur dhe luan me të pas shkolle • Prindërit e saj janë punëtorë, kujdesen shumë për të dhe janë përkrahës • Pjesëtarët e familjes ofrojnë mbështetje sipas nevojës • Ka akses në ndërhyrjen e hershme • Formuloni të paktën një term të gjatë për Ling-Ling 	

Aftësitë e trajnimit

Aktiviteti 11: Rrahje mendimesh

Koha: 30 minuta (15.15 – 15.45)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të diskutojmë aftësitë e lehtësimit dhe trajnimit

Fokusi

- Reflektim mbi përvojat e trajnimit për të identifikuar aftësitë e lehtësimit

Materiale

- Flipchart-e të ndara në 2 kolona
- Lapustila
- Shirit ngjitës
- Pusulla me ngjitje për shënim në ngjyrë të verdhë dhe të gjelbër
- Projektor, laptop, ekran
- Prezantimi: ToT, dita 3

Metoda

- Rrahje mendimesh në grup
- Prezantim

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Sigurohuni që të gjithë pjesëmarrësit të kenë një stilolaps dhe pusulla me ngjitje për shënim në ngjyrë të gjelbër dhe të verdhë.

Vareni flipchart-in në pjesën e përparme të sallës së mbledhjes. Ndajeni në 2 kolona.

Shfaqni faqen e prezantimit me udhëzime për aktivitetin e rrahjes së mendimeve. Shpjegoni se përse ky aktivitet duhet të kryhet individualisht. Kërkojuni të gjithë pjesëmarrësve të mendojnë për një përvojë trajnimi ose seminar të mëparshëm. Udhëzoni t'i shkruajnë të gjitha gjërat që i ndihmuan të mësojnë në një pusullë me ngjitje për shënim në ngjyrë të gjelbër dhe të gjitha ato gjëra që penguan procesin e të nxënimit në një pusullë me ngjitje për shënim në ngjyrë të verdhë. Sigurohuni që të shkruajnë vetëm 1 gjë në çdo pusullë.

Nëse është e nevojshme, bëjini pjesëmarrësit pyetje të tjera: a vutë re diçka në sjelljen e lehtësuesit, llojin të aktiviteteve, strukturën e sallës së mbledhjes, prezantime...që ju ndihmoi ose jo të mësoni?

Theksoni se ky aktivitet është individual dhe i shpejtë. Pasi pjesëmarrësit të kenë përgatitur pusullat, kërkojuni t'i ngjisin në flipchart në pjesën e përparme të sallës së mbledhjeve. Filloni të gruponi përgjigjet e ngjashme. Lexoni përgjigjet me zë të lartë dhe përmblihdhini ato.

Çfarë të bëni

Kaloni faqet e prezantimit me këshillat e lehtësimit. Sigurohuni që t'i keni analizuar

Çfarë të shfaqni

Rrahje mendimesh

Udhëzime:

- Mendoni për kurset trajnuese ose workshop-et që keni ndjekur në të kaluarën

Shkruani në një letër me ngjitës ngjyrë të gjelbër çfarë ju ndihmoi rrahja e mendimeve të mësoni

Shkruani në një letër me ngjitës të verdhë çfarë ju pengoi të mësoni

Çfarë të shfaqni

Aftësitë lehtësuese

Përdorni parimet e pedagogjisë me në qendër fëmijët

- Krijoni mundësi kuptimplota të nxënies

aftësitë dhe këshillat gjatë trajnimit

- Qartësoni qëllimin e sesionit trajnues
- Bëni lidhjen me përvoja dhe njohuri të mëparshme
- Siguroni mundësi për të praktikuar dhe zbatuar
- Tregoni sa i rëndësishëm është mësimi në praktikën e përditshme në shkollë
- Pranoni që edhe pjesëmarrësit në trajnim mësojnë në mënyra të ndryshme, prandaj ofroni të njëjtën përmbajtje në mënyra të ndryshme
- Pjesëmarrësit në trajnim mësojnë së bashku dhe nga njëri-tjetri
- Ambienti ku zhvillohet trajnimi duhet të jetë i aksesueshëm dhe mikpritës
- Ofroni një gamë e gjerë mënyrash që pjesëmarrësit në trajnim të tregojnë çfarë dinë dhe çfarë janë të aftë të bëjnë

Jepni këshilla për të menaxhuar nivelin e vëmendjes të pjesëmarrësve

- Diskutoni dhe bini dakord mbi rregullat bazë në fillim të sesionit
- Kujtojani këto rregulla bazë pjesëmarrësve kur është e nevojshme
- Qëndroni pranë pjesëmarrësve për t'i tërhequr vëmendjen
- Vëzhgoni pjesëmarrësit e zhurmshëm
- Kërkojini pjesëmarrësve t'ju mbështesin duke mbajtur vëmendjen brenda grupit (t'i kërkojnë njëri-tjetrit të ndalojnë së foluri dhe prezantojnë para grupit, dhe jo përpara trajnuesit)

Këshilla për të menaxhuar nivelin e vëmendjes të pjesëmarrësit

- Ecni përreth sallës së takimeve teksa prezantoni
- Përdorni metoda ndërvepruese dhe me pjesëmarrje, kur është e nevojshme
- Parashikoni pushime
- Parashikoni ushtrime energjizuese
- Ndaloni prezantimin dhe kërkon vëmendje

Këshilla për menaxhimin

- Caktoni dikë të mbajë kohën
- Praktikoni sesionet më parë në mënyrë që të keni një ide realiste të asaj çfarë mund të mbuloni në një sesion
- Ndani materialet për t'u lexuar dhe videot përpara fillimit të sesionit
- Kujtoni pjesëmarrësit të flasin shkurt dhe me vend kur japin kontributin e tyre.
- Shmangni prezantimet në grup, nëse është e nevojshme. Përdorni metoda alternative si analizimi i posterit, reflektim në grup pa prezantim, përmbledhje nga trajnuesi

Këshilla të përgjithshme

- Njihni përmbajtjen e trajnimit:
- Lexoni materialin, prezantimet, udhëzuesin e lehtësuesit dhe broshurën për pjesëmarrësit përpara trajnimit
- Kërkon informacion shtesë për kuptueshmëri më të thellë
- Shikoni videot para trajnimit
- Identifikoni 1 ose 2 mesazhe kyçe për ditën e trajnimit
- Sigurohuni të vini theksin te këto mesazhe

Reflektimi dhe përpunimi

Aktiviteti 12: Reflektimi mbi trajnimin

Koha: 30 minuta (15.45 – 16.15)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të reflektojmë mbi mësimet e marra në trajnim dhe se si ato do t'i ndihmojnë pjesëmarrësit në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës

Fokusi

- Reflektim mbi pikat kryesore të të nxënit

Materiale

- Pusulla (me 3 ngjyra të ndryshme)
- Flipchart
- Lapustila
- Prezantimi 'ToT, dita 3'

Metoda

- Reflektim individual
- Diskutim në grup

Hapat e aktiviteteve

Çfarë të bëni

Mbyllni trajnimin me një aktivitet reflektimi. Kërkojuni pjesëmarrësve të reflektojnë në mënyrë individuale. Jepuni pusulla ose copa të vogla letre në 3 ngjyra të ndryshme. Caktoni 1 ngjyrë për sa më poshtë:


- 3 gjërat kyçe që kam mësuar
- 2 mënyrat përmes të cilave mund të zbatoj atë që kam mësuar
- 1 pyetje ende pa përgjigje

Çfarë të thoni

Do ta mbyllim trajnimin përmes një aktiviteti reflektimi të njohur si 3-2-1. Do të merrni pusulla ose letra me ngjyra dhe më pas do t'ju kërkoj të reflektoni në mënyrë individuale për sa më poshtë:

- 3 gjërat kyçe që kam mësuar
- 2 mënyrat përmes të cilave mund të zbatoj atë që kam mësuar
- 1 pyetje që dua të bëj

Çfarë të shfaqni



Çfarë të bëni

Jepuni pjesëmarrësve 10 minuta kohë për të menduar dhe shkruar reflektimet e tyre në mënyrë individuale. Më pas, kërkojuni pjesëmarrësve t'i ndajnë ato në grupin e tyre të vogël. Kërkojini një lehtësuesi të menaxhojë diskutimin dhe një dokumentuesi të përmbledhë përgjigjet e grupit në një flipchart të ndarë në 3 kolona sipas aktivitetit 3-2-1 të shfaqur më lart.

Sqaroni se diskutimi në grup përbën një mundësi për të shkëmbyer mësimet kyçe, si dhe për t'i bërë pyetje njëri-tjetrit. Pjesëmarrësit e tjerë mund të kenë informacione për pyetjet e ngritura nga pjesëtarë të tjerë.

Jepuni grupeve 20 minuta kohë për të diskutuar. Kërkojuni grupeve të caktojnë një raportues. Jepini

çdo raportuesi 2 minuta kohë për të ndarë një përmbledhje të informacioneve të grupit të tyre.

Aktiviteti 13: Përmbledhja dhe mesazhet kyçe

Koha: 15 minuta (16.15 – 16.30)

Përmbledhje

Qëllimi

- Të përmbledhim ato që janë mësuar sot

Fokusi

- Vendosja e theksit mbi mesazhet kyçe

Materiale

- Laptop, projektor, ekran
- Prezantimi 'ToT, dita 3'

Metoda

- Prezantim

Hapat e aktiviteve

Çfarë të bëni

Përmbledhni gjërat e mësuara sot duke kaluar në faqe të ndryshme prezantimi

Çfarë të shfaqni

Përmbledhja

- Strategjitë bazë në klasë mund të zbatohen pa pasur nevojë për shumë trajnime ose burime
- Pjesa më e madhe e mësuesve që e vendosin fëmijën në i përdorin tashmë pjesën më të madhe të këtyre strategjive
- Strategjitë do të rrisin cilësinë e arsimit për të gjithë fëmijët, jo vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara

Përmbledhja

- Plani për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes shërben si mjet pjesëmarrës për:
 - Mblidhni informacion për shkollën, shtëpinë dhe fëmijën
 - Vendosni objektiva personale dhe mësimore mbi këtë informacion
 - Planifikoni mbështetjen dhe masat paraprake për t'i arritur këto objektiva
- Fokusi i Planit për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjes: çfarë mund të bëjë fëmija, ëndrrat dhe prioritetet, JO dobësitë dhe mangësitë
- Fokusohuni në largimin e barrierave, jo në masa individuale
- Bëni përpjekje si ekip, duke përfshirë fëmijën dhe vëllezërit/motrat, shokët e tij/saj
- Të rishikohet rregullisht

Strategjitë të përdorura në klasë nga mësuesit gjatë përvojës kanë qenë të ndërlikuara

- Megjithatë, këto strategji bëjnë një diferencë të madhe për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përmirësojnë cilësinë e arsimit për të gjithë
- Arsimi gjithëpërfshirës = përpjekje në bashkëpunim për të identifikuar dhe larguar barrierat. Plani për Mbështetjen e Fëmijëve dhe Familjeve mund të na ndihmojë me këtë drejtim

Çfarë të bëni

Kontrolloni nëse ka pyetje të listuara në flipchart, të cilave tashmë mund t'u jepet përgjigje. Nëse gjykohet e nevojshme, referojuni seancave në ditët e ardhshme për t'u siguruar që problemet do të adreson më vonë gjatë trajnimit.

Materiale, dita 3

Materiali 1, dita 3: Strategjitë bazë në klasë

Dita 3 - Planifikimi për arsimin gjithëpërfshirës

Aktiviteti 3 - Strategjitë bazë në klasë - Prezantim

Strategjitë bazë në klasë dhe përshtatjet: për të gjithë fëmijët

- Hartoni një plan të qartë për mësimin dhe përcaktoni që në fillim aktivitetet që do të organizohen dhe në fund kontrolloni nëse është përvetësuar mësimi.
- Planifikoni aktivitete shtesë për fëmijët që mbarojnë më parë.
- Përdorni DUN-në si kuadër orientues: Sigurohuni që të paraqisni pikat kyçe të të nxëniet për mësimin nëpërmjet sinjaleve pamore, dëgjimore dhe, nëse është e mundur, të prekshme - përgjigjuni stileve të ndryshme të të nxëniet
- Tregohuni fleksibël dhe ofroni një sërë aktivitete, për të vënë në praktikë të njëjtat kompetenca dhe për të arritur të njëjtat rezultate të të nxëniet.
- Përpara mësimit, sigurohuni që të flisni me fëmijët dhe të shpjegoni se çfarë do të mësojnë sot - fëmijët me vështirësi në të nxëniet mund të kenë nevojë për shpjegim më të thjeshtuar, i cili të përsëritet.
- Tregohuni pozitivë dhe bëhuni shembull i mirësisë, respektit dhe dashurisë për fëmijët në klasë.
- Nxisni një kulturë bashkëpunuese dhe që nxit të shprehurit në klasë, ku fëmijët të mund të flasin dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin.
- Ndërveproni me fëmijët gjatë mësimit:
 - Vëzhgojini fëmijët dhe kontrollojini për të monitoruar punën e tyre dhe sigurohuni që janë duke bërë atë që prisni prej tyre.
 - Jepuni shumë lavdërime dhe inkurajime
 - Kontrolloni për të parë kuptueshmërinë gjatë mësimit.
- Tregohuni konsistentë - jini të qartë mbi atë çfarë prisni prej fëmijëve të ndryshëm - p.sh. disa mund të mbarojnë 20 përlllogaritje matematikore, të tjerë duhet të bëjnë më pak.
- Përdorni arsyen. Tregohuni të durueshëm kur fëmijët nuk po kuptojnë aq shpejt sa do të donit. Përsëriteni informacionin dhe shpjegimet përpara se të vazhdoni me detyrat.
- Përqendrohuni tek të nxëniet dhe jini të qartë se prisni që të gjithë në klasë të punojnë fort dhe të nxënë gjatë mësimit.
- Sigurohuni që fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë në grup me nxënës të tjerë që kanë vështirësi. Vendosini ata në grupe me fëmijë që mund të japin mbështetje dhe ndihmë.
- Jepuni kohë më të gjatë për të përfunduar punën fëmijëve që iu nevojitet.
- Gjatë provimeve të rëndësishme, mbështetini fëmijët me aftësi të kufizuara, duke mundësuar ndihmë në kuptimin e pyetjeve dhe shkrimin e përgjigjeve të tyre sipas nevojës. Kjo ndihmë mund të jepet nga një nxënës i një viti ose klase tjetër, apo një mësues i caktuar ndihmës.

Strategjitë bazë në klasë dhe përshtatjet: Për fëmijët me dëgjim të kufizuar

Kërkojuni fëmijëve me dëmtim të dëgjimit që të ulen në pjesën e përparme të klasës, në mënyrë që të mund të shohin lehtësisht se çfarë është shkruar në dërrasë.

- Kini parasysh që fëmijët, të cilët kanë vështirësi me leximin përdorin shenja pamore për të kuptuar më mirë informacionin. Kur të flisni, sigurohuni që ata të mund të shohin buzët tuaja, në mënyrë që të mund t'ju lexojnë, për të qenë pjesë e diskutimit - mos flisni kur jeni të kthyer nga dërrasa e zezë.
- Minimizoni zhurmat në sfond. Menaxhoni klasën në mënyrë që, gjatë diskutimeve në grup, nxënësit të mos flasin të gjithë njëkohësisht.
- Sigurohuni që klasa të jetë e ndriçuar mirë, në mënyrë që fëmijët me dëmtim të dëgjimit të mund të maksimizojnë shenjat pamore për të kuptuarit.

- Paraqiteni dhe me shkrim atë që po komunikohet. Mundësoni materiale të shkruara për të plotësuar diskutimet dhe lajmërimet në klasë. Vendosni emërtime në pjesë të ndryshme të klasës dhe përdorni paraqitje pamore për rutinën dhe marrëveshjet e klasës.
- Kur shfaqni video në klasë, sigurohuni që të kenë titra.
- Fëmijët me humbje të dëgjimit mund të kenë aftësi të kufizuara gjuhësore. Diskutoni fjalët e panjohura dhe strukturoni detyrat e të lexuarit.
- Lejojini fëmijët që të punojnë me shokët për të mbajtur shënime.
- Tërhiqni vëmendjen e nxënësit para se të flisni
- Paraqisni informacionin qartë dhe thjesht
- Shqiptojini qartë fjalët

Strategjitë Bazë në klasë dhe përshtatjet: Këshilla për mësuesit

Për fëmijët me një aftësi të kufizuara fizike:

- Mundësoni hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur nëpër klasë dhe në hapësirat e tjera shkollore. Sigurohuni që çdo hapësirë e klasës dhe materialet e mjetet në klasë të mund të aksesohen në mënyrë të pavarur nga fëmijët me aftësi të kufizuara fizike.
- Tregohuni fleksibël me orarin pasi fëmijëve me aftësi të kufizuara mund t'u nevojitet më shumë kohë për të ardhur dhe për t'u larguar nga klasa.
- Jepini fëmijës kohë të mjaftueshme për të lëvizur nëpër klasë për punët në grup dhe ndërrimet e lëndëve.
- Nëse një fëmijë ka vështirësi në të shkruar, vendoseni fëmijën bashke me një shok që mund ta ndihmojë apo të mbajë shënime. Lejojini fëmijës që të përdorë teknologji ndihmëse si kompjuteri, incizues i vogël apo kamerë për të regjistruar informacionin, në vend që ta shkruajë.
- Nëse një fëmijë lodhet shpejt, menaxhoni aktivitetet që të ketë kohë shtesë për të përfunduar detyrën.

Strategjitë bazë në klasë dhe përshtatjet: Për fëmijët me dëmtim në shikim Kërkojuni fëmijëve, të cilët kanë vështirësi në shikim, që të ulen pranë dërrasës së zezë.

- Përdorni materiale të nxëni me shkronja të mëdha në klasë dhe me kontrast të theksuar (p.sh. materialet udhëzuese të printuara për përdorim vetjak, emërtimet në klasë, numrat e klasave, etj.)
- Përdorni tekst të regjistruar nëse është e nevojshme. Lejojuni nxënësve të incizojnë pjesë të mësimëve dhe udhëzimet në vend që të mbajnë shënime.
- Lejojini fëmijët që të kenë më shumë kohë për të lexuar dhe shkruar. Lejojini nxënësit që të përdorin një lapustil ose mjet shkrimi me majë të trashë për të bërë detyrat.
- Nëse jepni udhëzime ose detyra me shkrim, sigurohuni që të jenë të shkruara qartë dhe me tekst të madh. Jepuni fëmijëve një kopje të shënimeve të klasës dhe lejojini që t'i aksesojnë ato nga tableti.
- Jepini udhëzimet në mënyrë verbale si dhe në mënyrë pamore. Komunikoni gjithçka siç është shkruar në dërrasë.
- Mundësoni një sërë aktivitetesh që angazhojnë shqisat e tjera për të nxënësit dhe paraqitjet e të nxënësit (Shihni Seksionin për DUN, f. 28). Lejojini fëmijët me dëmtim në shikim që të dorëzojnë detyra më të shkurtra me shkrim dhe/ose të demonstrojnë të nxënësit nëpërmjet një mënyre tjetër.
- Kini parasysh që fëmijët, të cilët kanë dëmtim në shikim, do të kenë indicie të kufizuara pamore dhe do kenë më pak akses ndaj shenjave pamore se sa shokët e tyre të klasës, të cilët nuk kanë vështirësi në të parë (p.sh. të parit të orarit të klasës, orës, leximit të materialeve ndihmëse dhe materialeve pamore në mure, duke përfshirë dhe materialet udhëzuese, rregullat dhe emërtimet në klasë, etj.). Mundësoni udhëzime jo pamore për të komunikuar rutinën e klasës, si kontrolli i orarit ditor të klasës dhe përdorimi i mënyrave dëgjimore për të lajmëruar ndërrimet e lëndëve. Gjithashtu, mund t'u kërkohet shokëve të klasës që të ndihmojnë fëmijët

me dëmtim në shikim që të ndjekin rutinën e klasës.

- Fëmijëve me dëmtim në shikim do t'iu nevojitet mbështetje për orientimin dhe lëvizjen në hapësirat e të nxënit. Jepini kohë fëmijës me dëmtim në shikim që të mësohet me organizimin e klasës, bibliotekës, mensës dhe hapësirave të tjera kyçe në shkollë, në mënyrë që të familjarizohet me mjedisin që e rrethon dhe të fitojë siguri për të lëvizur. Orientojeni fëmijën me dëmtim në shikim lidhur planimetrinë e të gjithë shkollës (p.sh tualetet, palestra, biblioteka, mensa, zyra e udhëzimeve, fushat e lojës, etj.) si dhe mbi procedurat shkollore të emergjencës.
- Lejohuni kohë fëmijëve me dëmtim në shikim që të njihen me shokët e klasës, pasi mund ta kenë të vështirë të lidhin emrat me fytyrat. Krijoni qëllimisht aktivitete dhe përvoja për ndërveprime individuale ose në grupe të vogla me shokët e klasës.

Strategjitë bazë në klasë dhe përshtatjet: Këshilla për mësuesit
Për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale

- Përsëritini udhëzimet disa here.
- Ndajini detyrat e mëdha në pjesë më të vogla. Jepini udhëzimet hap pas hapi. Jepni zgjedhje të qarta.
- Përdorni fjalë sa më të thjeshta të jetë e mundur në aktivitete
- Paraqiteni mësimin në mënyra të shumëfishta (p.sh pamore, dëgjimore, ilustruese, dhe mësim praktike)
- Krijoni një sistem shoku, në mënyrë që moshatarët të mund të ndihmojnë fëmijët me dëmtime intelektuale që të kuptojnë dhe përmbushin aktivitetet dhe detyrat e klasës.
- Përdorni materiale me shkronja të mëdha dhe bëni një paraqitje pamore të mësimin.
- Përforconi udhëzimet e shkruara duke i shpjeguar me gojë.

Strategjitë bazë në klasë dhe përshtatjet: Këshilla për mësuesit
Për fëmijët me vështirësi komunikimi dhe ndërveprimi (këtu përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, me vështirësi në të folur dhe fëmijët me autizëm)

- Flisni duke përdorur gjuhë të drejtpërdrejtë dhe konkrete, shmangni përdorimin e idiomave dhe sarkazmës. Zakonisht, është më efektive të thuash "Lini stilolapsat, mbyllini fletoren dhe vendosuni në radhë për të dalë jashtë" se sa "Qenka bukur jashtë. Le ta bëjmë mësimin e shkencës tani. Sapo të keni përfunduar me shkruarit, mbyllini librat dhe vendosuni në radhë tek dera. Sot do të studiojmë bimët jashtë".
- Përcaktoni një rutinë ditore dhe kini një strukturë të qartë për ditën.
- Bëjeni kalimin nga një temë në tjetër në mënyrë të qartë. Bëjeni pjesë të rutinës suaj sinjalizimin e përfundimit të një aktiviteti dhe fillimit të tjetrit. Gjithashtu, mund të përdorni shenja si vendosja e muzikës apo një përplasje specifike duarsh, të cilat do të ndihmojnë fëmijët të kuptojnë se do të fillojnë temë tjetër.
- Jepni sa më pak zgjedhje. Nëse një fëmijë pyetet të zgjedhë një ngjyrë, jepini vetëm dy ose tre zgjedhje.
- Jepni zgjedhje shume të qarta dhe përpikuni të mos lini zgjedhje të hapura. Ka gjasë të merrni rezultat më të mirë duke pyetur "Dëshiron që të lexosh apo vizatosh?" se sa "Çfarë dëshiron që të bësh tani?"
- Mësojuni aftësi/rregulla shoqërore specifike, si bërja e gjërave me radhë dhe distanca sociale.
- Përsëritini udhëzimet dhe kontrolloni të kuptuarit, duke përdorur fjali të shkurtra që të siguroni qartësinë e udhëzimeve.
- Shmangni stimulimin e lartë. Minimizoni/hiqni gjërat shpërqendruese kur është dhënë një detyrë që kërkon përqendrim. Mundësoni akses në një hapësirë pune ose bankë individuale. Posterat shumëngjyrësh në mur mund të jenë shpërqendruese për disa nxënës, ndërsa të tjerë mund të kenë problem zhurmën.

Strategjitë Bazë në Klasë dhe Përshtatjet: Këshilla për Mësuesit
Për fëmijët me vështirësi komunikimi dhe ndërveprimi (këtu përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, me vështirësi në të folur dhe fëmijët me autizëm)

- Mësojuni nxënësve se ç'është të thotë "e përfunduar" dhe ndihmojini ata që të kuptojnë se kur diçka ka përfunduar dhe kur ka filluar diçka tjetër. Bëni një fotografi të asaj se si duhet të duket produkti i përfunduar dhe tregojani nxënësit. Nëse dëshironi që të fshihet klasa, bëjini një fotografi se si duhet të duket kur është e pastër. Nxënësit mund ta përdorin atë si referencë.
- Drejtojuni nxënësit individualisht çdo herë (për shembull, nxënësi mund të mos e kuptojë që një udhëzim që i është dhënë të gjithë klasës përfshin dhe atë. Ta thërrisni nxënësin në emër dhe t'i thoni "Duhet që të dëgjosh pasi është diçka që duhet ta bësh edhe ti" mund të funksionojë; herë të tjera nxënësit do të duhet t'i drejtoheni individualisht)
- Kini parasysh se disa ndryshime në manierizmat apo sjelljet e nxënësit mund të reflektojnë ankth (që mund të shkaktohet nga një ndryshim (i vogël) i rutinës)
- Mos merrni personale sjellje në dukje agresive apo të paedukata; dhe kuptoni se objekti i zemërimit të nxënësit mund të mos ketë të bëjë me burimin zemërimi.
- Synoni që të lidhni punën me interesat e veçanta të nxënësit.
- Hulumtoni përpunimin e fjalëve, dhe të nxënët me kompjuter për aftësitë e shkrimit e këndimit.
- Mbrojeni nxënësin nga ngacmimi në çdo rast dhe jepuni shokëve informacion mbi nevojat e tij/saj të veçanta.
- Lejojuni nxënësin që të shmangë aktivitete të caktuara (si sportet dhe lojërat) të cilat mund të mos i kuptojë apo pëlqejë; dhe mbështeteni nxënësin në detyrat e lira në grup.
- Lejojuni sjellje kompulsive si shpërblim për përpjekjet pozitive.

Materiali 2 - Dita 3: Plani për mbështetjen e familjes dhe fëmijës


Dita 3 - Planifikimi për arsim gjithëpërfshirës

Aktiviteti 9 - Prezantim "Plani për mbështetjen e familjes dhe fëmijës"

Plani për mbështetjen e familjes dhe fëmijës

Emri i fëmijës:

Vendosni fotografinë e fëmijës këtu :



Ky plan nisi më:

Numri i planit:

Ky plan do të rishikohet më:

Data e rishikimit të fundit:

Detajet e mia personale		
Mbiemër	Emër	Emri i Parapëlqyer
Adresa		
Data e Lindjes	Gjinia	Besimi fetar
Raca	Gjuha e Parapëlqyer	

Prindërit/ Kujdestarët e mi	
Mbiemër	Emër
Adresa	
Numër Telefoni Numër Celulari	Marrëdhënia me fëmijën
E-mail	
Mbiemër	Emër
Adresa	
Numër Telefoni Numër Celulari	Marrëdhënia me fëmijën
E-mail	

SEKSIONI A: Cfarë duhet të dini për

SEKSIONI A: dhe Pikëpamjet e prindërve, interesat, shpresat dhe aspiratat
<p>Kush jam unë</p> <p>Çfarë pëlqejnë njerëzit tek unë</p> <p>Si mund të më mbështesësh dhe të komunikosh më mirë me mua</p> <p>Çfarë pëlqej dhe çfarë bëj mirë në shkollë</p> <p>jashtë shkollës</p>

Gjërat që nuk janë duke shkuar mirë për momentin

Çfarë dua të arrij këtë vit

Si e shoh veten të rritur

Çfarë dëshirojnë prindërit që unë të arrij këtë vit

Çfarë dëshirojnë prindërit për të ardhmen time

SEKSIONI B: Vlerësimi im

SEKSIONI B: Pikat e forta dhe nevojat

Komunikimi dhe ndërveprimi

Pikat e forta dhe aftësitë

Nevojat

Aftësia njohëse dhe të nxënit

Pikat e forta dhe aftësitë

Nevojat

Shëndeti social, emocional dhe mendor

Pikat e forta dhe aftësitë

Nevojat

Nevojat shqisore dhe/ose fizike
Pikat e forta dhe aftësitë

Nevojat

Kujdesi shëndetësor
Pikat e forta

Nevojat

SEKSIONI C dhe D: Qëllimet dhe Vështirësitë e mia

SEKSIONI C: Qëllimet

Komunikimi dhe ndërveprimi
Qëllimi afatgjatë

Qëllimi/et afatshkurtër/a

Njohja dhe të nxënit
Qëllimi afatgjatë

Qëllimi/et afatshkurtër/a

Vështirësitë shoqërore, emocionale dhe të shëndetit mendor
Qëllimi afatgjatë

Qëllimi/et afatshkurtër/a

Nevojat shqisore dhe/ose fizike
Qëllimi afatgjatë

Qëllimi/et afatshkurtër/a

SEKSIONI D: Çdo mbështetje apo masë për arritjen e qëllimeve të përmendura në seksionin D (nga qeveria, shkolla, qendra e kujdesit shëndetësor, OJF-të, organizatat private apo familja)

Qëllimi afatshkurtër i të nxënit	Çfarë duhet të ndodhë për ta arritur këtë qëllim?	Kush do ta mundësojë mbështetjen?	Sa shpesh?	Çfarë burimesh nevojiten?

Rregullimet për rishikimin e Planit

Duhet të ndodhë të paktën çdo vit

Data e rishikimit të ardhshëm:

Profesionistët e kërkuar për rishikimin e ardhshëm:

Profesionisti drejtues përgjegjës për rishikimin e planit:

Detajet e kontaktit:

Materiali 3 - Dita 3: Rast studimor

Dita 3 - Planifikimi për arsim gjithëpërfshirës
Aktiviteti 10 - Rast studimor

Udhëzime

- Lexoni historinë e Ling-Ling-ut
- Diskutoni pyetjet me grupin tuaj të vogël
- Mos raportoni

Historia e Ling-Ling-ut^{xv}

Ling-Ling-u është një vajzë 4 vjeçe e gjysmë me sindromën Down. Ajo ka marrë ndërhyrje të hershme në një qendër shëndetësore vendase. Në fillim të vitit, mësuesja e ndërhyrjes së hershme ishte e shqetësuar për aftësitë e saj të vonuara të gjuhës së folur dhe ato motorike, dhe sugjeroi që Ling-Ling-u të merrte ndërhyrje terapeutike fizike dhe të gjuhës së folur. Tre muaj më vonë, mësuesja e Ling-Ling-ut ishte e frustruar nga fakti që Ling-Ling kishte pasur progres minimal në aftësitë e gjuhës së folur dhe motorike. Ajo gjithashtu zbuloi se prindërit e Ling-Ling-ut nuk e kishin ndjekur planin e ndërhyrjes në shtëpi, një përcaktues kritik i suksesit. Çfarë ajo nuk dinte ishte se familja e Ling-Ling-ut kishte shqetësime të tjera.

Të pasurit e një fëmije me aftësi të kufizuara ka një ndikim thelbësor dhe afatgjatë në familjen e Ling-Ling-ut. Kjo gjë ndryshon sistemin e besimit që familja ka ndjekur për breza me radhë. Budizmi është feja e kësaj familjeje, dhe ata besojnë se çfarë do të bëjnë në këtë botë do të përcaktojë se çfarë do të bëhen në botën tjetër pas vdekjes. Z. Dhe Znj. Chan besonin se të pasurit e një fëmije me aftësi të kufizuara ishte dënim nga perëndia për një gabim të bërë prej tyre ose paraardhësve. Prandaj, e vetmja mënyrë për t'u përballur me aftësinë e kufizuar ishte të punuarit fort dhe pendesa. Ata nuk besonin se kishin fuqinë të ndryshonin ose përmirësonin gjendjen e Ling-Ling-ut. Të dy ata punonin me kohë të plotë. Ata nuk kishin shumë kohë për terapinë në shtëpi të Ling-Ling dhe ndiheshin më rehat të kërkonin mbështetje nga familjarët e tyre se sa të merrnin ndihmë profesionale. Ata e konsideronin përkujdesjen dhe mbrojtjen e Ling-Ling si përparësinë e familjes.

Grupi i PMFF-së të Ling-Ling-ut përbëhej nga Ling-Ling-u, prindërit e saj, gjyshërit, vëllai i madh, shokët e kopshtit, Sarah dhe Tom-i, mësuesja e ndërhyrjes së hershme, terapeuti i gjuhës së folur dhe terapeuti i saj fizik. Të gjithëve iu kërkua që të flisnin rreth ëndrrave të tyre për Ling-Ling-un. Çfarë e bëri këtë proces planifikimi unik ishin ëndrrat për Ling-Ling, që u shprehën nga vëllai i saj më i madh, Sam-i, dhe shokët, Sarah dhe Tom-i. Sam-i ishte një vëllai shume i përkujdesur, dhe ai luante shpesh me Ling-Ling-un pas kthimit nga shkolla. Ëndrra e tij për Ling-Ling-un ishte që ajo të mund të shkonte në kolegji; ëndërr që ai e kishte dhe për veten e tij. Sarah tha se ëndrra e saj për Ling-Ling-un ishte që të shkonin në kopësht së bashku, në mënyrë që të mund ta shihnin njëra-tjetrën çdo ditë dhe të luanin së bashku. Tom-i ishte një djalë shumë aktiv dhe dëshironte që Ling-Ling-u të luante futboll me të. Kur u pyet përse, ai tha sepse ishin shokë të ngushtë. Ling-Ling-u donte gjithashtu të luante me shokët e saj sa më shumë të ishte e mundur. Terapistët e saj donin që Ling-Ling-u të ishte e aftë të shprehej më qartë dhe të përmirësonte aftësitë e përgjithshme motorike. Prindërit e saj donin që Ling-Ling-u të merrte përkujdesjen më të mirë të mundshme. Krahasuar me ëndrrat e të rriturve për Ling-Ling-un, të cilat përqendroheshin kryesisht në aftësitë e saj, shokët e Ling-Ling-ut iu kujtuan të rriturve se Ling-Ling-u ishte, së pari, një fëmijë 4-vjeçar si të gjithë moshatarët e tjerë, dhe për këtë arsye ajo kishte nevojë të rrinte me moshatarët e saj në një ambient gjithëpërfshirës. Për ta realizuar këtë ëndërr, u sugjerua një program gjithëpërfshirës i fëmijërisë së hershme. Nëpërmjet këtij procesi, Z. dhe Znj. Chan ishin shumë të lumtur kur zbuluan që Ling-Ling-u pranohej nga moshatarët e saj pa aftësi të kufizuara si shoqja e tyre, gjë të cilën ata druheshin se nuk do të ndodhte kurrë. Ata nuk e kishin ëndërruar asnjëherë që Ling-Ling-u do të shkonte në një shkollë të zakonshme si vëllai i saj, deri në atë moment. Një horizont i ri po shpalosej për Ling-Ling-un.

Pyetje për diskutim në grup

- Cila është vlera e shtuar e përfshirjes së fëmijëve në procesin e PMFF-së? (Ling-Ling, vëllai Sam-i dhe shokët Sarah dhe Tom-i)
- Cilat janë prioritetet për palët e interesuara?
- Cilat janë pikat e forta dhe burimet në komunitetin e Ling-Ling-ut?
- Formuloni të paktën një qëllim afatgjatë për Ling-Ling-un

Lista e referencave

- Alexander, Robin. "Still No Pedagogy? Principle, Pragmatism and Compliance in Primary Education." *Cambridge Journal of Education* 34, nr. 1 (2004): 7-33.
- Booth, Tony, and Mel Ainscow. *The Index for Inclusion. A Guide to School Development Led by Inclusive Values. 4th Edition*. Cambridge: Index for Inclusion Network, 2016.
- CAST. "Top 5 Udl Tips for Learning Environments." Marrë nga: <http://castprofessionallearning.org/project/top-5-udl-tips-for-learning-environments/> (Aksesuar për herë të fundit më 13/11/18): CAST Professional Learning, 2018.
- EENET. "Inclusive Education Teacher Training. Programme 7 - Teaching and Learning." Marrë nga: <https://www.eenet.org.uk/the-10-videos-and-manuals/> (Aksesuar për herë të fundit më 14/11/18): EENET, 2017.
- Republika e Azerbajxhanit. "Kushtetuta e Azerbajxhanit." Baku: Republika e Azerbajxhanit, 1995.
- . "Education Law of the Republic of Azerbaijan." Baku: Republic of Azerbaijan, 2009.
- OKB. "Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Opsional." Marrë nga: <http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 25/08/2014), 2006.
- . "Konventa për të Drejtat e Fëmijës." Marrë nga: <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx> (V Aksesuar për herë të fundit më 22/09/2014), 1989.
- . "Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut" Paris: OKB, 1948.
- UNICEF. "Webinar 11, Aksesimi në Shkollë dhe Ambienti i të Nxënësve - Dizajni i Universal i të Nxënësve. Broshura Teknike Shoqërore." Nju Jork: UNICEF, 2014.
- . "Webinar 12, Mësuesit, Mësimdhënia dhe Pedagogjia Gjithëpërfshirëse me në Qendër Fëmijën. Broshurë Teknike Shoqërore." Nju Jork: UNICEF, 2014

ⁱUNICEF, "Webinar 12, Mësuesit, Pedagogjia dhe Mësimdhënia Gjithëpërfshirëse, me në Qendër Fëmijën. Broshurë Teknike Shoqërore," (Nju Jork: UNICEF, 2014).

ⁱⁱOKB, "Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut," (Paris: OKB, 1948).

ⁱⁱⁱ"Konventa për të Drejtat e Fëmijëve," (Marrë nga: <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx> (Aksesuar për herë të fundit më: 22/09/2014)1989).

^{iv}"Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokolli Opsional," (Marrë nga: <http://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më: 25/08/2014)2006).

^vPo aty.

^{vi}Tabela është marrë nga: http://www.eenet.org.uk/what_is_ie.php

^{vii}Tony Booth dhe Mel Ainscow, *Indeksi për Gjithëpërfshirje. Udhëzues për Zhvillimin e Shkollës udhëhequr nga Vlerat Gjithëpërfshirëse. Botimi i 4-t* (Cambridge: Indeks për Rrjetin Gjithëpërfshirës, 2016).

^{viii}Robin Alexander, "Still No Pedagogy? Principle, Pragmatism and Compliance in Primary Education," *Cambridge Journal of Education* 34, no. 1 (2004).

^{ix}Përshtatur nga: UNICEF, "Webinar 12, Teachers, Inclusive, Child-Centred Teaching and Pedagogy. Companion Technical Booklet."

^xPërshtatur nga: ibid.

^{xi}Përshtatur nga: ibid.

^{xii}"Webinar 11, Access to School and the Learning Environment li - Universal Design for Learning. Companion Technical Booklet," (New York: UNICEF, 2014).

^{xiii}Përshtatur nga: CAST, "Top 5 Udl Tips for Learning Environments," (Retrieved from: <http://castprofessionallearning.org/project/top-5-udl-tips-for-learning-environments/> (Last accessed on 13/11/18): CAST Professional Learning, 2018).

^{xiv}Përshtatur nga Yaoying Xu and John Filler. "Facilitating Family Involvement and Support for Inclusive Education." *The School Community Journal* 18, nr. 2 (2008).

^{xv}Përshtatur nga Yaoying Xu and John Filler. "Facilitating Family Involvement and Support for Inclusive Education." *The School Community Journal* 18, nr. 2 (2008)

